



BASHKITË PËR NË EVROPË  
Një projekt i financuar nga BE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E PUNËVE  
TË BRENDSHME

# BASHKITË NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Raporti i Vlerësimit  
për Vitin 2021

KORRIK 2022





BASHKITË PËR NË EVROPË  
Një projekt i financuar nga BE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E PUNËVE  
TË BRENDSHME

# BASHKITË NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Raporti i Vlerësimit  
për Vitin 2021

---

KORRIK 2022

Raporti i 5<sup>të</sup> paraqet ecurinë e institucioneve të vetëqeverisjes vendore në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian për sa i përket realizimit të detyrimeve që rrjedhin në kuadër të kriterëve dhe angazhimeve të procesit të integrimit evropian gjatë vitit 2021.

Njësitë e Integrimit Evropian në secilën bashki kanë koordinuar organizimin e brendshëm të grumbullimit të të dhënave ndërsa orientimi dhe monitorimi i procesit të raportimit është realizuar nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV). Analiza e të dhënave dhe përgatitja e raportit u asistuan edhe nga ekspertët e projektit “Bashkitë për në Evropë” znj. Mirsa Titka dhe znj. Valbona Kuko.

## SHENIM

*Ky botim u realizua me mbështetjen financiare të projektit “Bashkitë për në Evropë” financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.*

**TABELA E LËNDËS**

<b>I.</b>	<b>Përmbledhje Ekzekutive</b> .....	6
<b>II.</b>	<b>KRITERI POLITIK</b> .....	18
1.1.	DEMOKRACIA.....	18
1.1.1.	Qeverisja .....	18
1.1.2.	Rritja e Transparencës së Financave Vendore .....	24
1.1.3.	Administrata Publike .....	27
1.1.4.	Avokati i Popullit.....	34
1.1.5.	Shoqëria civile .....	36
1.2.	Shteti i së drejtës .....	40
1.2.1.	Lufta kundër korrupsionit .....	40
1.2.2.	Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave .....	44
<b>III.</b>	<b>KRITERI EKONOMIK</b> .....	48
2.	Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale .....	48
<b>IV.</b>	<b>AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT</b> .....	52
3.1	Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi dhe rural.....	52
3.2	Kapitulli 12: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare .....	59
3.3	Kapitulli 14: Politika e transportit .....	63
3.4	Kapitulli 15: Energjia .....	69
3.5	Kapitulli 16: Taksat .....	73
3.6	Kapitulli 19: Politikat sociale dhe punësimi .....	77
3.7	Kapitulli 22: Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumentave strukturorë .....	84
3.8	Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore .....	87
3.9	Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria .....	102
3.10	Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura .....	105
3.11	Kapitulli 27: Mjedi dhe ndryshimi i klimës .....	110
3.12	Kapitulli 32: Kontrolli financiar .....	122

## ➔ SHKURTIME

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara në Shqipëri
PV	Plan Veprimi
RV	Raport Vjetor
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
NjA	Njësi Administrative
BE	Bashkimi Evropian
SNKK	Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2020
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
KK	Këshilli Konsultativ për vetë-Qeverisjen Vendore
KM	Këshilli i Ministrave
KE	Komisioni Evropian
SNRAP	Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020
DPPS	Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale
ILKPKDI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PAK	Person me Aftësi të Kufizuara
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
PPV	Plani i Përgjithshëm Vendor
NjVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
PKVIRE	Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane
PVIRE	Plani Vendor për Integrimin e Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane
QQ	Qeveria Qëndrore
QV	Qeveria Vendore
MB	Ministria e Brendshme
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTE	Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PKVPAK	Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara
PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë
PVMIM	Plan Vendor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve

RAP	Reforma e Administratës Publike
SNDQV	Strategjia Ndërsektorale e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore
SKEE	Strategjia Kombëtare për Eficiencën e Energjisë
SKPA	Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
ZIN	Qendra e Integruar me një Ndalesë
SSC	Sistemi i Sigurimit të Cilësisë
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
MSA	Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asocimit
MIM	Menaxhimi i Integruar i Mbetjeve
RAT	Reforma Administrative Territoriale
SZHAP	Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar
GP	Grup Pune
SHBSH	Shoqata e Bashkive të Shqipërisë
SHAV	Shoqata për Autonominë Vendore
ZNjN	Zyra me Një Ndalesë
TI	Teknologjia e Informacionit
HRMIS	Sistemi Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme

## Përmbledhje Ekzekutive

### KRITERI POLITIK

#### Demokracia

**Këshilli Konsultativ** ka funksionuar si forumi kryesor për dialogun institucional dhe koordinimin ndërmjet qeverisë qendrore dhe qeverive vendore. Këshilli Konsultativ (KK) ka organizuar 6 takime në të cilat janë diskutuar projektakte të fushave të ndryshme, gjithsej nga 52 projektakte të paraqitura, 43 janë konsultuar dhe miratuar (më shumë akte të konsultuara në krahasim me vitin 2020). Ndonëse përfaqësimi i Qeverisë në takimet e Këshillit Konsultativ nuk është plotësisht sipas parashikimeve ligjore, në 2021 ka patur një rritje të nivelit të përfaqësimit në krahasim me 2020. Sfidë mbetet rritja e ndërgjegjësimit dhe kuptimi i rolit të KK nga të gjithë Kryetarët e 61 NJVV dhe sigurimi i pjesëmarrjes së plotë të tyre në takimet e KK. Nevojitet një monitorim dhe vlerësim sistematik i zbatimit të strategjisë kombëtare ndërsektoriale të decentralizimit dhe qeverisjes vendore 2015-2022<sup>3</sup>.

Në kuadër të studimit "Matrica e Kompetencave", në identifikimin konkret të hapësirave ligjore dhe përplasjeve të ligjit organik 139/2015 (Për Vetëqeverisjen Vendore" me ligje të tjera sektoriale për funksionet e pushtetit vendor) dhe Urdhrit të Kryeministrit 101/2019, në vitin 2021, Ministria e Brendshme përditësoi rekomandimet ligjore, duke adresuar rekomandimet me fushën e përgjegjësisë së institucioneve përgjegjëse, ashtu edhe përditësoi rekomandimet ligjore me ndryshimet e fundit të bazës ligjore dhe prioriteve të Qeverisë. Në këtë këndvështrim, bazuar në listën e rekomandimeve të Matricës së Kompetencave për vitin 2021, shkalla e zbatimit, përkatësisht niveli i harmonizimit ligjor për vitin 2021, është 58%<sup>4</sup>.

Në fushën e **shërbimeve dhe transformimit digjital**, vendi ka ruajtur pozicionin në krye të vendeve të rajonit. Rreth 95% e shërbimeve administrative janë të vlefshme online<sup>5</sup>. Harta e Zyrave me Një Ndalesë (ZNjN) në nivel bashkie është zgjeruar në të gjitha bashkitë e vendit, si dhe norma e shtrirjes së tyre në Njësitë Administrative në 35% (ose +5 p.p. krahasuar me vitin 2020). Mbeten sfida zgjerimi i ZNjN në të gjithë territorin e Bashkive, rritja e financimit nga buxheti vendor për përmirësimin e infrastrukturës fizike, teknologjisë së informacionit dhe internetit për mundësimin e zyrave në njësitë administrative si dhe trajnimi i stafëve përkatëse.

Është i nevojshëm hartimi dhe miratimi i standarteve minimale të shërbimeve, si dhe forcimi i rolit mbikqyrës të AMVV për të siguruar që NJVV të ofrojnë shërbime në përputhje me kërkesat dhe standartet e cilësisë së tyre<sup>6</sup>.

#### Administrata publike

**Ka pasur progres** në lidhje me **reformën në administratën publike**. Është arritur përparim me miratimin e udhëzimeve për konsultimet publike, ngritjen e sistemeve të TI-së për planifikim të integruar, rritjen e shkallës së zbatimit të Planit Kombëtar të Integritimit Evropian, rritjen e numrit të shërbimeve elektronike dhe përfundimin e fazës së testimit për të automatizuar sistemin e pagave .

Në 2021, përparim është bërë në zbatimin e legjislatcionit të shërbimit civil, me fokus NJVV, digjitalizimin e procesit të rekrutimit në shërbimin civil (mundësia për ta zhvilluar procesin online), forcimin e kapaciteteve profesionale të nënpunësve publik dhe të komisioneve të vlerësimit, përdorimi i moduleve të unifikuara të

<sup>3</sup> Raport Progresi i KE për Shqipërinë (2021)

<sup>4</sup> Ministria e Brendshme (2022) Raporti i Monitorimit për vitin 2021

<sup>5</sup> SIGMA Raport monitorimi për Shqipërinë (Nëntor 2021); <https://www.idp.al/2021/12/22/raporti-i-monitorimit-per-shqiperine-nga-sigma-parimet-e-administrates-publike/>

<sup>6</sup> Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (2020)

<sup>7</sup> Raport Progresi i KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)



platformës së integruar “administrata.al”. Rrjeti i koordinatorëve vendorë të BE-së ka forcuar përfshirjen e NJVV-ve në procesin e anëtarësimit në BE, duke rritur ndërgjegjësimin për politikat e BE-së, fondet dhe programet e saj.

Numri i punonjësve të administratës vendore është ulur me 3.6 p.p. në krahasim me vitin 2020, ndërsa norma mesatare e nëpunësve me status është rreth 35.4% të punonjësve të administratës vendore. Numri i nëpunësve vendorë me status është më i ulët në krahasim me vitin 2020. Punësimi i femrave në pozicione drejtuese ka pësuar rritje në 2021 krahasuar me vitin 2020. Numri i programeve të trajnimit nga ASPA për fuqizimin e kapaciteteve profesionale të administratës vendore është rritur në 2021. Gjithsej janë trajnuar rreth 2300 punonjës, nga të cilët 853 janë trajnuar mbi zbatimin e Ligjit të Nëpunësit Civil dhe 300 punonjës të trajnuar mbi udhëzimet dhe manualet për menaxhimin e burimeve njerëzore. Sistemi HRMIS ka qenë funksional në një numër pak më të lartë të NJVV në 2021.

Mbeten sfida zbatimin koherent të Ligjit të Nëpunësit Civil në nivel vendor, ulja e punësimit me kontrata të përkohshme për pozicionet e shërbimit civil, dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së nëpunësve në administratën vendore e në mënyrë të veçantë i nëpunësve më përvojë.

Një kuadër i ri strategjik për Reformën në Administratën Publike rekomandohet të hartohet me mekanizma monitorimi dhe koordinimi më efektive, përmirësimi i koordinimit brenda administratës, veçanërisht në lidhje me procesin e integritetit në BE, dhe shtrirja e sistemit të integruar të politikbërjes edhe në nivelin vendor<sup>8</sup>.

Bashkitë kanë bërë progres të lehtë lidhur me **pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen vendore dhe përmirësimin e transparencës së financave vendore**. Ndonëse më pak dëgjesa publike me qytetarët janë organizuar nga NJVV, në 2021, mbi projektbuxhetin (faktor ndikues mund të ketë qenë edhe situata e pandemisë), numri i qytetarëve pjesëmarrës në dëgjesat publike ka qenë më i lartë në krahasim me 2020. NJVV kanë mbajtur funksionale programin e transparencës në faqen zyrtare të bashkisë dhe publikojnë të gjitha dokumentet kryesore si buxheti vjetor dhe raporte të tjera të financave vendore. Sfida mbeten rritja e ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjes së qytetarëve, hartimi i buxhetit në një format të thjeshtë e të lexueshëm për qytetarët dhe caktimi i një nëpunësi në bashki për procesin e konsultimit dhe dëgjesave publike. Përdorimi i instrumentave të teknologjisë së informacionit (psh një aplikacion në telefonin mobile të qytetarit) do të lehtësonte aksesimin ‘Transparenca e Buxhetit’ dhe informimin për qytetarët.

**Përmirësimi ka patur llogaridhënia e pushtetit vendor** lidhur me normën e kthim-përgjigjeve të administratës vendore ndaj kërkesave të qytetarëve. Treguesi ka rritje në 2021 në krahasim me vitin 2020. Rreth 43% e bashkive kanë një normë të kthim-përgjigjeve mbi 95%, ndërsa treguesi mbi publikimin e akteve të organeve vendimmarrëse është ulur në krahasim me vitin 2020. Gjithashtu, NJVV kanë treguar përmirësim për sa i përket shqyrtimit të raporteve dhe rekomandimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sfida mbeten forcimi i bashkëpunimit ndërmjet agjencive shtetërore në nivel rajoni dhe institucioneve vendore për adresimin e çështjeve të rekomanduara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe shqyrtimi i çdo raporti e rekomandimi nga drejtoritë dhe strukturat përkatëse të NJVV, brenda afateve të përcaktuara ligjore.

**Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë marrë më pak raporte dhe rekomandime nga Avokati i Popullit**, në vitin 2021, gjithsej 412 raporte, ose mesarisht 12 raporte, ndërsa norma e shqyrtimit dhe pranimit të raporteve të Avokatit të popullit (84%), ka qenë më e lartë në krahasim me vitin 2020. Bashkia e Tiranës ka marrë numrin më të lartë të raporteve.

Sfida mbeten eliminimi i vonësve nga NJVV në shqyrtimin e raporteve dhe rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit dhe forcimi i bashkëpunimit për qartësimin e kompetencave dhe referimin e rasteve në kohë. Rekomandohet forcimi i rolit të koordinatorëve për të drejtën e informimit brenda autoriteteve publike duke emëruar zyrtarë të lartë në këtë pozicion<sup>9</sup>, si dhe rritja e transparencës ndaj publikut lidhur me zbatimin e rekomandimeve nëpërmjet publikimit të rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit në faqen zyrtare të bashkisë.

<sup>8</sup> Progres Raporti për Shqipërinë i KE (Nëntor 2021)

<sup>9</sup> Progres Raporti i KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

**Konsolidimi i shoqërisë civile në nivel vendor mbetet një sfidë.** Ndonëse kuadri ligjor është përmirësuar me miratimin e ligjit për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse (qershor 2021), zbatimi i Udhërrëfyesit për një mjedis të favorshëm për shoqërinë civile kërkon më shumë përpjeke dhe burime. Në kuadër të financimit nga buxheti i shtetit, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile organizoi thirrjen nr.14 në vitin 2021, dhe mundësoi mbështetjen e 153 organizatave në fusha, si integrimi evropian, lufta kundër korrupsionit dhe edukimi ligjor i publikut, mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, zhvillimi i SME-ve, etj. Në vitin e raportimit, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë marrë më pak rekomandime nga organizatat e shoqërisë civile, por norma e shqyrtimit dhe pranimit të tyre nga organet vendimmarrëse është rritur në krahasim me vitet 2019-2020.

Sfida mbeten forcimi i angazhimit të rolit të shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes vendore, shtimi i organizatave Joqeveritare në bashkitë e vendit, rritja e financimit nga fondet e qeverisë dhe të NJVV-e për projekte në partneritet të përbashkët dhe rritja e transparencës nga ana e bashkive lidhur me publikimin e rekomandimeve të OSHC dhe reflektimin e tyre në vendimmarrjen vendore.

### Lufta kundër korrupsionit

**Lufta kundër korrupsionit vazhdon të jetë një sfidë e rëndësishme për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.** Sfidat kryesore janë të lidhura me: mungesën e kapaciteteve njëzëzore, burimet financiare të pamjaftueshme si dhe bashkëpunimi ndër-institucional i limituar.

**Forcimi i kapaciteteve të punonjësve të bashkive për çështjet antikorruption ka vijuar edhe gjatë 2021.** Përqindja e Bashkive që nuk kanë ndjekur trajnime në fushën e antikorruptionit mbetet e lartë në 50 % dhe në të njëjta nivele me vitin 2020. Megjithë përpjekjet e bëra për të institucionalizuar rrjetin antikorruption të pikave të kontaktit në nivel vendor ai ende nuk është kryer nga 14 Bashki.

**Numri i Bashkive që kanë ngritur regjistrin elektronik të kërkesave dhe ankesave në vitin 2021 ka pësuar rritje duke shkuar në 48** por progresi në ngritjen dhe përditësimin ndikohet negativisht nga mungesa e buxhetimit të fondeve për ngritjen dhe mirëmbajtjen e regjistrit elektronik. **Ka vijuar procesi i hartimit dhe miratimit të Planeve të Integritetit Vendor në kuadër të masave antikorruption** ndërkohë që planifikimi buxhetor për zbatimin e Planit të Integritetit mbetet i limituar.

**Bashkëpunimi midis qeverisjes qëndrore dhe vendore për zbatimin e masave antikorruption duhet të forcohet dhe të shtrihet në sektorë të rëndësishëm dhe me impakt në ekonomi** si prokurimet publike, administratën tatimore, transparencën në vendimmarrje si dhe konflikti i interesit.

### Të drejtat e njeriut

**Progres i limituar është bërë në drejtim të rritjes së kapaciteteve të nëpunësve vendor mbi çështjet e të drejtave të njeriut.** Vetëm 40% e bashkive kanë përfituar trajnime në vitin 2021 për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve publikë vendorë për zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut. Numri i trajnimeve mbetet pothuaj në të njëjtat nivele me 2020 dhe 2019 ndërkohë që rastet për shkelje të drejtave të njeriut kanë ardhur në rritje.

**Ka vazhduar bashkëpunimi me OSHC për të trajtuar rastet e referuara për shkelje të të drejtave të njeriut në nivel vendor edhe në vitin 2021 ku shënohen 2 herë më shumë raste të trajtuara për Bashki.** Raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut në 2020 janë referuar në total 2.5 herë më shumë se në vitin 2020. Megjithatë mbetet ende problematikë mungesa e OSHC të specializuara dhe të licensuara në bashkitë e vogla.

## KRITERI EKONOMIK .....

### Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

**Nxitja e zhvillimit ekonomik dhe rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë vendore ka vijuar të jetë në vëmendjen e Bashkive përmes hartimit dhe miratimit të planeve vendore të zhvillimit.** Në vitin 2021 janë

54 Bashki që kanë miratuar një Plan Vendor Zhvillimi për të orientuar vendimarrjen drejt prioritetëve lokale dhe siguruar një zhvillim të qëndrueshëm. Sfidë vazhdon të mbetet zbatimi i planeve vendore dhe pamjaftueshmëria e buxheteve të bashkive për tju përgjigjur nevojave të mëdha për projekte strategjike zhvillimore.

**Progres është shënuar në përmirësimin e kuadrit Strategjik dhe Ligjor për nxitjen e krijimit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) duke rritur kapacitetet teknologjike.** Megjithë efektet nga Pandemia e COVID 19, në ekonominë lokale edhe në 2021 janë ndërmarrë disa iniciativa për të zvogëluar impaktin negativ tek biznset përmes lehtësirave fiskale të ofruara në një numër të madh të bashkive. **Kapacitetet njerëzore dhe financiare të Bashkive për të mbështetur me aktivitete dhe financime direkte për krijimin e bizneseve të reja mbeten shumë të ulta dhe të përqëndruara te bashkitë e mëdha.**

**Janë bërë përpjekje nga një pjesë e bashkive për të orientuar dhe këshilluar NVM-të mbi mundësitë dhe potencialet për zhvillim duke i orientuar drejt tregut.** Në vitin 2021 janë raportuar 186 shërbime në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të kryera nga vetëm 38% e bashkive. **Hapja e bizneseve të reja ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021.** Numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që kanë filluar aktivitetin në territorin e bashkive ka patur një rritje prej 40% krahasuar me vitin 2020. Ndërveprimi më i mirë i strukturave të bashkive me bizneset si edhe lehtësimi i aksesit në informacion është një nga gjetjet në raportin e monitorimit të vitit 2021 të Sekretariatit të Këshillit të Investimeve. Për këtë rekomandohet ngritja e një seksioni të dedikuar për bizneset në procedurat e ankimimit administrativ në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

## AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT .....

### Bujqësia dhe zhvillimi rural

Progres është kryer lidhur me krijimin e një regjistri fermash dhe krijimin e një sistemi identifikimi të parcelave të tokës (LPIS). Mungon rrjeti i të dhënave të kontabilitetit të fermave (FADN). Për politikën e cilësisë, progres është arritur me miratimin e legjislacionit zbatues të skemës tradicionale të garantimit të specialitetit dhe në sigurimin e vijueshmërisë së mbështetjes për bujqësinë organike<sup>10</sup>. U rrit mundësia e kreditimit nga Qeveria, e cila alokoi 1 miliard lekë në bankat e nivelit të dytë si Fond Sovran Garancie nga shteti për të financuar 50% të kolateralit për kredi në bujqësi.

NJVV kanë financuar më pak sektorin e bujqësisë krahasuar me vitin 2020 dhe 2019. Përmirësim është kryer me zgjerimin e Zyrave të Informacionit dhe të Këshillimit Bujqësor, të cilat kanë qenë funksionale në 41 bashki të vendit, por numri i përfituesve të mbështetur më shërbime nga ZIKB ka qenë në nivel të njëjtë krahasuar me vitin 2020.

Përsa i përket infrastrukturës rurale, evidentohet një ulje e lehtë e mirëmbajtjes së sistemit të rrjetit ujitës krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit, por ka patur përmirësim lidhur me mirëmbajtjen e kanaleve të kullimit. Për bashkitë, sfida mbeten rritja e financimit për sektorin e bujqësisë, eliminimi i stokut të prodhimeve bujqësore, mungesa e strukturave dhe stafeve në disa bashki, dhe e agronomëve të kualifikuar në njësitë administrative rurale.

**Rekomandohet** zgjerimi i aktiviteteve të këshillimit dhe trajnimit të ZIKB në të gjitha NJVV, ngritja e GVV /LAG në të gjitha bashkitë e vendit dhe operacionalizimi efektiv i tyre, hartimi i buxhetit vjetor të sistemit ujitës bazuar në nevojat, kërkesat e fermerëve si dhe në performancën e shërbimit.

### Politikat e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe fitosanitare

**Reforma e sektorit të veterinarisë është në proces zbatimi.** Progres është bërë në forcimin e kapaciteteve organizative dhe profesionale të veterinerëve për mbrojtjen e konsumatorëve, sigurinë ushqimore dhe

<sup>10</sup>Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

veterinare. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve nuk ka fituar ende kapacitet të plotë operacional. Nevojitet një politikë sektoriale koherente dhe përafrimi i acquis-it të BE-së mbi kontrollet zyrtare, shëndetin e kafshëve dhe shëndetin e bimëve. Legjislacioni është zgjeruar mbi rregullat e paketimit dhe disa udhëzime të Ministrisë për sigurinë ushqimore si dhe zhvillimi i një sistemi monitorimi të situatës epidemiologjike në nivel kombëtar<sup>12</sup>.

Në nivel vendor, progresi i lehtë është bërë me krijimin e 7 zyrave për mbrojtjen e konsumatorëve në NJVV për adresimin e rasteve të ankmuara nga qytetarët lidhur me sigurinë ushqimore. Më shumë ankesa nga qytetarët mbi sigurinë ushqimore janë regjistruar nga NJVV-e gjatë vitit 2021 krahasuar me një vit më parë, për të cilat bashkitë kanë marrë masat përkatëse në një nivel mesatar 79%.

Sfida për bashkitë mbeten krijimi i zyrave për mbrojtjen e konsumatorëve në të gjitha bashkitë, parashikimi i investimeve nga buxheti vendor për përmirësimin e infrastrukturës së tregjeve të shitjes me pakicë dhe tregjet e kafshëve në përputhje me standardet e shërbimit, fuqizimi i rolit monitorues të shërbimeve përkatëse të bashkisë përkundrejt funksionimit të tregjeve dhe rritja e ndëveprimit me strukturat e Agjencisë Kombëtare të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, AKU-së lidhur me sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

## Politikat e transportit

**Përmirësim është bërë në drejtim të rritjes së normës së përputhshmërisë me standartet e kodit rrugor të rrjeteve rrugore urbane dhe rurale, sinjalistikës të administruar nga NJVV në vitin e raportimit krahasuar me periudhën e mëparshme.** Gjithashtu është përmirësuar shkalla e konektivitetit të fshatrave ndërmjet tyre nëpërmjet mirëmbajtjes dhe ndërtimit të rrugëve për periudhën 2019-2021. Ndonëse ka patur përmirësim të disa treguesve të performancës për vitin e raportimit, financimi nga fondet e veta të NJVV për mirëmbajtje dhe ndërtim të rrugëve ka pësuar ulje krahasuar me vitin e mëparshëm.

*Përmirësim është bërë për publikimin e hartës të linjave të transportit publik dhe të lëvizjes së mjeteve të transportit publik në stacionet e autobusëve, rritjen e gjatësisë së rrjetit urban të dedikuar për lëvizje me biçikleta; rreth 50% e bashkive kanë investuar për ndërtimin dhe zgjerimin e rrjetit të korsisë së biçikletave.*

Mbeten sfida përmirësimi i kapaciteteve të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së rrjeteve rrugore dytësore dhe terciare, rritja e burimeve të financimit për investime e mirëmbajtje të rrugëve dhe përmirësimin e sinjalistikës.

## Energjia

**Bashkitë nuk kanë bërë progres në lidhje me zbatimin e politikës kombëtare për eficientë e energjisë, specifikiisht lidhur me caktimin e menaxherit për eficientë e energjisë dhe trajnimin e tij, si edhe hartimin e planit vendor të veprimit për eficientë e energjisë, në përputhje me Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën.** Në vitin 2021, ka patur rritje të konsiderueshme të projekteve të zbatuara sipas kërkesave të eficientës së energjisë në bashkitë e vendit krahasuar me 2020, por më pak kontrole janë kryer nga shërbimet përkatëse të bashkive lidhur me respektimin e kërkesave të eficientës së energjisë në ndërtesat private të banimit dhe në ndërtesat për shërbime publike dhe private sipas standardeve të përcaktuara në ligj.

Sfida të bashkive mbeten hartimi i planit vendor të veprimit për eficientë e energjisë, rritja e kapaciteteve në drejtim të prokurimeve të gjelbërta dhe menaxhimi i kontratave të shërbimeve bazuar në performancën e energjisë.

<sup>12</sup> Raport i Progresit të KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

## Taksat

Në sajë të përmirësimit të performancës në administrimin e taksave vendore janë rritur burimet financiare të bashkive gjatë vitit 2021. Të ardhurat e pushtetit vendor janë realizuar 21.5% më shumë se të ardhurat faktike në vitin 2020 duke arritur në nivelin 29,498,427 (mijë lekë).

Për disa tregues të performancës të sektorit, ka patur një trend zbritës, krahasuar me vitin 2020, dhe specifikisht më pak NJVV kanë miratuar programe të politikave tatimore që kanë për qëllim nxitjen e formalizimit të ekonomisë në territorin e bashkisë, më pak inspektime të kryera në terren dhe më pak dëgjesa publike të organizuara me grupet e interesit lidhur me konsultimin publik mbi politikën fiskale gjatë vitit të raportimit. Përmirësimi i lehtë është arritur lidhur me rritjen e numrit të bashkive që kanë funksionale databazën për debitorët, në 2021 krahasuar me 2020, por mbetet në nivel më të ulët krahasuar me vitet 2018 dhe 2019.

Sfida për shërbimet e taksave të bashkive, është përmirësimi i sistemit të administrimit të taksave vendore (dijitalizimi dhe unifikimi i sistemit për të gjitha bashkitë), informimi dhe ndërgjegjësimi për formalizimin e bizneseve dhe grumbullimi i të ardhurave nga tarifa dhe taksat vendore përkundrejt planifikimit dhe rritja e transparencës mbi performancën në administrimin e të ardhurave të pushtetit vendor.

## Politikat sociale dhe punësimi

**Shqipëria ka një kuadër të mirë Strategjik dhe Ligjor për Çështjet Sociale, Punësimin dhe Formimin profesional të harmonizuar edhe me standartet e BE-së.** *Ndryshimet në Kodin e Punës* futën më shumë masa për të mbështetur barazinë gjinore në tregun e punës, kryesisht të lidhura me ndërgjegjësimin dhe mbështetjen e fuqizimit ekonomik të grave në tregun e punës. *Për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, strategjia kombëtare për mbrojtjen sociale 2015-2020 u rishikua dhe u zgjat deri në vitin 2023.*

**Problematikat në zbatimin e politikave dhe legjislativës në nivel vendor janë të lidhura kryesisht me mungesën e kapaciteteve financiare dhe njërëzore në bashkitë.** Shpenzimet publike për programet e shërbimeve të kujdesit social janë ende të kufizuara dhe nuk ka një mekanizëm për monitorimin e situatës së kategorive që janë të më të cënueshëm dhe pa akses në shërbime të tilla. **Në vitin 2021 buxheti i bashkive i planifikuar për shpenzime të kujdesit social përbën mesatarisht 7% të buxhetit total të tyre.** Progres është shënuar në drejtim të rritjes së numrit të personave që dalin nga skema ekonomike dhe ri-integrimit në tregun e punës përmes formimit profesional apo bashkëpunimit me zyrat e punës duke sjellë në 2021 uljen e tyre me 50% krahasuar me vitin 2020.

**Hartimi dhe miratimi i planit vendor për përfshirjen sociale në vitin 2021 është bërë nga 93% e Bashkive.** Gjatë 2021 janë zhvilluar më shumë trajnime nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për nëpunës vendor mbi metodologjitë e matjes së treguesve të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale. Me gjithë trendin pozitiv në numrin e trajnimeve sërish kapacitetet e bashkive për të hartuar raportet e vlerësimit për nevojat sociale janë në nivele të ulëta. **Gjithashtu, ngritja e sektorit të vlerësimit të nevojave dhe referimit nuk është realizuar nga 50% e bashkive.**

**Baza statistikore për përfshirjen sociale është ngritur dhe bërë funksionale në 57 % të Bashkive.** Treguesi evidenton përmirësim të lehtë në krahasim me vitin 2020. Qeveria duhet të shtojë përpjekjet për të zbatuar sistemin e Menaxhimit të Informacionit për shërbimet e kujdesit social në të 61 bashkitë dhe ofruesit e shërbimeve sociale të licencuara jo publike, në mënyrë që të sigurojë raportim të saktë për përfituesit e shërbimeve të kujdesit social<sup>13</sup>.

## Politikat rajonale dhe koordinimi i instrumentave strukturorë

**Kanë vazhduar përpjekjet e Bashkive për të rritur bashkëpunimin rajonal dhe atë Evropian por sërish niveli i iniciativave të përbashkëta të ndërmarra mbetet i kufizuar. Rreth 40 % e Bashkive nuk raportojnë bashkëpunime apo pjesëmarrje në projekte të përbashkëta rajonale. Kapacitetet e bashkive për hartimin e**

<sup>13</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

projekteve dhe thithjen e financimeve nga fondet e BE-së dhe donatorëve të tjerë me përfitues disa bashki mbeten ende të limituara dhe të varura nga partnerët e vendeve të rajonit apo ato evropianë.

**Hap pozitiv shënoi miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 459 datë 30.07.2021 “Për përcaktimin e rajoneve të zhvillimit dhe kufijve të tyre” në zbatim të ligjit nr.102/2020 “Për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin”** i cili synon të definojë kuadrin insitucional për të siguruar zhvillimin e balancuar rajonal të vendit. Me qëllim menaxhimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikës së zhvillimit rajonal dhe kohezionit, territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në katër zona/rajone zhvillimi. Sipas përcaktimit të ligjit rajonet e zhvillimit janë territoret për të cilat hartohet, zbatohet dhe vlerësohet politika kombëtare për zhvillimin dhe kohezionin rajonal.

**Për një politikë rajonale të suksesshme tashmë Shqipëria duhet të vazhdojë me hartimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Zhvillimin dhe Kohezionin Rajonal (2021-2027) dhe Planet e Zhvillimit Rajonal (2021-2024)** me qëllim që të nxisin potencialin e zhvillimit të të gjitha rajoneve në Shqipëri dhe për t'u ofruar atyre mundësi që të vazhdojnë me ndërhyrje të decentralizuara bazuar në plane dhe strategji të integruara lokale dhe/ose rajonale<sup>14</sup>.

## Gjyqësori dhe të drejtat themelore

**Progres është shënuar në hartimin e një kuadri strategjik dhe ligjor që garanton të drejtat themelore të harmonizuar me standartet e BE-së dhe Konventat Ndërkombëtare.** Çështjet e fëmijëve, pakicave etnike, të barazisë gjinore dhe personave me aftësi të kufizuara kanë qënë në fokus të politikave në nivel qendror dhe vendor.

**Edhe në vitin 2021 kanë vazhduar përpjekjet e bashkive për të ngritur Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve** si dhe për të krijuar sistemin për monitorimin e rasteve për shkelje të të drejtave të fëmijëve. **Sfidë mbeten kapacitetet njëzore të pamjaftueshme për të menaxhuar rastet si dhe burimet financiare shumë të limituara. Në 2021 bashkitë kanë alokuar mesatarisht 5.2% të buxhetit për rastet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.** Megjithatë treguesi ka pësuar rritje nga vitet e kaluara ai sërish mbetet në nivele të ulëta në krahasim me nevojat e bashkive për të trajtuar të gjitha rastet.

Përsa i përket zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi, progres është shënuar me hartimin e “Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI+, 2021 - 2027”. **Megjithatë roli i bashkive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komunitetit LGBTI+ në nivel vendor si dhe bashkëpunimi me Organizatat e Shoqërisë Civile mbetet ende i kufizuar.**

Progres është shënuar **në rritjen e raportimeve për rastet e dhunës** në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përmes sistemit REV-ALB. Gjithashtu ka vijuar me ritme të kënaqshme **krijimi dhe funksionimi i Njësive së Barazisë Gjinore si dhe emërimi i nëpunësit vendor në kapacitetin e koordinatorit lokal për çështjet gjinore. Buxheti me bazë gjinore i politikave vendore mbetet ende larg kërkesave dhe standarteve ndërkombëtare për një politikë me ndjeshmëri gjinore.**

**Nuk ka progres për rritjen e aksesit të personave me Aftësi të Kufizuara në infrastrukturën bashkiake si dhe në institucionet publike.** Sërish numri i shkollave të sistemit para-universitar që kanë infrastrukturë të aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe mbetet i ulët. **E njëjta situatë problematike paraqitet në sigurimin e infrastrukturës së aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara në qendrat historike dhe kulturore në disa Bashki.**

## Drejtësia, liria dhe siguria

**Strategjia Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2022 kanë shtuar sfidat e pushtetit vendor për luftën ndaj krimit dhe rritjen e sigurisë në komunitet.** Qasja e re për sigurinë është reflektuar në Strategjinë Ndër-sektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026, e cila synon përmirësimin e parametrevave të sigurisë në komunitet duke rritur ndërveprimin e strukturave policore me komunitetin, përmes metodave proaktive për parandalimin dhe zbulimin e veprave penale. Strategjia bazohet

<sup>14</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

në rritjen e bashkëpunimit me aktorët institucionalë qendrorë dhe vendorë, qytetarët dhe komunitetin, institucionet e tjera jo qeveritare, bizneset, institucionet fetare, media etj, për të krijuar një kulturë të re të sigurisë publike gjithëpërfshirëse.<sup>15</sup>

**Ngritja dhe funksionimi i strukturave të parashikuara në Strategji si dhe në kuadrin ligjor në nivel vendor ka vazhduar me ritme të moderuara.** Grupi i punës për zbatimin e Planit të Veprimit për luftën kundër krimit të organizuar në nivel vendor është krijuar në 48% të bashkive. Këshilli i Sigurisë Vendore, një mekanizëm në luftën kundër krimit të organizuar, është ngritur në 75% të Bashkive. **Hartimi dhe miratimi i Strategjisë për Sigurinë Publike në nivel vendor mbetet në të njëjtat nivele nga vetëm 62% e bashkive.**

**Prioritet mbetet krijimi i besueshmërisë dhe rritja e sigurisë së komunitetit përmes policimit në komunitet. Në 2021 ngritja e Zyrës së Policimit në komunitet në secilën njësi administrative raportohet me një mesatare prej 40.6 %.** Disa nga prioritetet e identifikuar nga Policia e Shtetit në raportin e monitorimit të vitit 2021 të Ministrisë së Brendshme janë: (i) Identifikimi i zonave me risk të lartë dhe prioritare, dhe angazhimi me projekte pilot për policimin në komunitet. (ii) Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të policimit në komunitet dhe të pikave kufitare rreth tendencave të radikalizimit, metodave të rekrutimit, radikalizimit në internet dhe mekanizmave të referimit të problematikës; (iii) Kryerja e fushatave ndërgjegjësuese të policisë në zonat me rrezik të lartë për të promovuar policimin në komunitet dhe rolet e tyre për komunitetin (e parë kjo në këndvështrimin gjinor).

## Arsimi dhe Kultura

**Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj shënon një moment të rëndësishëm për avancimin e reformës në arsim përfshirë dhe arsimin bazë dhe atë parashkollor.** Në kuadër të procesit të decentralizimit të kompetencave të pushtetit qendror tek ai vendor, arsimi parashkollor është ndër funksionet e fundit të decentralizuara drejt njësisive të pushtetit vendor. Bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe janë funksione të bashkisë.

**Sfidë mbetet buxheti i kufizuar i bashkive për të investuar në infrastrukturën e kopshteve dhe shkollave.** Në vitin 2021 fondi i alokuar nga buxheti vendor për rindërtimin e kopshteve ekzistuese ose ndërtimin e kopshteve të reja është mesatarisht 2.7 % dhe mesatarisht 3.1 % e fondit të investimit vendor është alokuar për ndërtimin e shkollave të reja dhe rikonstrukcionin e shkollave ekzistuese.

**Kanë vazhduar përpjekjet e bashkive për të parashikuar infrastrukturën e nevojshme për Personat me Aftësi të Kufizuar** në projektet për rindërtimin dhe ndërtimin e shkollave. Në vitin 2021 parashikimi i infrastrukturës PAK është bërë nga 78% e bashkive.

**Roli i Bashkive në ruajtjen dhe promovimin e kulturës dhe trashëgimisë kulturore ka ardhur në rritje.** Me gjithë situatën e vështirë financiare dhe kufizimeve të pandemisë COVID 2019, bashkitë kanë organizuar një numër të konsiderueshëm aktvitetesh kulturore më fondet e tyre. Mesatarisht 7.64 % e buxhetit të bashkive është akorduar për aktivitete kulturore dhe për promovimin e trashëgimisë kulturore në vitin 2021.

**Sfidë mbetet ruajtja dhe mirëmbajtja e objekteve të trashëgimisë kulturore. Rritja e ndërgjegjësimit të banorëve dhe bashkëpunimi i ngushtë me strukturat e policisë dhe institucionet e tjera qendrore për parandalimin dhe dënimin e rasteve të shkeljeve është i një rëndësie të veçantë.** Gjatë vitit 2021 rastet e shkeljeve dhe ndërtimeve të paligjshme në zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore kanë ardhur në ulje në vetëm 12 të tilla në katër Bashki të vendit. Hartimi i planeve për mbrojtjen dhe zhvillimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si dhe alokimi i buxheteve për investime dhe mirëmbajtje është një problematikë që kërkon adresimin e duhur dhe të qëndrueshëm.

<sup>15</sup> Raporti monitorimit 6-mujor 2021, Ministria e Brendshme

## Mjedisi dhe ndryshimet klimatike

**Kanë vazhduar përpjekjet e Bashkive për të siguruar zbatimin e legjislacionit në fushën e mjedisit dhe klimës si dhe rritjen e njohurive të stafëve lokale mbi standartet e BE-së në këtë sektor.** Problematikat e mbartuara në vite dhe abuzimet me mjedisin vazhdojnë të mbeten prezente në një pjesë të madhë të territorit të vendit. Kjo situatë ka shtuar nevojën për më shumë fonde dhe projekte afatgjata për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit përmes një zhvillimi të qëndrueshëm.

**Lidhur me menaxhimin e Integruar të mbetjeve, kapacitetet e bashkive për mbledhjen dhe ndarjen në burim mbeten të kufizuara.** Roli i bashkive për monitorimin e zbatimit efektiv të shërbimit të ofruar nga kontraktorë të jashtëm për pastrimin duhet të forcohet si dhe të rritet shkalla e ndërgjegjësimit qytetar në mbrojtje të mjedisit. Mbyllja e shumë vend-depozitimeve të papërshtatshme mbetet problematikë edhe në vitin 2021.

**Progres të ngadaltë ka patur përsa i përket hartimit të planit të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe marrjen e masave për zbutjen e rreziqeve të ndryshimit të klimës.** 80 % e bashkive sërisht nuk kanë një plan vendor veprimi për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Niveli i pjesëmarrjes së bashkive në trajnime mbi zbatimin e masave të politikave kombëtare për ndryshimet klimatike ka qenë pozitiv. Bashkitë kanë organizuar 40% më shumë fushata ndërgjegjësimi në vitin 2021 në mbrojtje të mjedisit dhe minimizimin e ndotjes në bashkëveprim më aktorë të tjerë vendorë dhe OSHC.

**Progres i ulët është bërë në hartimin e planeve vendore për administrimin e pyjeve.** Njësitë e Qeverisjes Vendore kanë detyra të rëndësishme që lidhen me administrimin e fondit pyjor vendor të tilla si hartimi i strategjive, planin e menaxhimit për fondin pyjor, programin e zhvillimit të sektorit dhe planin e mbarështimit të pyjeve vendore. **Në raportin e progresit të BE të viti 2021 theksohet nevoja që Shqipëria duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve për pyjet, prerjet e pyjeve dhe të ndjekë penalisht shkelësit dhe zjarrvënësit.**

**Investimet në rrjetin e ujësjellës kanalizimeve sërisht hasen me problematika si ndërhyrjet e paligjshme, mirëmbajtja e pamjaftueshme, rrjeti i pazhvilluar i kanalizimeve dhe lidhjet shtëpiake e të bizneseve.** Nevojë urgjente mbetet investimi në rrjetin e kanalizimeve dhe impiantet e trajtimit të ujërave të zeza. Sipas Raportit të Progresit të BE 2021, Shqipëria duhet të përforcojë dhe përshtepojë më tej masat e reformës së ujit për të rritur performancën dhe qëndrueshmërinë e shoqërive dhe nivelin e shërbimit të ofruar për të gjithë qytetarët.

**Progres domethënës është bërë në ngritjen e Shtabit të Emergjencës Civile dhe strukturës së emergjencave civile. Në vitin 2021, raportohet se 97% e bashkive kanë ngritur shtabin dhe strukturën e emergjencave civile.** Megjithatë sipas edhe raportit të progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021 kapacitetet administrative, infrastruktura dhe sistemet për paralajmërim të hershëm, parandalim, gatishmëria dhe reagimi janë ende të pamjaftueshme.

## Kontrolli Financiar

Ndonëse ekziston një kornizë strategjike për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik (KBFP), përgjegjësia menaxheriale nuk është ende plotësisht e sanksionuar në legjislacion dhe praktikën administrative. NJVV mbeten institucionet më të dobta përsa i përket funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm<sup>16</sup>.

Të ardhurat nga pushteti vendor janë rritur në vitin 2021, duke zënë një peshë 1.67% të PBB. Rritje kanë patur edhe shpenzimet e pushtetit vendor. Rreth 29% e bashkive kanë rritur stokun e detyrimeve të prapambetura. Praktika jo të mira me pasojë dëm ekonomik lidhur me administrimin e të ardhurave dhe menaxhimin jo të kujdesshëm të fondeve publike, si dhe inefiçenca në realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe në zbatimin e punimeve sipas kontratave të nënshkruara janë evidentuar në disa bashki të vendit<sup>17</sup>.

Sfida janë rritja e burimeve të financimit nëpërmjet rishikimit të politikave vendore fiskale, realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve sipas planit, likuidimi i borxhit dhe shmangia e krijimit të borxheve të reja. Gjithashtu, është i nevojshëm forcimi i zbatimit të rregullave dhe procedurave për menaxhimin e financave

<sup>16</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Nëntor 2021), kapitulli 32 (Kontrolli Financiar)

<sup>17</sup> Raport i KLSH (2021)



publike në nivel vendor, rritja e cilësisë së raportimit dhe të transparencës mbi ekzekutimin e buxhetit, duke përfshirë jo vetëm performancën financiare por edhe performancën mbi arritjen e objektivave dhe rezultateve, si dhe rritja e kapaciteteve në drejtim të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

**Duhet theksuar se nivelet e bashkive për mbajtjen e statistikave në mënyrë të unifikuar dhe sistematike mbetet problematike. Zyrat e Performancës që pritet të ngrihen në bashki duhet të sigurojnë edhe grumbullimin dhe mbajtjen sistematike të të dhënave për të gjithë treguesit e performancës.**

## HYRJE

Ky është raporti i pestë kombëtar i vlerësimit të arritjeve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) në funksion të procesit të integrimit evropian në nivel vendor dhe në fushat kryesore të cilat lidhen me kriterin politik, kriterin ekonomik dhe aftësinë për të realizuar detyrimet e anëtarësimit të Shqipërisë.

Monitorimi i performancës mbi bazën e analizës së treguesve për sektorë dhe fusha të ndryshme, përfshijnë demokracinë vendore, qeverisjen, shtetin e së drejtës, administratën publike, zbatimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit, të drejtat e njeriut, ekzistencën e ekonomisë së tregut funksionale dhe aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit në fusha specifike, të tilla si bujqësia dhe zhvillimi rural, siguria ushqimore, politikat e transportit, energjia, taksat, gjyqësori dhe të drejtat themelore, arsimi dhe kultura, mjedisi dhe ndryshimi i klimës, financat vendore dhe kontrolli financiar. Ky raport analizon informacionin për treguesit për vitin e raportimit 2021 duke bërë një krahasim për disa tregues të performancës me vitet 2017 – 2021. Të dhënat e raporteve të vlerësimit duke filluar nga viti 2018 publikohen në faqen e internetit të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, si dhe on-line në adresën <https://mapping-bpe.al/goDataAnalyze/online.aspx>.

Në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore 2015-2020, u miratua në 2020 plani i veprimit 2020-2022<sup>18</sup> i cili planifikoi masa dhe aktivitete me qëllim arritjen e objektivave strategjike/dhe objektivave specifike, lidhur me i) Konsolidimin e kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore, (ii) Forcimin e financave vendore, (iii) Promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm vendor, dhe (iv) Forcimin e qeverisjes së mirë në nivelin vendor<sup>19</sup>.

### Metodologjia dhe Sistemi i të dhënave

#### **Burim parësor i të dhënave në analizën e raportit janë të dhënat e plotësuara nga NJVV për vitin 2021.**

Raporti i Vlerësimit të NJVV në procesin e integrimit evropian për vitin 2021 mbulon të 61 bashkitë bazuar në të dhënat e raportuara nga Njësitet e Integrimit Evropian në bashki, nëpërmjet Sistemit On-Line të Raportimit për më shumë se 240 tregues sipas fushave kryesore të tre kriterëve të anëtarësimit. Duhet theksuar se shkalla e plotësimit të treguesve ndryshon ndërmjet bashkive. Saktësia e të dhënave të raportuara është përgjegjësi vetëm e bashkive.

Krahas të dhëna të analizuara nga informacioni i hedhur në Sistemin On-Line të Monitorimit të Performancës, raporti është pasuruar edhe me të dhëna dytësore bazuar në rishikimin e ligjeve dhe akteve nën ligjore të miratuara gjatë 2021, mbi bazën e të cilave NJVV kanë rol dhe detyra specifike, si dhe rishikimin e dokumenteve strategjike dhe raporteve të monitorimit të ministrive të linjës për vitin 2021, Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021), të dhëna nga INSTAT (ndonëse statistikat jepen në nivel qarku dhe jo në nivel bashkie).

<sup>18</sup> Vendim nr. 783, datë 07.10.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të veprimit 2020–2022, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020

<sup>19</sup> Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SNDQV), 2015–2020

Raporti bën një analizë krahasuese ndërmjet bashkive sipas fushave të ndryshme, dhe identifikon praktikën e mira, problemet dhe sfidat në realizimin e politikave vendore në përgjigje të sfidave të zhvillimit kombëtar, politikave sektoriale dhe agjendës së integrimit evropian.

Raporti jep të dhëna të llogaritura për shumën, mesataren ose numërimin për tregues të ndryshëm për të cilat janë ofruar të dhëna të vlefshme. Treguesit janë të matshëm (numerike, ose të shprehur në përqindje), afirmative për disa objektiva dhe prioritete që lidhen me zbatimin e politikave të qeverisë qendrore në nivel vendor dhe në kuadër të procesit të anëtarësimit. Treguesit prezantojnë situatën në secilën bashki sipas kriterëve të vlerësimit dhe përkundrejt standarteve (ku ka qene e mundur). Bashkitë, që nuk kanë ofruar të dhëna për ndonjë tregues të veçantë, janë paraqitur në hartë ( në ngjyrë gri) ose me shpjegime në fund-shënime. Të dhënat e kapitullit të financave vendore / dhe kontrollit financiar janë siguruar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

**Duhet theksuar se nivelet e bashkive për mbajtjen e statistikave në mënyrë të unifikuar dhe sistematike mbetet problematike. Zyrat e Performancës që pritet të ngrihen në bashki duhet të sigurojnë edhe grumbullimin dhe mbajtjen sistematike të të dhënave të vlerësimit.**

**Gjithashtu bashkitë duhet të pajisen me sisteme on-line të mbajtjes së të dhënave për të siguruar cilësinë e tyre, saktësinë e të dhënave historike për treguesit që Bashkia grumbullon e raporton. Mbajtja e sistemeve on-line të të dhënave do të eliminonte gabimet në raportimet e të dhënave krahasuese sipas viteve.**

1

# KRITERI POLITIK

*Qëndrueshmëria e institucioneve  
që garantojnë demokracinë,  
shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut  
dhe respektimin e mbrojtjen e pakicave*

## 1.1. DEMOKRACIA

### 1.1.1. Qeverisja

“Qeveria shqiptare ka ruajtur fokusin në reformat në rrugën e vendit drejt BE-së, pavarësisht sfidës për të ulur ndikimin negativ social dhe ekonomik të krizës COVID-19 dhe pasojat e tërmetit të nëntorit 2019. Koordinimi brenda administratës duhet të përmirësohet, veçanërisht në lidhje me përfshirjen e tyre në proceset integruese në BE. Reforma administrative territoriale duhet të konsolidohet më tej si pjesë e axhendës më të gjerë të decentralizimit. Kjo është veçanërisht e nevojshme për të garantuar autonominë fiskale lokale dhe për të fuqizuar bashkitë që të ofrojnë shërbime publike me cilësi të mirë standard”<sup>20</sup>.

Masat të cilat kanë qenë në fokus të planit të veprimit të zgjeruar 2020-2022 të strategjisë ndërsektoriale për decentralizim dhe vetëqeverisje vendore (SKNDQV) përfshijnë: i) zgjerimin e rrjetit të zyrave me Një Ndalesë në Njësitë Administrative (NJA), ii) rritjen e kapaciteteve institucionale të bashkive me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike, iii) forcimin e dialogut mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, iv) krijimin e sistemit të standardizuar të të dhënave vendore për një vendimmarrje të informuar, v) rimëkëmbje financiare e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimi i ujrave të ndotura; forcimi i kompetencave rregullatore dhe administrative të bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit, shërbimeve sociale, arsim parashkollor, bujqësi dhe zhvillim rural, pyje dhe kullota; vi) harmonizimi i bazës ligjore me akte nënligjore nga ana e ministrive të linjës sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore për funksionet e deleguara tek NJVV, vii) hartimi dhe përditësimi i standarteve minimale kombëtare për disa fusha prioritare, si siguria (policia bashkiake), bujqësia, emergjencat civile, viii) hartimi i planeve të integritetit.

Duke u nisur nga një sërë pengesash ligjore dhe institucionale në ekzekutimin efektiv të funksioneve, pas delegimit të funksioneve të reja në 2015, Ministria e Brendshme, me mbështetjen e Delegacionit Evropian në Shqipëri, ndërmoi një studim "Matrica e Kompetencave", në identifikimin konkret të hapësirave ligjore dhe përplasjeve të ligjit organik 139/2015 (Për Vetëqeverisjen Vendore" me ligje të tjera sektoriale për funksionet e pushtetit vendor. Në vijim, me miratimin e një sërë rekomandimesh që vinin nga studimi i sipërcituar në Urdhrin e Kryeministrit 101/2019 u arrit të implementoheshin nga Ministrinë e Linjës më shumë se 90% e rekomandimeve.

Në vijim, në vitin 2021 Ministria e Brendshme përditësoi rekomandimet ligjore duke adresuar rekomandimet me fushën e përgjegjësisë së institucioneve përgjegjëse, ashtu edhe përditësoi rekomandimet ligjore me ndryshimet e fundit të bazës ligjore dhe prioriteve të Qeverisë.

Në këtë këndvështrim, bazuar në listën e rekomandimeve të Matricës së Kompetencave për vitin 2021 dhe përlllogaritjen e paraqitur në tabelën e mëposhtme, shkalla e zbatimit, përkatësisht niveli i harmonizimit ligjor për vitin 2021, është 58%. Shkalla e përgjithshme e zbatimit llogaritet si raport i numrit të përgjithshëm të akteve ligjore të miratuara ndaj numrit total të akteve ligjore të rekomanduara pa përfshirë aktet e përcaktuara në Urdhrin e Kryeministrit nr. 101, datë 03.07.2019<sup>22</sup>.

Ndërkohë që bashkive u janë dhënë kompetenca më të mëdha për politikbërje, ende u mungojnë burimet e mjaftueshme financiare dhe kapacitetet administrative për t'i ushtruar ato në mënyrë efektive<sup>23</sup>.

*Objektivi specifik: Përmirësimi i koordinimit të qeverisë qendrore dhe vendore nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit efektiv të Këshillit Konsultativ*

“Këshilli Konsultativ ka funksionuar si forumi kryesor për dialogun institucional dhe koordinimin ndërmjet qeverisë qendrore dhe qeverive vendore. Efikasiteti dhe efektiviteti i punës së tij duhet të forcohet më tej.

<sup>20</sup> Raport i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Nëntor 2021)


<sup>22</sup> Ministria e Brendshme (2022) Raporti i Monitorimit për vitin 2021

<sup>23</sup> Raport i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Nëntor 2021)

Vijon procesi i zbatimit të urdhrat të kryeministrit për ‘matricën e kompetencave’ që shqyrton përgjegjësitë ndërmjet dy nivele të qeverisjes<sup>24</sup>.

Në 2021, Këshilli Konsultativ organizoi 6 takime në të cilat janë diskutuar projektakte të fushave të ndryshme. Përpjekje janë bërë në drejtim të rritjes së transparencës të aktivitetit lidhur me shqyrtimin dhe konsultimin e projektakteve ligjore që impaktojnë vetëqeverisjen vendore. U paraqitën gjithsej 52 projektakte, por janë shqyrtuar dhe konsultuar 43 akte nga të cilat 3 projektligje, 39 projektvendime dhe 1 udhëzim (3 projektligje janë miratuar).



Grafiku 1: Numri i akteve ligjore të miratuara që kanë kaluar procedurën e konsultimit në KK, 2017-2021



Disa nga projektaktet ligjore të konsultuara në KK kanë qenë: Projektligji për ndërmarrjet mikro, të vogla e të mesme, për Policinë Bashkiake dhe për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 10112/2008 “Për administrimin e bashkëpronësisë së ndërtesave të banimit”, ndërsa janë diskutuar në KK edhe disa dokumenta të rëndësishme politikash në fushën sociale, si “Agjenda kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2021-2026”, “Plani kombëtar i veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje të romëve dhe egjiptianëve në RSH 2021-2025, plani kombëtar i veprimit për personat LGBTI 2021-2027, si dhe projektvendime të tjera si projekt vendimi për treguesit statistikore të vlerësimit të ndihmës ekonomike të pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore; projektvendimi mbi miratimin e Metodologjisë për Përcaktimin e Vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ‘ndërtesa’, dhe udhëzimi përkatës, për Krijimin, Përbërjen, Organizimin, Veprimtarinë dhe Rregullat e Funkionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin, dhe disa projektvendime në fushën e menaxhimit të mbetjeve, pyjeve dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në rast të fatkeqësive natyrore.

Institucionet qendrore që kanë paraqitur më shumë projektakte, të cilat janë diskutuar në Këshillin Konsultativ janë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ndërkohë që numri i iniciativave për ndryshime ligjore të propozuara nga NJVV mbetet në nivele shumë të limitura.

Grafiku 2 : Projekt-akte ligjore të inicuar nga Qeverija Qëndrore dhe të diskutuara në KK, 2021<sup>25</sup>



<sup>24</sup> Raport i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Nëntor 2021)


<sup>25</sup> Burim: AMVV

**Niveli i përfaqësimit të Qeverisë Qëndrore** në konsultimet në Këshillin Konsultativ: në takimet e KK kanë qenë të pranishëm, mesatarisht, rreth 66% e ministrive të linjës. Nga 11 ministri që përfaqësohen në Këshillin Konsultativ, 3 ministri (ose 27%) kanë qenë të pranishëm në të gjitha takimet; 2 ministri kanë qenë të pranishëm në 5 takime, ndërsa 6 ministri kanë qenë të pranishëm në 1 deri 2 takime të KK.

Niveli i përfaqësimit të ministrive në Këshillin Konsultativ ka qenë: 1 ministri është përfaqësuar me Ministrin, 3 ministri janë përfaqësuar me Zv. Ministrin dhe 7 ministri me përfaqësues të niveleve më të ulta hierarkike. Ndonëse niveli i përfaqësimit të ministrive nuk është në nivelin e duhur (është më i ulët përkundrejt kërkesave ligjore), vihet re se niveli i përfaqësimit është rritur në 66% në 2021, në krahasim me 40% në vitin 2020.

**Edhe përfaqësimi i qeverisjes vendore nuk ka qenë në nivele të larta:** 7 bashki kanë qenë të pranishëm në të gjitha takimet e KK. Shkalla e pjesëmarrjes së bashkive ka ndryshuar nga 3 në 30 bashki në takimet e ndryshme të KK gjatë vitit 2021. Vetëm 10% e bashkive janë përfaqësuar me Kryetarin e Bashkisë, ndërsa të tjerat me nivele më të ulta përfaqësimi.

Grafiku 3: Numri i mbledhjeve të KK 2017-2021



**Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore** përveç aktivitetit të saj të rregullt dhe rolit që ushtron si Sekretarit i Këshillit Konsultativ ka ofruar mbështetje gjatë 2021 për koordinimin e shumë aktiviteteve si pjesë e planeve dhe aktiviteteve të projekteve të financuara nga donatorë në mbështetje të forcimit të qeverisjes vendore, të tillë si STAR<sup>26</sup>, Bashkitë për Evropë<sup>27</sup> dhe Bashki të Forta<sup>28</sup>.

AMVV koordinon proceset e integrimit evropian në nivelin vendor nëpërmjet bashkëpunimit me rrjetin e Njësive të Integritimit Evropian në bashki.

Me mbështetje të projektit Bashki të Forta, Ministria e Brendshme dhe AMVV shpallën për herë të parë procesin e replikimit të **Konkursit të Praktikave të Mira**, Nëntor 2021-Qershor 2022 për 10 praktika të mira të Bashkive Elbasan, Shkodër, Dimal, Mirditë, Has, Tropojë, Kavajë, Lezhë dhe Maliq.

<sup>26</sup> Projekt i financuar nga disa donatorë – UNDP, BE, SDC, Qeveria Italiane dhe SIDA

<sup>27</sup> BpE – një projekt i financuar nga IPA (BE)

<sup>28</sup> BtF – një projekt i financuar nga SDC dhe zbatuar nga Helvetas

Harta 1: Konkursi i Praktikave të Mira (replikimi)



Burim: BtF / Helvetas (SDC); <http://praktikatemira.qeverisjavendore.gov.al/>

Për tre praktikave të përzgjedhura – ngritja e sistemit informatik për menaxhimin e të taksave vendore (praktika e Bashkisë Dimal), ngritja e grupeve vullnetare për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret (praktika e Bashkisë Has) dhe menaxhimi i mbetjeve (praktika e Bashkisë Lezhë), janë nënshkruar gjithsej 17 Memorandume Bashkëpunimi me bashkitë fituese për replikimin e praktikave, të cilat do të financohen me fondet e bashkive.

### Probleme dhe sfida .....

- Zbatimi i plotë i Urdhrit të Kryeministrit nr.101, dt: 03.07.2019, mbi sjelljen e akteve ligjore që prekin funksionet e pushtetit vendor për konsultim në Këshillin Konsultativ.
- Rritja e nivelit të përfaqësimit të qeverisë qendrore përkundrejt parashikimeve në ligj.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe kuptimi i rolit të Këshillit Konsultativ nga të 61 Kryetarët e Bashkive, për të siguruar pjesëmarrjen e tyre të plotë.
- Kapacitetet e NJVV për të ndërmarrë iniciativa për ndryshime ligjore nga vetë bashkitë për të adresuar problematikat e konstatuara në zbatimin e kuadrit ligjor ekzistues.

### Rekomandime .....

Disa nga rekomandimet mbeten të vlefshme edhe për këtë raportim:

- Efikasiteti dhe efektiviteti i punës së Këshillit Konsultativ duhet të forcohet<sup>29</sup>.
- Konsultimet me NJVV për çdo ndryshim ligjor që ndikon në vetëqeverisjen vendore duhet të iniciohen që në fillim të procesit për të ndihmuar që të kryhet një analizë më e plotë të ndikimeve social-ekonomike. AMVV duhet të mundësojë lehtësimin e analizës dhe të konsultimit me NJVV.
- AMVV duhet të ketë një qasje më proaktive për monitorimin se si janë reflektuar, në aktet e miratuara, rekomandimet e dhëna nga përfaqësuesit e NJVV, gjatë konsultimit në Këshillin Konsultativ. Për realizimin sa me efektiv të këtij roli, AMVV në rolin e Sekretariatit të Këshillit Konsultativ, duhet të fuqizohet me personel. Rekomandohet të ketë nëpunës të dedikuar dhe me njohuri të thella mbi aspektet ligjore, për të mundësuar analizën e akteve ligjore pas miratimit të tyre.
- Të rritet cilësia e diskutimeve dhe përfaqësimi i institucioneve të qeverisë dhe NJVV në takimet e Këshillit Konsultativ, sipas parashikimeve ligjore.

<sup>29</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Nëntor 2021)




## Ngritja e Zyrave me Një Ndalesë për Shërbimet Publike


**Objektivi specifik: qeverisja e hapur, llogaridhënia dhe qeverisja elektronike në nivel vendor**

Bazuar në një kuadër të qëndrueshëm të politikave Shqipëria ka ruajtur pozicionin në krye të vendeve të rajonit në fushën e ofrimit të shërbimeve dhe transformimit digjital duke tejkaluar mesataren e vendeve të rajonit. Pavarësisht pak mangësive në disa shërbime, norma e kënaqësisë së qytetarëve dhe bizneseve është rritur duke konfirmuar reformat e viteve të fundit. Rreth 95% e shërbimeve administrative janë të vlefshme online.<sup>30</sup>


Grafiku 4: Aksesueshmëria dhe mbulimi i territorit me shërbime publike dixhitale



Harta 2: Zyrat me Një Ndalesë 2021<sup>31</sup>



Grafiku 5: Zgjerimi i sistemit të ZNjN, 2017-2021




Në vitin 2021, harta e Zyrave me Një Ndalesë (ZNjN) në nivel bashkie është zgjeruar në të gjitha bashkitë e vendit (N=61). Bashkitë të cilat raportojnë për ngritjen e ZNjN gjatë 2021 janë Bashkitë e Hasit, Dibrës, Peqinit dhe Selenicë. Katër bashki kanë raportuar 'Jo'; Arsye mund të jetë mungesa e funksionalitetit të ZNjN gjatë vitit 2021.

Integrimi iOSSH në partneritet me ADISA ka vijuar duke mundësuar ngritjen e zyrave të integruara në Bashkitë Himarë dhe Tepelenë. Gjithshtu, në Bashkitë Has dhe Pustec filluan operimin Zyrave të Integruara iOSSH. Në sajë të zbatimit të reformës për modernizimin e Shërbimeve Publike dhe thjeshtimin e procedurave është **mundësuar zgjerimi i rrjetit të Zyrave me Një Ndalesë në nivel të njësisë administrative – norma mesatare e shtrirjes së tyre është rritur në 35% gjatë 2021 nga 26% që ishte në fund të vitit 2020** (N=59). Bashkitë e Dimalit, Pustecit, Belshit, Shkodrës, Beratit, Klosit, Kamzës, Elbasanit, Matit, Dropullit, Konispolit, Devollit, Vorës (gjithsej 13 bashki) kanë raportuar një normë të shtrirjes së ZNjN 100%, pra në të gjitha njësitë administrative të tyre, ndërsa 15 bashki kanë raportuar që nuk kanë funksionale ZNjN në njësitë e tyre administrative.

<sup>30</sup> SIGMA Raport monitorimi për Shqipërinë (Nëntor 2021); <https://www.idp.al/2021/12/22/raporti-i-monitorimit-per-shqiperine-nga-sigma-parimet-e-administrates-publike/>

<sup>30</sup> Burim i të dhënave është raportimi i bashkive

Grafiku 6: Norma e shtrirjes së ZNjN në Njësitë Administrative, 2021



Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021, STAR III ofroi mbështetje për zgjerimin e sistemit në 240 NJA (për tu kompletuar gjatë 2022). U krye një vlerësim i nevojave për mjete të IT në NJA të 50 bashkive, të cilat do të mbështeten financiarisht 50% nga bashkitë dhe 50% nëpërmjet STAR III (149 PCs dhe 155 printers/scanners u prokuruan në dhjetor 2021).

Deri në fund të dhjetorit 2021 nga 50 bashki me iOSSH 38 kanë një normë të kënaqshme shërbimi. Ndër arsytet që ndikojnë në mosfunksionimin e duhur të iOSSH janë mungesa e vullnetit nga stafi administrativ dhe politik i NJVV, mungesa e ambienteve dhe e infrastrukturës TIK, si dhe mungesa e burimeve njerëzore<sup>32</sup>.

Për pjesën më të madhe të bashkive numri i shërbimeve të ofruara nga ZNjN është midis 80-90 lloje të ndryshme të ofruara nëpërmjet ZNjN (numri mesatar - 89 shërbime). Bashkitë që raportojnë numrin më të madh të shërbimeve të ofruara janë Bashkia Dimal (360), Bashkia e Tiranës (278), dhe Bashkia e Elbasanit (176).

**Numri gjithsej i qytetarëve** që kanë aplikuar për shërbime në ZNjN gjatë 2021 ka qenë 82,746 (N=57). Krahasuar me vitin 2020 raportohen rreth 4620 më pak aplikime. Bashkitë me numrin më të lartë të aplikimeve janë Bashkia e Tiranës me 27,097 aplikime, Bashkia Shkodër me 12,497 aplikime, Bashkia Lezhë (7362) dhe Bashkia Elbasan (4616).

### Kutia 1: Sfida për zgjerimin e ZNjN në të gjithë territorin e Bashkisë

**Bashkia Berat dhe Himarë:** Funkionimi i sistemit elektronik edhe në katër njësitë administrative dhe në dy NJA të Bashkisë Himarë.

**Bashkia Devoll dhe Bashkia Diber:** Zgjerimi i ambienteve të pritjes për qytetarët, përmirësim i infrastrukturës së TI.

**Bashkia Kamëz:** Unifikimi në një sistem të vetëm elektronik të gjithë programeve lokale dhe qendrore për ZNjN.

**Bashkia Kolonjë:** Ngritja e ZNjN në NJA rurale dhe fuqizimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare.

**Bashkia Lezhë dhe Vau i Dejës:** Hapja e ZNjN në të gjitha Njësitë Administrative.

**Bashkia Rogozhinë:** Mungesa në buxhet për investime, mungesat në infrastrukturë dhe mosbesueshmëria e qytetarëve për këtë formë të ofrimit të shërbimeve.

**Bashkia Shkodër:** Ngritja e strukturave organizative, infrastrukturës fizike dhe TI, si dhe internet për të shtrirë ZNjN në të gjitha Njësitë Administrative.

<sup>32</sup> Raport STAR III (Qershor – Dhjetor 2021)

**Probleme dhe sfida**

Disa nga problemet dhe sfidat mbeten relevante edhe për periudhën e raportimit:

- Vijimi i shtrirjes në territor të ZNjN për të mundësuar ofrimin e shërbimeve në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkive.
- Rritja e numrit të llojeve (kategori) të shërbimeve administrative dhe publike që ofrohen nga ZNjN.
- Trajnimi i stafeve në ato bashki ku janë ngritur qendrat e integruara me nje ndalesë.
- Mbatjtja e të dhënave të sakta në mënyrë sistematike për treguesit e shërbimeve të ofruara nga ZNjN.

**Rekomandime**

- Parashikimi i fondit nga NJVV për të mbuluar koston e shtrirjes së ZNjN në Njësitë Administrative dhe ngritja e strukturës organizative përkatëse (kosto për mbulimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit, internetit, infrastrukturën e zyrave).
- Krijimi i një sistemi elektronik të integruar të ofrimit të shërbimeve në të gjitha NJVV.
- Zhvillimi dhe miratimi i standardeve minimale të shërbimeve publike.

**1.1.2. Rritja e Transparencës së Financave Vendore**

Edhe në kushtet e pandemisë, NJVV kanë inkurajuar pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen e tyre përmes organizimit të mbledhjeve të Këshillit online të hapura për publikun dhe mjeteve të tjera inovative. Megjithatë, kuadri institucional për pjesëmarrje efektive dhe gjithëpërfshirëse ekziston, është e nevojshme të fuqizohet më tej zbatimi i tij<sup>35</sup>.

Rritja e transparencës së financave vendore vlerësohet nga tre grupe treguesish: (i) përgatitja nga bashkia e buxhetit vendor për qytetarët, (ii) buxheti vendor i publikuar në faqen e internetit të bashkisë dhe në faqen [financatvendore.al](http://financatvendore.al) dhe (iii) rritja e transparencës.



Në 2021, Bashkitë kanë mbajtur aktive faqen zyrtare të bashkisë dhe programi i transparencës ka qenë funksional. Korniza rregullatore është përmirësuar përmes miratimit të udhëzimeve për përgatitjen e planeve vjetore të konsultimit publik. NJVV duhet të publikojnë të gjitha dokumentet si buxheti vjetor, buxheti i qytetarëve dhe një listë të investimeve publike të parashikuara në programin buxhetor të vitit korrent, si dhe raportin e ekzekutimit të buxhetit dhe detyrimet e prapambetura në veçanti.

Në 2021, 43 bashki (ose 70.5% e bashkive) kanë raportuar se kanë përgatitur buxhetin vendor në një format të kuptueshëm për qytetarët (në të njëjtin nivel më vitin 2020). Treguesi mund të jetë më i lartë por 13 bashki nuk kanë ofruar të dhëna për treguesin, si Bashkitë Durrës, Divjakë, Rogozhinë, peqin, Vlorë, Belsh, Poliçan, Memaliaj, Tepelenë, Delvinë dhe Finiq.

**Publikimi i buxhetit të bashkisë në faqen zyrtare të bashkisë** është kryer nga 51 bashki, ndërsa publikimi në faqen [financatvendore.al](http://financatvendore.al) është realizuar nga 45 bashki (ose 5 bashki më pak në krahasim me 2020), (N=59)


<sup>35</sup> Raport i Komisionit Evropian për Shqipërinë (Nëntor 2021)

Harta 3: Publikimi i buxhetit vendor për qytetarët Grafiku 7: Buxheti vendor i publikuar për qytetarët



Në nivel vendi janë organizuar gjithsej **404 dëgjesa publike** me qytetarët gjatë 2021, ose mesatarisht rreth 7 dëgjesa për bashki (N=61); treguesi është rreth 50% më i ulët se vlera e raportuar për vitin 2020).


Grafiku 8: Dëgjesa publike me qytetarët për buxhetin sipas NJVV, 2021



Bashkitë me numrin më të lartë të dëgjesave janë Elbasan, Libohovë, Durrës dhe Gramsh; Bashkia e Tiranës, Belshit, Devollit dhe Dropullit nuk kanë ofruar të dhëna mbi dëgjesat publike të realizuara në fazën e hartimit të buxhetit.

Në dëgjesat publike për buxhetin e vitit pasardhës kanë marrë 8688 qytetarë (N=42). Treguesi duhet të jetë më i lartë por një pjesë e bashkive nuk kanë raportuar për treguesin. Ndonëse numri i dëgjesave për buxhetin ka qenë më i ulët në krahasim me vitin 2020, numri i qytetarëve pjesëmarrës në konsultime ishte më i lartë në 2021 kundrejt vitit 2020 (rreth 1800 më shumë qytetarë).

Grafiku 9: Numri i dëgjesave publike mbi projekt-buxhetin nga NJQV, 2017-2021



Krahas organizimit të dëgjësave publike me qytetarët NJVV mundësojnë dëgjesa të posaçme për të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe komunitetet në nevojë. Në 2021 janë organizuar gjithsej 128 dëgjesa publike me këto grupe ose mesatarisht 2 dëgjesa për bashki (N=56). Bashkia Peqin dhe Bashkia Lushnjë kanë organizuar më shumë dëgjesa me këto grupe të veçanta respektivisht 20 dhe 11 dëgjesa, ndërsa bashkitë e tjera kanë organizuar nga 1 në 8 dëgjesa. Rreth 24 bashki nuk kanë raportuar për këtë tregues midis tyre Bashkia e Tiranës, Shkodrës, Skraparit, Libohovës, Këlcyrës, Kukës, Dibrës, Kavajës, Tepelenës, Rrogozhinës, Vorës.

Në 2021 NJVV kanë organizuar rreth 253 dëgjesa publike për raportin e ekzekutimit të buxhetit ose mesatarisht 4 dëgjesa (N=59) në të cilat kanë marrë pjesë rreth 6296 qytetarë (N=35). Ndërsa disa bashki kanë raportuar plotësimin 100% të rekomandimeve të organizatave të shoqërisë civile dhe të grupeve të interesit, si Bashkia e Shkodrës, Lushnjës, Mallakastrës, Kamzës, Gramshit dhe Shijakut, lidhur me nevojat dhe prioritetet e tyre norma mesatare e adresimit të rekomandimeve të organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit ka qenë 36% (ose 11 p.p. më e lartë në krahasim me vitin 2020).

## Kutia 2: Sfida për ofrimin e transparencës mbi financat vendore

**Bashkia Tiranë:** Pandemia ka ndikuar në realizimin e konsultimeve publike.

**Bashkia Përmet:** Duhet respektuar formati standard sipas ligjit, i cili për shumicën e qytetarëve është i vështirë për tu kuptuar, dhe përgatitja e një buxheti më të thjeshtë dhe të kuptueshëm për qytetarët behët i vështirë dhe kërkon angazhim financiar dhe në burime njerëzore. Ndërgjegjësimi i komunitetit për të marrë informacion online duke përdorur faqen zyrtare të bashkisë.

**Bashkia Patos:** Të mund të hartohet “buxheti vendor” edhe me mbështetjen e mjeteve të bashkisë, në rastet kur mungojnë projekte që mund ta mbështetnin (si video ilustruese ose fletëpalosje, si dhe mund të promovohet me anagzhimin e Kryetarëve të fshatrave dhe vullnetarëve për tu shpërndarë në njësitë administrative).

**Bashkia Shkodër:** Përdorim nga qytetarët i instrumentit ‘Transparenca e Buxhetit’ në portalin zyrtar bashkiashkodër.gov.al ‘Upgrade mobile app’.

**Bashkia Tropojë:** Sfidë mbetet zbatimi dhe vazhdimësia në publikim që të sigurohet transparencë më e lartë.

**Bashkia Vlorë:** Hasrtimi i projekt-buxhetit dhe paraqitja e tij në Këshill brenda afateve ligjore.

**Bashkia Mallakastër:** Përditësimi i të dhënave për çdo ndryshim në buxhetin vjetor të bashkisë.

**Bashkia Pogradec:** Përgatitja e buxhetit vendor të strukturuar në një formë më të thjeshtë për qytetarët.

**Bashkia Dibër:** Qytetarët apo grupet e interesit nuk kanë dërguar komente dhe sugjerime online gjatë hartimit të projekt-buxhetit vendor.

**Bashki Kolonjë:** Ndërgjegjësimi i komunitetit për të përdorur faqen zyrtare të bashkisë dhe për tu informuar është i ulët. Vështirësia e kuptimit të termave financiarë.

**Bashkia Dropull:** Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në dëgjesat publike.

**Bashkia Librazhd:** Caktimi i një personi për dëgjesat publike, i cili të mbajë list-prezencën dhe të ndjekë organizimin e dëgjësave dhe përpunimin e të dhënave.

**Bashkia Berat:** Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve dhe pakicave, si dhe personave me aftësi të kufizuara në dëgjesat publike.

**Probleme dhe Sfida**

- Përgatitja e buxhetit të strukturuar në një formë më të kuptueshme për qytetarët.
- Rritja e interesit të qytetarëve për të marrë pjesë në vendimmarrjen vendore lidhur me planifikimin e buxhetit dhe raportimin mbi zbatimin e tij (performancën në zbatimin e buxhetit).
- Pandemia ka ndikuar në realizimin e dëgjësive dhe konsultimit publik me pjesëmarrje fizike të qytetarëve.
- Realizimi i projekt buxhetit dhe paraqitja në Këshill Brenda afateve ligjore, zbatimi dhe vazhdimësia në publikim për çdo ndryshim (azhurnimi i buxhetit), për të siguruar transparencë për qytetarët.

**Rekomandime**

- Përmirësimi cilësor i procesit dhe marrjes së mendimit të qytetarëve.
- Zbatimi me rigorozitet në nivel vendor i Ligjit për konsultim publik<sup>36</sup> dhe kërkesave që ka ligji.
- Organizimi i dëgjësive në tre mujorin e parë të vitit nëpërmjet platformave online dhe me fokus grupe specifike<sup>37</sup>.
- Forcimi i kapaciteteve institucionale të NJVV në drejtim të monitorimit të zbatimit të buxhetit dhe raportimit për qytetarët dhe Këshillin Bashkiak lidhur me ofrimin e shërbimeve publike, të financuara nga buxheti vendor mbi bazë të rezultateve (treguesve të performancës).
- Rritja e burimeve njerëzore në bashki për të organizuar dhe ndjekur çështjet që lidhen me dëgjësat publike dhe përpunimin e statistikave përkatëse (psh. të rekomandimeve të qytetarëve dhe marrjen në konsideratë të tyre në vendimmarrjen e organeve të qeverisjes vendore).
- Një vlerësim më i mirë i kërkesave të qytetarëve dhe rekomandimeve për tu marrë në konsideratë në projekt-buxhetin e rishikuar.
- Përdorimi i instrumentave të teknologjisë së informacionit do të lehtësonte aksesimin 'Transparenca e Buxhetit' në telefonin mobile të qytetarit.

**1.1.3. Administrata Publike**

“Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar me reformën e administratës së saj publike. Është arritur përparim me miratimin e udhëzimeve për konsultimet publike, ngritjen e sistemeve të TI-së për planifikim të integruar, rritjen e shkallës së zbatimit të Planit Kombëtar të Integrimit Evropian, rritjen e numrit të shërbimeve elektronike, dhe përfundimin e fazës së testimit për të automatizuar sistemin e pagave. Zbatimi i reformës të administratës publike 2015-2022 (PAR) dhe strategjisë së menaxhimit të financave publike 2014-2022 (MFP) ka vazhduar pavarësisht ndikimit të pandemisë.<sup>38</sup>”

Krahasuar me vitin 2017, Shqipëria ka bërë progres të vazhdueshëm, duke kryesuar rajonin e Ballkanit Perëndimor, në fushat kyçe të zbatimit të reformës në administratën publike; vlerësohet përforcimi i sistemit të shërbimit civil, forcimi i kapaciteteve dhe rritjes profesionale të nëpunësve publik në përballimin e sfidave të integritetit drejt Bashkimit Evropian pavarësisht sfidave që solli pandemia<sup>39</sup>.

Disa nga zhvillimet dhe arritjet në menaxhimin e burimeve njerëzore, gjatë vitit 2021, përfshijnë:

- (i) zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, me fokus Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore,

<sup>36</sup> Raport Progresi I KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

<sup>37</sup> Rekomandim i Bashkisë së Tiranës si pjesë e raportimit për treguesit për vitin 2021

<sup>38</sup> Raport Progresi i KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

<sup>39</sup> SIGMA Raporti i Monitorimit “Principet e Administratës Publike” (Nëntor 2021) <https://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-Executive-Summary-2021-Albania.pdf>


- (ii) digjitalizimi i procesit të rekrutimit në shërbimin civil (mundësia për ta zhvilluar procesin online),
- (iii) forcimi i kapaciteteve profesionale të nëpunësve publike dhe të komisioneve të vlerësimit,
- (iv) funksionimi dhe përdorimi i moduleve të unifikuara të platformës së integruar “administrata.al”,

Rrjeti i njërive të integrimit evropian të BE-s ka forcuar përfshirjen e NJQV-ve në procesin e anëtarësimit në BE, duke rritur ndërgjegjësimin për politikatat e BE-s dhe fondet dhe programet e BE-s. ë vitin 2021 gjashtëdhjetë (60) bashki kanë zbatuar Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM 450/ 2018) për institucionalizimin dhe përmirësimin e “Këndeve të BE-s në NJVV<sup>40</sup>.

### Punësimi në administratën vendore dhe shërbimet publike në bashki


Në vitin 2021 numri gjithsej i punonjësve të 61 bashkive ishte 34386 nga të cilët rreth 33.4% janë punonjës të administratës vendore. Vihet re se numri i punonjësve të administratës është ulur rreth 3.7 p.p në krahasim me vitin 2020 (37.15%).

Grafiku 10: Numri total i punonjësve të bashkive, 2020



Norma mesatare e punonjësve të shërbimeve publike është 45% (N=61), por treguesi ndryshon në një shkallë të gjerë - bashkitë që kanë raportuar numrin më të madh të punonjësve të punësuar në shërbimet publike janë bashkitë Rrogozhinë (94%) dhe Sarandë (91%).


Grafiku 11: Shkalla e punësimit në shërbimet publike sipas bashkive, 2021



<sup>40</sup> Raport Progresi i KE për Shqipërinë, Nëntor 2021


**Shkalla mesatare e nëpunësve me status të nëpunësit civil** në NJVV kundrejt numrit të përgjithshëm të punonjësve në administratën vendore ishte rreth **35.4%** në 2021 (ose 4076 nëpunës civilë kundrejt **4,625 të raportuar në vitin 2020**), N=60. Treguesi është me tendencë ulje edhe në krahasim me vitin 2019. Rreth 37.4% të punonjësve me status të nëpunësit civilë janë femra (N=60).

Grafiku 12: Numri gjithsej i nëpunësve vendore me status të nëpunësit civil në bashki, 2021



Nga 2115 pozicione drejtuese në administratën vendore, në të gjitha NJVV, rreth 25.6% e tyre kanë qenë femra (N=60, treguesi është pak më i lartë kundrejt vitit 2020). Tendeca e treguesit është me rritje për periudhën 2019-2021.

Grafiku 13: Shkalla e punësimit të femrave në pozicionet drejtuese në NJVV, 2021 (në %)




Bashkitë e Patosit, Kamzës, Beratit, Malësisë së Madhe, Konispol, Dropull dhe Elbasan kanë një raport të njëjtë gjinor në pozicionet drejtuese në administratën vendore. Bashkia Vorë nuk ka raportuar mbi pjesëmarrjen e femrave në pozicione drejtuese, Bashkia Himarë ka numrin më të vogël të raportuar, vetem 0.17% e femrave në pozicione drejtuese, ndërsa Bashkia Pustec nuk ka asnjë femër në pozicion drejtuesi në bashki.

**Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të administratës vendore nëpërmjet trajnimeve**

Numri gjithsej i programeve të trajnimit të ofruar nga ASPA për nëpunësit e 57 bashkive, ka qenë 1229, ose 21 programe mesatarisht, në 2021 (pak më i lartë kundrejt 2020), të cilat janë ndjekur nga rreth 2325 punonjës vendor (N=59). Gjithashtu rreth 2000 punonjës kanë marrë trajnime nga ofrues të tjerë në vitin 2021, ose mesatarisht 36 punonjës për bashki (N=55). *Bashkia e Tiranës ka patur numrin më të madh të punonjësve të trajnuar nga ASPA në 2021 (614 persona), e ndjekur nga Bashkia Gjirokastër (198) dhe Bashkia e Kamzës (177).*



Grafiku 14: Numri I punonjësve vendor të trajnuar nga ASPA, 2018-2021



Zbatimi i Ligjit të Nëpunësit civil në administratën vendore ka qenë në fokus të Departamentit të Administratës Publike dhe të ASPA. Në 2021, kanë vijuar trajnimet për zbatimin koherent të ligjit të Nëpunësit Civil – rreth 853 nëpunës vendorë të trajnuar, nga të cilët 300 persona janë trajnuar mbi udhëzimet dhe manualet dedikuar menaxhimit të burimeve njerëzore.


Mjaft NJVV nuk parashikojnë fonde për trajnime nga buxheti i tyre vendor (N=53); norma mesatare e buxhetit vendor për trajnime ka qenë rreth 0.1% e buxhetit vendor në 2021 (më e vogël kundrejt vitit 2020).

**Sistemi Informatik për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (HRMIS)** vazhdon të jetë i plotësuar/funksional por nuk mbulon ende të gjithë sektorin publik dhe mbetet për t'u shtrirë në nivel lokal. Qeveria po vendos masa për një mekanizëm koordinues për monitorimin dhe vlerësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore ndërmjet nivelit qendror dhe lokal. Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil monitoron zbatimin e ligjit për shërbimin civil në nivel qendror dhe vendor<sup>41</sup>.

HRMIS ka qenë funksional në 62% të NJVV (N=60, ose 6 p.p. më i lartë në krahasim me 2020). Bashkitë e Tiranës, Elbasanit dhe Peqinit, nuk e kanë patur sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore (HRMIS) funksional në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020<sup>42</sup>.

#### Largimet nga administrata vendore

Në 2021 janë larguar **gjithsej 1922 punonjës** nga NJVV (23% e tyre për shkak të daljes në pension), N=58. Norma mesatare e personave të larguar pa përfshirjen e atyre të larguar për shkak të daljes në pension ka qenë 25. Bashkitë me normë më të lartë të largimeve kanë qenë Bashkia Pogradec (28%), Bashkia Dropull (24%) dhe Bashkitë e Kavajës dhe Devoll (20%).




■ Nuk ka te dhena  
 ■ Jo  
 ■ Po

<sup>41</sup> Progres Raporti për Shqipërinë i KE (Nëntor 2021)

<sup>42</sup> Bazuar në raportimin e bashkive mbi treguesit e performancës për vitin 2021

Grafiku 15: Norma e të larguarve nga NJVV, 2021



### Probleme dhe sfida

- Kontratat e përkohshme për pozicionet e shërbimit civil, megjithëse në ulje, vazhdojnë të jenë mjaft të shpeshta në NJVV<sup>43</sup>. Ky fenomen shihet në masë të ndjeshme edhe në nivelin vendor
- Sigurimi i qëndrueshmërisë së nëpunësve në administratën vendore dhe në mënyrë të veçantë i nëpunësve me përvojë.
- Mungesa e qëndrueshmërisë së stafëve të Njësive të Integrimit Evropian që kanë një rol të rëndësishëm në kordinimin e procesit të integrimit evropian dhe përthithjen e fondeve të Bashkimit Evropian.
- Zbatimi i reformës së pagave në sektorin publike ka qenë i ngadalshëm, çka ka ndikuar që nivelet e pagave në nivelin vendor të jenë tepër të ulta duke u kthyer një problem për bashkitë në punësimin e specialisteve profesionistë në shumë sektorë të shërbimeve apo pozicione të rëndësishme menaxheriale<sup>44</sup>.
- Krijimi i strukturave të menaxhimit të performancës në bashki, si pjesë e synimeve të SNDQV dhe PV 2020-2022.
- Sistemi i informacionit për menaxhimin e burimeve njerëzore (HRMIS) nuk është plotësisht funksional në të gjitha NJVV.
- Fond i vogël nga buxheti vendor për trajnime të punonjësve vendor në përputhje me nevojat e tyre.

### Rekomandime

Disa nga rekomandimet e raportit të mëparshëm mbeten të vlefshme:

- Zbatimi i Ligjit të Nëpunësit Civil mbetet për t'u përmirësuar në nivelin vendor në të gjitha nivelet, veçanërisht në nivelin vendor ku nevojitet depolitizimi i shërbimit civil dhe gjithashtu trajnim më i mirë.<sup>45</sup>
- Zbatimi i rekomandimeve të Departamentit të Administratës Publike për përmirësimin e procedurës së rekrutimit dhe veçanërisht për proceset e NJVV.
- Një kuadër i ri strategjik për Reformën në Administratën Publike duhet të hartohet në mënyrë gjithëpërfshirëse për periudhën tjetër dhe me mekanizma monitorimi dhe koordinimi më efektive, që të sigurojë drejtim të nivelit politik më të rregullt dhe rezultate zbatimi me të mira<sup>46</sup>.

<sup>43</sup> Progres Raporti për Shqipërinë i KE (Nëntor 2021)

<sup>44</sup> OECD Raporti i Monitorimit "Parimet e Administratës Publike" (Nëntor 2021)

<sup>45</sup> Progres Raporti për Shqipërinë i KE (Nëntor 2021)

<sup>46</sup> Progres Raporti për Shqipërinë i KE (Nëntor 2021)


- Zbatimi më i shpejtë i reformës së sistemit të pagave për shërbimin civil do të tërhiqte më shumë kandidatë dhe do të rriste motivimin për tu punësuar në administratën publike dhe për të siguruar rezultate më të mira të politikave publike<sup>47</sup>.
- Shtrirja e sistemit të integruar të politikbërjes edhe në nivelin vendor.
- Monitorimi i treguesve të reformës në administratën publike të shtrihet edhe në NJVV, dhe të bëhet publikimi i të dhënave në platformën “administrata.al”.
- Ngritja e njësisë së monitorimit dhe performancës në NJVV të jetë mbi bazën e një modeli të rekomanduar dhe konsultuar në KK dhe NJVV dhe shoqatat e vetëqeverisjes vendore.
- Mbajtja në mënyrë sistematike e informacionit mbi trajnimet e punonjësve në bashki, në mënyrë që të mirëkordinohet dhe të rritet efiçenca e trajnimeve që marrin stafet e bashkive. Roli dhe kapacitetet e njësisë të mënaxhimit të burimeve njerëzore duhet të forcohen në drejtim të përdorimit të instrumentave që ofron Sistemi i HRMIS.
- Përmirësimi i koordinimit brenda administratës, veçanërisht në lidhje me procesin e integritetit në BE<sup>48</sup>.

### Objektivi specifik: përmirësimi i llogaridhënies së administratës vendore<sup>49</sup>

Në 2021, është rritur numri i akteve ligjore që kalojnë në konsultim publik dhe përdorimi i regjistrit elektronik. Funkzioni i kontrollit të cilësisë në konsultimin publik ka nevojë të forcohet për t'u fokusuar më shumë në përmbajtje sesa në proces. Vërehet një përmirësim i transparencës pasi të 61 bashkitë tani po publikojnë online vendimet e Këshillit Bashkiak të tyre<sup>50</sup>.

Në 2020, **shkalla mesatare e kthim-përgjigjeve të administratës vendore ndaj kërkesave të qytetarëve** është rritur në nivelin 82.3% për 58 NJVV raportuese (ose +1.4 p.p. në krahasim me vitin 2020), **ç'ka tregon për një rritje të përgjegjshmërisë së bashkive për të reaguar ndaj kërkesave të qytetarëve**. Rreth 43% e bashkive kanë një normë të kthim-përgjigjeve mbi 95%. Vetëm dy bashki – Has dhe Vorë nuk kanë ofruar të dhëna për treguesin. Vihet re se vlera e treguesi është me tendencë rritëse në 3 vitet e fundit.

Grafiku 16: Norma e përgjigjeve të administratës vendore ndaj kërkesave/ankesave të qytetarëve, 2021




<sup>47</sup> OECD Raporti I Monitorimit për Administratën Publike (Nëntor 2021)

<sup>48</sup> OECD Raporti i Monitorimit “Parimet e Administratës Publike” (Nëntor 2021)

<sup>49</sup> Performanca e NJVV lidhur me objektivin specifik vlerësohet mbi bazën e tre treguesve të performancës: (i) numri i përgjigjeve të dhëna për kërkesat e qytetarëve ndaj numrit të përgjithshëm të dorëzuar pranë bashkisë, (ii) numri i akteve të vendimmarrësve vendor të publikuar në regjistrin elektronik së bashkisë, mbi numrin total të akteve të miratuar nga bashkia gjatë vitit të raportimit, (iii) numri i raporteve mbi konstatimet/ rekomandimet nga Komisioneri për Mbrojtjen kundër Diskriminimit të cilat bashkia i ka refuzuar kundrejt numrit të përgjithshëm të raporteve të dorëzuara në bashki nga KMDDHP.


<sup>50</sup> Progres Raporti për Shqipërinë i KE (Nëntor 2021)

Grafiku 17: Tendeca e normës mesatare të përgjigjeve të administratës vendore ndaj kërkesave/ankesave të qytetarëve, 2019-2021



Në 2021, transparenca e organeve vendimmarrëse për të publikuar aktet e miratuara është ulur, bazuar në të dhënat e raportuara nga bashkitë, përkatësisht në 58.9% (N=51), në krahasim me 70% të raportuar për vitin 2020. Treguesi mund të kishte rezultuar me vlerë më të lartë, sepse 18% e bashkive nuk kanë ofruar të dhëna për treguesin.

Grafiku 18: Tendensa e normës së publikimit të akteve të organeve vendimmarrëse vendore, 2017-2021



Norma e kthimit (refuzimit) nga NJVV të rekomandimeve (raporteve) të lëshuara nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qenë e vogël rreth 6.5% të numrit të përgjithshëm të raporteve të dërguara (N=55), ose 0.5 p.p. më e lartë në krahasim me vitin 2020 ndërsa në vitin 2019 ka qenë në nivelin 4%.

### Probleme dhe sfida .....

- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet agjencive shtetërore në nivel rajoni dhe institucioneve vendore për adresimin e çështjeve të rekomanduara nga KMD.
- Shqyrtimi i çdo rekomandimi nga drejtoritë dhe strukturat përkatëse të NJVV brenda afateve ligjore.

### Rekomandime .....

- Respektimi i afateve dhe përgjegjshmëri me të lartë në lidhje me shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve.
- Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe ofrimi i informacionit të strukturuar për adresimin efikas të rasteve të konstatuara dhe të raportuara.
- Zgjerimi i mbulimit të regjistrit qendror për kërkesat për informacion<sup>51</sup>.


<sup>51</sup> Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë 2021

### 1.1.4. Avokati i Popullit

Avokati i Popullit (AP)<sup>52</sup> mbulon funksionet si (i) Institucioni kombëtar për të drejtat e njeriut (IKDNj) sipas parimeve të Parisit të OKB-së, (ii) Avokati i Popullit "klasik" me detyrën e mbikëqyrjes së autoriteteve publike në aspektin e zbatimit të sundimit të ligjit dhe parimeve të qeverisjes së mirë dhe për të shmangur keqadministrimin në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve publike, (iii) Mekanizmi Kombëtar Parandalues kundër Torturës dhe Trajtitimit ose Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore ose Poshtëruese, në përputhje me Protokollin Fakultativ të Konventës së OKB-së kundër Torturës (MKP), (iv) Avokati i Popullit për Fëmijët: Krijimi i institucioneve të tilla është promovuar nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe nga viti 1990 e tutje, nga Këshilli i Evropës".

Në vitin 2021, **NJVV kanë marrë më pak raporte me konstatime dhe rekomandime** nga Avokati i Popullit në krahasim me vitin 2020, gjithsej **412 raporte** (N=59), ose mesatarisht 7 raporte. Nëse trajtojmë vetëm bashkitë, të cilat kanë marrë raporte nga AP gjatë vitit 2021, norma mesatare ka qenë 12 raporte për bashki (N=33).

Grafiku 19: Numri i raporteve dhe rekomandimeve nga institucioni i Avokatit të Popullit për NJVV, 2021




Bashkia e Tiranës ka marrë një numër më të lartë të raporteve nga Avokati i Popullit (192 raporte), ndjekur nga Bashkia Korçë (41), Bashkia Fier (37 raporte) dhe Bashkia Sarandë (22 raporte).

Norma e shqyrtimit dhe pranimit të raporteve të Avokatit të Popullit nga bashkitë e vendit ka qenë rreth **84%** në 2021 (më e lartë krahasuar me nivelin 71% të raporteve të pranuar nga NJVV në vitin 2020), N=57. **Krahasuar me mesataren e shkallës së përgjigjeve nga institucionet publike për vitin 2021 e cila është në masën 55%, mund të thuhet që bashkitë tregojnë një vëmëndje më të madhe ndaj raporteve të Avokatit të Popullit.** Nga 33 bashki që kanë marrë raporte nga Avokati i Popullit, 21 bashki i kanë trajtuar dhe pranuar të gjithë raportet (100%) ndërsa 12 bashki kanë një normë pranimi nga zero përqind në 91% brenda fund vitit 2021.

<sup>52</sup> Kushtetuta e RSH, kapitulli VI, Ligji për Avokatin e Popullit Nr. 8454, më datë 04.02.1999, i ndryshuar

Grafiku 20: Norma e pranimit nga NJVV të raporteve të dërguara nga Avokati i Popullit, 2021



Gjithsej 75 raporte të Avokatit të Popullit kanë qenë në proces shqyrtimi nga bashkitë në fund të vitit 2021 (N=56, shqyrtimi i tyre nuk kishte përfunduar në fund dhjetor 2021).

### Problemet dhe sfidat .....

- Forcimi i bashkëpunimit dhe transparencës me Avokatin e Popullit për ndjekjen e rasteve të referuara në kohë.
- Plotësimi i rekomandimeve duke zgjeruar shërbimet dhe qartësimi i kompetencave.
- Respektimi i afateve ligjore, si dhe evidentimi i shtresave vulnerabël për ti trajtuar dhe mbrojtur.
- Vonesa në kthim përgjigje.

### Rekomandime .....

Disa nga rekomandimet mbeten relevante edhe për periudhën raportuese:

- E drejta e qytetarëve për administrim të mirë ka nevojë për rritje. Roli i koordinatoreve për të drejtën e informimit brenda autoriteteve publike duhet të forcohet duke emëruar zyrtarë të lartë në këtë pozicion<sup>53</sup>.
- Të vlerësohen dhe të ketë zgjidhje nga NJVV për tematikat dhe çështjet e adresuara nga Avokati i Popullit.
- Të trajtohet me shumë kujdes korrespondenca me Avokatin e Popullit.
- Rritja e transparencës ndaj publikut lidhur me zbatimin e rekomandimeve nëpërmjet publikimit të rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit në faqen zyrtare të bashkisë<sup>54</sup>.

<sup>53</sup> Progres Raporti i KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

<sup>54</sup> Raporti vjetor i Avokatit të Popullit për vitin 2020

### 1.1.5. Shoqëria civile


“Është bërë përparim i kufizuar në zbatimin e udhërrëfyesit për një mjedis mundësues për shoqërinë civile. Miratimi i ligjit për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse sjell disa përmirësime. Këshilli Kombëtarë për Shoqërinë Civile duhet të reformohet për të siguruar përfaqësimin e duhur të shoqërisë civile shqiptare.”<sup>55</sup>

Situata e pandemisë ka dobësuar stabilitetin financiar të shoqërisë civile edhe për shkak të kuadrit të pafavorshëm ligjor dhe fiskal. Ligji për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse (miratuar në Qershor 2021), synon futjen e një regjistri elektronik, i cili do të lehtësojë procesin e regjistrimit dhe do të rrisë transparencën dhe saktësinë e Organizatave Joqeveritare. Udhërrëfyesi për një mjedis të favorshëm për shoqërinë civile mbetet fuqimisht i varur nga mbështetja e donatorëve. Kërkohen përpjekje dhe burime shtesë për të përshpejtuar zbatimin e tij në mënyrë që të krijohet një mjedis më i favorshëm për funksionimin e shoqërisë civile dhe për të kontribuar në miratimin e politikave dhe ligjeve të shëndosha. Ndërsa ligji i vitit 2014 për konsultimin publik është përgjithësisht në përputhje me standardet evropiane, konsultimet shpesh mbeten artificiale. Fushëveprimi i ligjit duhet të zgjerohet edhe në vendimet e qeverisë. Stimujt tatimorë për donacionet e korporatave nuk promovojnë donacione për OSHC-e dhe nuk ka stimuj tatimorë për donacionet individuale<sup>56</sup>.

Progresi në arritjen e objektivit “*forcimi i rolit të shoqërisë civile dhe rritja e bashkëpunimit në nivel vendor*” është vlerësuar nëpërmjet 4 treguesve kryesorë:

**Numri i përgjithshëm i rekomandimeve të ofruara nga OSHC gjatë procesit të vendimmarrjes vendore, gjatë vitit 2021 ka qenë 135** (ose mesatarisht rreth 5 rekomandime për 25 bashki të cilat kanë marrë rekomandime) (N=50). Një pjesë e bashkive të tjera (25) nuk kanë patur rekomandime nga OSHC (raportuar zero). Treguesi është më i ulët në krahasim me vitin 2020 (315 rekomandime më pak).

Grafiku 21: Numri i rekomandimeve të ofruara nga OSHC për NJVV, 2021




**Bazuar në të dhënat e raportuara nga bashkitë vihet re një vëmendje e shtuar e bashkive për të marrë në konsideratë rekomandimet e OSHC-ve.** Nga 135 rekomandime të dhëna nga OSHC për organet vendimmarrëse gjatë 2021 rreth 89% e tyre (120) janë marrë në shqyrtim (N=51), nga të cilat 117 (ose 87%) janë pranuar nga organet e NJVV (N=50). Në krahasim me vitin 2021, norma e pranimit të rekomandimeve ka qenë më e lartë në krahasim me vitin 2020 (70% e numrit të rekomandimeve).

<sup>55</sup> Raport Progresi i KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

<sup>56</sup> Raport Progresi i KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

Grafiku 22: Norma e pranimit të rekomandimeve të OSHC në vendimmarrjen e NJVQ, 2019-2021



NJVV kanë dhënë gjithsej 63 grante për projekte të përbashkëta në partneritet me organizatat e shoqërisë civile (N=54). Grantet janë kategorizuar të madhësisë deri 100,000 lekë nga 100,000 – 500,000 dhe mbi 500,000 lekë.

Bashkitë me numrin më të lartë të granteve kanë qenë Bashkia e Shkodrës me 18 grante dhe Bashkia e Tiranës me 15 grante, Bashkia Përmet (6 grante) dhe Bashkia Gjirokastër (4 grante). Bashkitë e tjera kanë dhënë nga 1-3 grante, ndërsa 35 bashki (57%) nuk kanë dhënë asnjë grant në 2020.

#### Kutia 4: Sfida për bashkëpunimin me organizata të shoqërisë civile

**Bashkia Tiranë:** Mbatja e një raporti për rekomandimet e ofruara nga OSHC-e.

**Bashkia Berat:** Ka nevojë për më shumë përfshirje të OSHC-e në procesin e vendimmarrjes të qeverisë vendore.

**Bashkia Devoll:** Sfidë mbetet bashkëpunimi me shoqata të ndryshme në të gjithë vendin që ndihmojnë në procesin e mirëqeverisjes.

**Bashkia Dimal:** Pjesëmarrje më e lartë e OSHC dhe grupeve të interesit të të rinjve në aspektet sociale, politike dhe ekonomike; kerkohen më shumë rekomandime dhe bashkëpunim. Krijimi i strukturave rinore informuese /komunikuesë me qeverisjen vendore.

**Bashkia Shkodër:** Rritja e ndërgjegjësimit të shoqërisë civile për marrjen pjesë në vendimmarrje.

**Bashkia Kamëz:** Shqyrtimi i të gjitha kërkesave dhe rekomandimeve.

**Bashkia Mirditë:** Pranimi, diskutimi dhe ku është e mundur reflektimi i kërkesave të tyre në projekt-vendimet e Këshillit Bashkiak.

**Bashkia Përmet:** Rritja e numrit të OSHC-ve që janë aktive.

**Bashkia Prrënjës:** Ngritja e OSHC-ve dhe përfshirja e tyre në vendimmarrjen vendore dhe çështje të tjera mbi mirëqeverisjen vendore.

#### Problemet dhe sfidat .....

*Disa nga sfidat dhe rekomandimet mbeten të vlefshme edhe për këtë periudhë raportimi:*

- Ndërsa norma e marrjes në shqyrtim dhe e pranimit në vendimmarrjen vendore të rekomandimeve të ofruara nga OSHC ka qënë më e lartë në vitin 2021 kundrejt 2020, vihet re ulje e numrit të rekomandimeve të OSHC (në vlerë absolute); rreth 39% e NJVV raportojnë zero rekomandime nga OSHC në vitin 2021, ndërsa rreth 20% nuk kanë raportuar për këtë treguesin. Në programin e transparencës së bashkive nuk jepen rekomandimet e dhëna nga organizatat e shoqërisë civile.
- Mungesa e OSHC-ve aktive në mjaft bashki.



- Cilësia e diskutimeve dhe konsultimeve publike nuk është në nivelin e duhur. Ndërsa ligji i vitit 2014 për konsultimin publik është përgjithësisht në përputhje me standardet evropiane, konsultimet shpesh mbeten artificiale<sup>57</sup>.
- Burime financiare të vogla nga bashkitë për të financuar projekte në partneritet me organizata të shoqërisë civile.

### Rekomandime .....

- Nevojiten përpjekje thelbësore për të siguruar konsultime kuptimplota dhe sistematike me shoqërinë civile si pjesë e një dialogu politikash gjithëpërfshirëse për reformat<sup>58</sup>.
- Më shumë iniciativa dhe përfshirje të organizatave të shoqërisë civile në proceset e vendimmarrjes vendore.
- Forcimi i partneritetit me organizatat e shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse të NJVV .
- Rritja e angazhimit të bashkive për të rregjistruar dhe bërë publike në programin e transparencës rekomandimet e dhëna nga organizatat e shoqërisë civile dhe reflektimi i tyre në vendimmarrjen vendore.
- Mbatja e një raporti nga NJVV mbi rekomandimet e ofruara nga organizata e shoqërisë civile.
- Krijimi i strukturave rinore informuese /komunikuese me qeverisjen vendore do të ndihmonte bashkëveprimin me shoqërinë civile.

## PËRFUNDIME MBI DEMOKRACINË

**Këshilli Konsultativ** ka funksionuar si forumi kryesor për dialogun institucional dhe koordinimin ndërmjet qeverisë qendrore dhe qeverive vendore. Ndonëse përfaqësimi i Qeverisë në takimet e Këshillit Konsultativ nuk ka qenë plotësisht sipas parashikimeve ligjore, në 2021 ka patur një rritje të nivelit të përfaqësimit në krahasim me 2020. Sfidë mbetet rritja e ndërgjegjësimit dhe kuptimi i rolit të KK nga të gjithë Kryetarët e 61 NJVV, sigurimi i pjesëmarrjes së plotë të tyre, si dhe rritja e cilësisë së kontributit që vjen nga njësitë e qeverisjes vendore për aktet ligjore që diskutohen në KK.

Në fushën e **shërbimeve dhe transformimit digjital** është zgjeruar harta e Zyrave me Një Ndalesë (ZNjN) në të gjitha bashkitë e vendit. Mbeten sfida zgjerimi i ZNjN në të gjitha bashkitë dhe njësitë administrative, rritja e financimit nga buxheti vendor për përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe të teknologjisë së informacionit e të internetit për mbulimin e territorit me shërbimin e ZNjN, hartimi dhe miratimi i standarteve minimale të shërbimeve, si dhe forcimi i rolit mbikqyrës për të siguruar që bashkitë të ofrojnë shërbime në përputhje me kërkesat dhe standartet e cilësisë<sup>61</sup>.

### Administrata publike

Shqipëria është e **përgatitur në mënyrë të moderuar** në lidhje me **reformën në administratën publike**. Përparim është bërë në zbatimin e legjisllacionit të shërbimit civil në nivel vendor, dixhitalizimin e procesit të rekrutimit në shërbimin civil (mundësia për ta zhvilluar procesin online), në përdorimin e platformës së integruar “administrata.al” dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të nëpunësve publikë. Rrjeti i koordinatorëve

<sup>57</sup> Progres Raporti i KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

<sup>58</sup> Progres Raporti i KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

<sup>61</sup> Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (2020)

vendorë të BE-s ka forcuar përfshirjen e NJQV-ve në procesin e anëtarësimit në BE, rritjen e informimit për politikën dhe fondet e BE-s.

Ndërsa vihet re ulje e numrit të punonjësve të administratës vendore dhe numrit të nëpunësve me status krahasuar me vitin e mëparshëm të raportimit, punësimi i femrave në pozicione drejtuese ka pësuar rritje gjatë vitit 2021. Sistemi HRMIS ka qenë funksional në një numër pak më të lartë të bashkive në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.

Mbeten sfida zbatimi koherent i Ligjit të Nëpunësit Civil në nivel vendor, ulja e punësimit me kontrata të përkohshme për pozicionet e shërbimit civil, sigurimi i qëndrueshmërisë së nëpunësve në administratën vendore e në mënyrë të veçantë i nëpunësve më përvojë dhe shtrirja e sistemit të integruar të politikbërjes edhe në nivelin vendor.

Bashkitë kanë bërë progres të lehtë lidhur me sigurimin e **pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimarrjen vendore dhe përmirësimin e transparencës së financave vendore**. Ndonëse më pak dëgjesa publike me qytetarët janë organizuar nga NJVV, në 2021, mbi projektbuxhetin (faktor ndikues mund të ketë qenë edhe situata e pandemisë), numri i qytetarëve pjesëmarrës në dëgjesat publike ka qenë më i lartë në krahasim me 2020. NJVV kanë mbajtur funksionale programin e transparencës në faqen zyrtare të bashkisë dhe publikojnë të gjitha dokumentet kryesore si buxheti vjetor dhe raporte të tjera të financave vendore. Sfida mbeten rritja e mëtejshme e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve, hartimi i buxhetit në një format të thjeshtë e të lexueshëm për qytetarët dhe caktimi i një nëpunësi në bashki për procesin e konsultimit dhe dëgjesave publike.

**Bashkitë kanë demonstruar një rritje të përgjegjshmërisë për të reaguar ndaj kërkesave të qytetarëve** që reflektohet në rritjen e normës së kthim-përgjigjeve të administratës vendore ndaj kërkesave të qytetarëve, dhe në shqyrtimin e raporteve dhe rekomandimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD).

Sfida mbeten forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërmjet agjencive shtetërore në nivel rajoni dhe institucioneve vendore për adresimin e të gjitha çështjeve të rekomanduara nga KMD, dhe shqyrtimi i raporteve dhe rekomandimeve nga ana e bashkive, brenda afateve të përcaktuara ligjore.

**Lidhur me zbatimin e të drejtave të njeriut, zbatimin e drejtë të ligjeve dhe të parimeve të qeverisjes së mirë** në ofrimin e shërbimeve publike, më pak raporte dhe rekomandime janë dërguar nga Avokati i Popullit për NJVV gjatë vitit 2021, dhe një vëmendje më e madhe është treguar nga bashkitë ndaj Avokatit të Popullit në shqyrtimin dhe adresimin e raporteve dhe rekomandimeve të dërguara.

Rekomandohet forcimi i rolit të koordinatorëve për të drejtën e informimit brenda autoriteteve publike duke emëruar zyrtarë të lartë në këtë pozicion<sup>62</sup>, si dhe rritja e transparencës ndaj publikut lidhur me zbatimin e rekomandimeve nëpërmjet publikimit të rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit në faqen zyrtare të bashkisë.

**Konsolidimi i shoqërisë civile në nivel vendor mbetet një sfidë**. Ndonëse kuadri ligjor është përmirësuar me miratimin e ligjit për regjistrimin e organizatave joftimprurëse (qershor 2021), zbatimi i Udhërrëfyesit për një mjedis të favorshëm për shoqërinë civile mbetet fuqimisht i varur nga mbështetja e donatorëve. Në vitin e raportimit, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore kanë marrë më pak rekomandime nga organizatat e shoqërisë civile, por norma e shqyrtimit dhe pranimit të tyre nga organet vendimmarrëse është rritur në krahasim me vitet 2019-2020. Programi i transparencës së bashkive nuk jep rekomandimet e ofruara nga OSHC për çështje të ndryshme dhe nëse janë reflektuar ose jo.

Sfida mbeten forcimi i angazhimit të rolit të shoqërisë civile në proceset e vendimarrjes vendore, rritja e financimit nga fondet e qeverisë dhe të NJVV-e për projektet në partneritet të përbashkët, rritja e transparencës nga ana e bashkive lidhur me publikimin e rekomandimeve të OSHC, si dhe rritja e cilësisë së diskutimeve dhe konsultimeve publike.

<sup>62</sup> Progres Raporti i KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

## 1.2. SHTETI I SË DREJTËS

### 1.2.1. Lufta kundër korrupsionit

“Zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2015-2023 në përgjithësi është në rrugën e duhur, edhe pse ka disa mangësi. Këto mangësi përfshijnë nevojën për të rritur pronësinë, për të forcuar kapacitetet institucionale, për të përmirësuar buxhetimin e duhur të aktiviteteve të strategjisë. Ndikimi i masave kundër korrupsionit në zonat veçanërisht vulnerabël (dogana, administrate tatimore, arsimi, shëndetësia, prokurimet publike, kontratat PPP etj.) mbetet i kufizuar. Kontrollat e brendshme dhe mekanizmat e inspektimit brenda administratës publike mbeten të dobëta dhe joefektive. Kapaciteti institucional dhe operacional i rrjetit antikorrupsion në ministritë e linjës, në nivel vendor dhe në Zyrën e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit (KKKK) është rritur lehtë.<sup>63</sup>”


*Objektivi specifik: Përmirësimi i efijencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër korrupsionit, matet nëpërmjet vlerësimit të katër treguesve të performancës:*

- **Numri i rasteve të ankimuara nga biznesi dhe qytetarët për shkelje të procedurave administrative dhe korrupsion** (përfshirë prokurimin publik). Në vitin 2021 janë rregjistruar gjithsej 106 ankesa ose mesatarisht 1.89 ankesa për bashki (N=56). Treguesi shënon rënie të ndjeshme krahasuar me vitin 2020 ku janë raportuar 627 ankesa. Bashkia Malësi e Madhe zë vendin kryesor me një total prej 53 raste ose 50% të totalit të ankesave të raportuara nga bashkitë për vitin 2021<sup>64</sup>.


<sup>63</sup> Progres Raporti i KE për Shqipërinë (2021)

<sup>64</sup> Bashkitë Devoll, Durrës, Peqin, Vlorë dhe Vorë nuk kanë raportuar të dhëna për këtë tregues

Harta 5: Caktimi i Koordinatorit antikorrupsion, 2021



Grafiku 23: Koordinatorit antikorrupsion i emëruar në bashki, 2017-2021



- **Numri i nëpunësve të administratës vendore që kanë deklaruar pasurinë**, sipas mënyrës së kërkuar me ligj (raportuar nga Burimet Njerëzore). Në vitin 2021 ka vazhduar deklarimi i pasurisë nga mesatarisht 1 person për Bashki (N=59), kjo për arsye të faktit që detyrimi ligjor për deklarim të pasurisë në pjesën më të madhe është vetëm për Kryetarin e Bashkisë<sup>65</sup>.
- **Ngritja e një rrjeti të koordinatorëve vendorë anti-korrupsion në bashki.** Caktimi i nëpunësit publik në kapacitetin e koordinatorit vendor anti-korrupsion në zbatim të Planit të Veprimit në luftën kundër korrupsionit është kryer nga 77% e bashkive (47 Bashki (N=59) duke shënuar një rritje me 10 bashki krahasuar me vitin 2020.<sup>66</sup>



### 5.2 Objektivi specifik: Forcimi i kapaciteteve të administratës së qeverisjes vendore për të luftuar korrupsionin

- Në vitin 2021 kanë ndjekur trajnime në fushën e anti-korrupsionit 45% e bashkive me një total prej 69 trajnimesh ose mesatarisht 1.3 trajnime për bashki (N=55). **Përqindja e Bashkive që nuk kanë ndjekur trajnime në fushën e antikorrupsionit mbetet e lartë në 50 % dhe në të njëjtat nivele me vitin 2020.** Bashkia Lushnjë ka numrin më të madh të trajnimeve të ndjekura (10) ndërkohë që 25 bashki nuk kanë ndjekur asnjë program trajnimi.

65 Bashkitë Has dhe Vorë nuk kanë raportuar të dhëna për këtë tregues

66 Bashkitë Dibër dhe Memaliaj nuk kanë raportuar të dhëna për këtë tregues

Harta 6: Ngritja e regjistrit elektronik të bashkisë 2021 Grafiku 24: Ngritja e regjistrit elektronik 2017-2021




Numri i Bashkive që kanë ngritur Regjistrin Elektronik të kërkesave dhe ankesave të qytetarëve ka ardhur në rritje nga viti 2018 deri në 2021 është rritur me 27 p.p.

Ato bashki që kanë ngritur regjistrin elektronik të ankesave raportojnë se kryejnë përditësimin e vazhdueshëm të tij.

- Numri i Bashkive që kanë ngritur regjistrin elektronik te kërkesave dhe ankesave në vitin 2021 ka pësuar rritje duke shkuar në 48 Bashki (N=61) nga 39 në 2020 dhe 23 në 2019. Ky zhvillim pozitiv ka ndikuar edhe në rritjen e aksesit në informacion dhe transparencën ndaj komunitetit si dhe organeve të tjera ligjzbatuese. Bashkitë që kanë ngritur regjistrin elektronik në vitin 2021 janë: Devoll, Finiq, Fushë-Arrëz, Lezhë, Malësi e Madhe, Mallakastër, Përmet, Pukë, Pustec, Skrapar dhe Vorë.
- Në vitin 2021 përditësimi i regjistrit elektronik është realizuar nga 70 % e bashkive (N=54) me një përmirësim 20 p.p. nga viti 2020 i kryer nga vetëm 50% e bashkive. Nuk përjashtohen rastet e bashkive që në mungesë të regjistrit elektronik i mbajnë ankesat në databazë të ngritur prej tyre manualisht<sup>67</sup>.

Grafiku 25: Shkalla e përditësimit të regjistrit elektronik të bashkisë 2021




<sup>67</sup> Bashkitë Delvinë, Divjakë, Has, Polican Selenicë, Shijak dhe Vlorë nuk kanë raportuar të dhëna për këtë tregues


### 5.3 Objektivi specifik: miratimi i politikave anti-korrupsion në nivel vendor

Edhe në vitin 2021 ka vijuar procesi i hartimit dhe miratimit të Planeve të Integritetit Vendor në kuadër të masave antikorrupsion duke arritur në **total në 21 Bashki. Në 6 bashki Tirana, Progradeci, Berat, Përmet, Belsh, and Lezha, Plani i Integritetit Vendor** është miratuar nga këshilli bashkiak (N=57) dhe 15 të tjera janë mbështetur nga projekti STAR III për hartimin e planeve.

Harta 7: Plani i Integritetit në nivel vendor 2021



Harta 8: Planifikimi në buxhet i fondit për politikën antikorrupsion 2021



- **Mos planifikimi në buxhetet e bashkive të fondeve për zbatimin e Planit të Integritetit mbetet problematikë edhe në vitin 2021.** Vetëm 9 Bashki kanë raportuar përfshirjen në buxhet të mjeteve financiare për zbatimin e masave të planit vendor, duke rritur pasigurinë në zbatimin e planit dhe arritjen e progresit në luftën antikorrupsion në nivel vendor (N=57).

#### Problemet dhe sfidat: .....

- Mungesa e Regjistrimit Elektronik të ankesave dhe kërkesave nga qytetarët vazhdon të jetë problematikë e shoqëruar kjo edhe me ritmet e ngadalëta të përditësimit të të dhënave.
- Trajnimet e administratës vendore për çështjet antikorrupsion mbeten në nivele të ulëta si dhe mungesa e pikës së kontaktit/koordinatarit antikorrupsion në disa bashki.
- Pamjaftueshmëria e fondeve për bashkitë dhe në buxhetet e Bashkive për zbatimin e planeve vendore anti-korrupsion.
- Kapacitetet njerëzore për zbatimin në nivel vendor të masave të strategjisë kombëtare kundër korrupsionit si edhe planeve vendore antikorrupsion janë të limituara.

**Rekomandime**

- Zbatimi i Planeve të Integritetit duhet të monitorohet nga afër dhe të inkurajohet miratimi i planeve të integritetit në Bashkitë e tjera<sup>69</sup>.
- AMVV duhet të marrë masat e nevojshme dhe konkrete për të inkurajuar njësitë e vetë-qeverisjes vendore të përcaktojnë një buxhet specifik për implementimin e politikave vendore antikorrupsion, në përputhje me Strategjinë Antikorrupsion<sup>70</sup>.
- Caktimi i koordinatorit/pikës së kontaktit antikorrupsion nga Bashkitë që ende se kanë përmbushur këtë detyrim ligjor.
- Ngritja e regjistrimit elektronik për bashkitë që nuk e kanë ende funksional dhe përditësimi periodik.
- Sigurimi i bashkërendimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe atyre vendore për shtimin e trajnimeve të stafit vendor në bashkëpunim edhe me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet ndërkombëtare.

**PËRFUNDIME MBI LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT**

**Lufta kundër korrupsionit vazhdon të jetë një sfidë e rëndësishme për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.** Sfidat janë të lidhura me tre faktorë bazë: Mungesa e kapaciteteve njëzore, burimet financiare të pamjaftueshme si dhe bashkëpunimi ndër-institucional i limituar.

**Progres i lehtë është shënuar në forcimin e kapaciteteve të punonjësve të bashkive për çështjet antikorrupsion.** Numri i punonjësve që kanë ndjekur trajnime në fushën e antikorrupsionit në vitin 2021 është 587 punonjës. **Përqindja e Bashkive që nuk kanë ndjekur trajnime në fushën e antikorrupsionit mbetet e lartë në 50 % dhe në të njëjtat nivele me vitin 2020.** Megjithë përpjekjet e bëra për të institucionalizuar rrjetin antikorrupsion të pikave të kontaktit në nivel vendor ai ende nuk është kryer nga 14 Bashki.

**Numri i Bashkive që kanë ngritur regjistrin elektronik të kërkesave dhe ankesave në vitin 2021 ka pësuar rritje,** por progresi në ngritjen dhe përditësimin ndikohet negativisht nga mungesa e buxhetimit të fondeve për të ngritur dhe mirëmbajtur regjistrin elektronik. **Ka vijuar procesi i hartimit dhe miratimit të Planeve të Integritetit Vendor në kuadër të masave antikorrupsion** ndërkohë që planifikimi buxhetor për zbatimin e Planit të Integritetit mbetet i limituar.

**Bashkëpunimi midis qeverisjes qendrore dhe vendore për zbatimin e masave antikorrupsion duhet të forcohet dhe të shtrihet në sektorë të rëndësishëm dhe me impakt në ekonomi** si prokurimet publike, administratën tatimore, tranpasencën në vendimmarrje si dhe konflikti i interesit. Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare dhe Organizatat e Shoqërisë Civile duhet të konsiderohet i rëndësishëm në iniciimin e iniciativave për matjen e perceptimit qytetar mbi korrupsionin në nivel vendor.

**1.2.2. Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e pakicave**

Qeveria Shqiptare ka vazhduar përpjekjet për përmirësimin e kuadrit strategjik dhe ligjor për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut si dhe pakicave. Një hap pozitiv është shënuar me miratimin e Udhëzimit nr. 10, datë 17.5.2021, i ministrit të Arsimit dhe Sporteve “Për regjistrimin dhe mbështetjen në institucionet e arsimit parauniversitar publik të fëmijëve të personave në situatë migrimi/azili, refugjatë, të fëmijëve të huaj të pashoqëruar, të fëmijëve që kthehen nga emigracioni, nga zonat e konfliktit apo fëmijë viktime të trafikimit, në Republikën e Shqipërisë”<sup>71</sup>

*Objektivi specifik: Ngritja e kapaciteteve të vetëqeverisjes vendore për të zbatuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut*


<sup>69</sup> Progres Raporti i KE për Shqipërinë (2021)

<sup>70</sup> Raporti i monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit Shtator 2021, Ministria e Drejtësisë

<sup>71</sup> Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sporteve


- Në vitin 2021 janë kryer në total 108 programe trajnimi, ose mesatarisht 2 trajnime për bashki (N=50) duke mbetur në të njëjtat nivele me vitin 2020 si edhe 2019. Janë vetëm 24 Bashki që kanë përfituar trajnime nga të cilat numri më i madh raportohet nga Bashkia Kamëz (20) pasuar nga bashkia Berat (16), dhe Këlcyrë (9).
- Në 2021 janë trajnuar 148 nëpunës vendorë mbi zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut ose mesatarisht 3 nëpunës për bashki (N=52). Numri i nëpunësve të trajnuar është rritur me rreth 9% në krahasim me 2020 ku numrin më të madh e kanë Bashkia Tiranë (25), Bashkia Kamëz (20) dhe Bashkia Berat (15).

Grafiku 26: Numri i trajnimeve nga autoritetet/ OSHC mbi standardet e të drejtave të njeriut 2021



- Në vitin 2021, janë trajtuar gjithsej 929 raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut në bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile, ose mesatarisht 17 raste për bashki (N=56); Vihet re një rritje e theksuar e rasteve të trajtuara në nivel vendor krahasuar me vitin 2020 (9 raste mesatarisht). Numrin më të madh të rasteve të trajtuara e ka Bashkia Kamëz (317 raste), Bashkia Fier (200 raste), Bashkia Durrës (169 raste) dhe Bashkia Pogradec (117 raste).
- Raste të shkeljeve të të drejtave të njeriut në 2021 janë referuar gjithsej 1485 ose rreth 2.5 herë më shumë se numri i referuar në vitin 2020 (557). Numrin më të madh të rasteve të referuara për shkelje të të drejtave të njeriut e ka Bashkia Durrës (632 raste) pasuar nga Bashkia Kamëz (317 raste) dhe Bashkia Fier (200 raste).
- Në vitin 2021, numri i rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut të trajtuar nga grupet ndërinsticionale të Bashkisë është në total 836 raste ose mesatarisht 14 raste për Bashki (N=59) nga 515 raste të trajtuara në 2020. Bashkia Durrës ka numrin më të madh (169 raste) e ndjekur nga Bashkia Kamëz (174 raste) dhe Fier (150 raste).

Grafiku 27: Nëpunës të administratës vendore të trajnuar mbi standardet e të drejtave të njeriut 2017-2021





**Kutia 5 - Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në 2021**

**Bashkia Gramsh:** Ka trajtuar 10 raste të dhunës në familje dhe 8 raste të shkeljes së të drejtave të fëmijëve, në bashkëpunim me psikologë të Forumit të Gruas Elbasan që mbështet viktimat e dhunës. Secili rast në bazë të problematikës që ka pasur ka marrë shërbimin e nevojshëm.

**Bashkia Kamëz:** Në bashkëpunim me OSHC të licensuara ka trajtuar 317 raste të shkeljes së të drejtave të njeriut. Karakteristikat e rasteve kanë të bëjnë me: dhunë fizike, psikologjike, seksuale, trafikim, fëmijë në situatë rruge, neglizhim, braktisje shkolle.

**Bashkia Patos:** Ka trajtuar 8 raste të të mbijetuarave të dhunës në familje në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare, duke ofruar asistencë ligjore dhe psikologjike, mbështetje me paketa ushqimore, veshmbathje dhe kite shkollore për fëmijët.

**Bashkia Prenjas:** Ka trajtuar 8 raste në bashkëpunim me Forumin e Gruas Elbasan dhe 1 rast me Organizatën "Une Gruaja" në Pogradec.

**Bashkia Tiranë:** Fondacioni "Së bashku" ka ngritur shqetesimin e një individi me aftësi të kufizuara që nuk ka pasur akses për të ndjekur një koncert në stadiumin "Air Albania". Problematika është transmetuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Bashkia ka mbajtur qëndrimin që aksesueshmëria në stadione është kompetencë e Federatës Shqiptare të Futbollit.

**Problemet dhe sfidat**

- Problematikë vazhdon të jetë kapacitetet e pamjaftueshme në bashki për të trajtuar rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut. Mungesa e stafëve të dedikuara dhe të trajnuara për këto aspekte.
- Sfidë mbetet koordinimi ndërinstitucional për referimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut dhe trajtimin e tyre në kohë dhe me efektivitet dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për të raportuar rastet pranë autoriteteve vendore.
- Burimet financiare të bashkive për të trajtuar me efektivitet rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe veçanërisht trajtimin e pakicave.
- Bashkëpunimi me OSHC të specializuara kombëtare dhe nderkombëtare është ende i kufizuar ndërkohë që mungojnë Organizatat e licensuara në Bashkitë e vogla.

**Rekomandime**

- Rritja e bashkëpunimit midis institucioneve dhe OSHC-ve për trajtimin e rasteve të referuara me ekspertizën e tyre si dhe për të përfutur nga trajnimet që u ofrohen nëpunësve vendorë.
- Përmirësimi i njohurive dhe rritja e vetëdijes për standardet e të drejtave të njeriut për zyrtarët vendorë përmes trajnimeve dhe pjesëmarrësjes në konferenca kombëtare e rajonale.
- Rritja e burimeve financiare për trajtimin e problematikave të fëmijëve dhe përmirësimi i instrumentave për të realizuar buxhetimin me qendër fëmijën në nivel qendror dhe vendor.
- Forcimin e kapaciteteve të punonjësve që mbulojnë fushën e mbrojtjes dhe shërbimeve të fëmijëve dhe ofrimi i trajnimeve të specializuara dhe njohura nga institucionet koordinuese lidhur me këtë fushë<sup>72</sup>.

<sup>72</sup>"Agjenda Kombëtare e Mbrojtjes së Fëmijëve 2021"

## **PËRFUNDIME MBI TË DREJTAT E NJERIUT**

**Ka vazhduar bashkëpunimi me OSHC për të trajtuar rastet e referuara për shkelje të të drejtave të njeriut në nivel vendor edhe në vitin 2021. Ky bashkëpunim ka sjellë edhe dyfishimin e rasteve të trajtuara për Bashki. Megjithatë mbetet ende problematikë mungesa e OSHC të specializuara dhe të licensuara në bashkitë e vogla.**

**Progres i limituar është bërë në drejtim të rritjes së kapaciteteve të nëpunësve vendor mbi çështjet e të drejtave të njeriut. Vetëm 40% e bashkive kanë përfituar trajnime në vitin 2021 për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve publikë vendorë për zbatimin e standarteve të të drejtave të njeriut.**

2

KRITERI  
EKONOMIK

## 2. EKZISTENCA E NJË EKONOMIE TREGU FUNKSIONALE

*Ekonomi tregu funksionale dhe aftësia për të trajtuar konkurrencën e BE-së dhe forcat e tregut*

**“Shqipëria ka bërë njëfarë progresi dhe ka njëfarë niveli përgatitjeje në kapacitetin e saj për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së. Ajo ka bërë përmirësime në infrastrukturën e energjisë dhe transportit, përdorimin e komunikimit dixhital dhe në rezultatet e arsimit, por mbeten boshllëqe të konsiderueshme në krahasim me homologët e saj rajonalë dhe evropianë. Konkurrueshmëria e Shqipërisë pengohet nga mungesa e njohurive sipërmarrëse dhe teknologjike, nivelet e konsiderueshme të informalitetit, nevojat e paplotësuara për investime në kapitalin njerëzor dhe fizik dhe shpenzimet e ulëta për Kërkim dhe Zhvillim. Boshllëqet e mëparshme dhe të konsiderueshme në nivelin e aftësive dhe në arsim janë thelluar ndoshta për shkak të izolimit të lidhur me COVID-19 dhe mësimit në distancë, i cili nuk është i mundur për të gjithë.<sup>73</sup>”**

Gjatë vitit 2021 janë diskutuar disa projektakte në Këshillin Konsultativ për vetëqeverisjen vendore sic janë:

- Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve dhe të Planit të Veprimit 2021-2027”. Strategjia e re i kushton vemendje të vecantë zhvillimit të biznesit dhe investimeve duke i konsideruar ato si kushte themelore drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 30.7.2021.
- Projektligji “Për ndërmarrjet mikro, të vogla e të mesme”, i cili ka si qëllim rritjen e mbështetjes për biznesin dhe forcuar konkurrueshmërinë e tyre dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik të vendit.
- Projektligji “Për mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve inovative”, i cili ka si qëllim krijimin e një kuadri rregullator dhe institucional që favorizon krijimin dhe zhvillimin e bizneseve të reja me potencial të lartë në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, të cilat realizojnë ide, modele, produkte dhe procese të reja biznesi dhe që sjellin përmirësim në disa fusha të ekonomisë.
- Projektvendimi “Për përcaktimin e metodologjisë dhe kriterëve të llogaritjes së kuotës BID” dhe udhëzimit “Për miratimin e marrëveshjes operacionale TIP”, i cili ka për qëllim të miratojë Marrëveshjen Operacionale TIP që lidhet midis Organizatës BID-Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID) dhe Bashkisë përkatëse.

### **Objektivi specifik: përmirësimi i mjedisit të biznesit**

Progresi mbi objektivin specifik vlerësohet nga pesë (5) tregues performace:

Në 2021 kanë **hartuar dhe miratuar planin e zhvillimit vendor në Këshillin Bashkiak në total 54 Bashki** (ose 88% e bashkive N=60). **Treguesi tregon rritje të lehtë me 6 p.p. krahasuar me vitin 2020.** Janë 6 Bashki<sup>74</sup> të cilat nuk e kanë miratuar Planin e Zhvillimit Vendor ndërkohë që Bashkia Durrës nuk ka dhënë asnjë informacion për këtë tregues. Plani i Zhvillimit Vendor është një mjet planifikimi tepër i rëndësishëm për orientimin e prioritetëve vendore drejt nevojave të komunitetit dhe lidhja e tyre me programin buxhetor vjetor dhe afat-mesëm.


<sup>73</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

<sup>74</sup> Devoll, Has, Këlcyrë, Peqin, Polican, Tepelenë


**Kutia 6: Aktivitete stimuluese në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme**

- **Bashkia Shkodër:** Ka krijuar Platformën Elektronike "Taksat e mia" duke ofruar shërbime online në të gjitha njësitë administrative. Është ngritur dhe funksionon për herë të parë në vendin tonë platforma "Tregu i Punës Shkodër". Është ofruar mbështetje financiare për bizneset e zonave tregtare që sjellin një koncept të ri për zonën.
- **Bashkia Tiranë:** Janë 25 biznese perfituese te Grantit të Gjelbërt dhe përgatitur 12 paketa informuese me rekomandime dhe informacione; Janë dhënë 25 ambjente me çira dhe 50 biznese të trajnuara "Mbështetje financiare/Grant për Biznese të Gjelbërta (të reja dhe ekzistuese).
- **Bashkia Gramsh:** Ka organizuar disa panaire për promovimin dhe nxitjen e bizneseve që operojnë në fushën e turizmit dhe kulinarisë lokale.
- **Bashkia Këlcyrë:** Ka organizuar panairin e prodhimeve blegtorale-bujqësore karakteristike të zonës.
- **Bashkia Berat:** Ka ngritur qëndrën për zhvillimin e Agrobiznesit si mbështetje për biznesin turistik dhe për markën e cilësise lokale.

Harta 9: Miratimi i Planeve të Zhvillimit Vendor, 2021




Grafiku 28: Miratimi i Planit të Zhvillimit Vendor në Këshillin Bashkiak 2017-2021



Në vitin 2021 janë ndërmarrë 77 **aktivitete stimuluese për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla** në zbatim të planeve të zhvillimit vendor. Vetëm 21 Bashki kanë raportuar që kanë ndërmarrë aktivitete stimuluese mesatarisht 1.57 për bashki). Treguesi ka ulje nga viti 2020 ku janë raportuar 89 aktivitete. Numrin më të madh të aktiviteteve stimuluese e ka ofruar Bashkia e Beratit (18) pasuar nga Bashkia Kamëz (8) dhe Bashkia Shkodër (8).

- **Grafiku 29: Aktivitete stimuluese në mbështetje të biznesit të vogël e të mesëm**



- Në 2021 janë raportuar **në total 186 shërbime në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ose mesatarisht 3.72 për bashki** (N=50). Treguesi ka pësuar një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2020 ku janë raportuar 150 shërbime. **Vetëm 38% e bashkive kanë ofruar shërbime** ku numrin më të madh e raporton Bashkia Tiranë me 112 shërbime pasuar nga Bashkia Shkodër me 9 shërbime, Shijak dhe Kamëz me nga 6 shërbime.

Gjatë vitit 2021, janë ofruar lehtësira fiskale dhe shërbime mbështetëse për disa iniciativa stimuluese si lehtësi në pagesa (pagesa me këste të taksave), vendosja e tarifave sezonale për turizmin (Bashkia Tropojë) Hartimi dhe përditësimi i paketave informuese për bizneset me rekomandime dhe informacion mbi instrumentat ose iniciativat nga autoritetet publike kombëtare, rajonale, të BE-së e më gjerë, që ofrojnë fonde publike, kapital në ndihmë të bizneseve (Bashkia Tiranë); Lehtësira fiskale për NVM e reja, heqje e tarifës së regjistrimit për subjektet e reja, si dhe krijimi i zonave depresive ekonomike, me lehtësira fiskale për subjekte ekzistuese dhe të reja në këto zona (Bashkia Berat).

- **Në vitin 2021, është raportuar krijimi i 14017 ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, ose mesatarisht 241.67** (N=58). Bashkia e Tiranës raporton numrin më të madh të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të krijuara (7170), pasuar nga Bashkia Shkodër (905) dhe Bashkia Elbasan (624). Numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që kanë filluar aktivitetin në territorin e bashkive ka patur rritje prej 40% nga viti 2020.
- **Numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të cilat kanë mbyllur aktivitetin në territorin e Bashkisë në 2021 është raportuar në total 6786, ose mesatarisht 117 NVM për bashki.** Numrin më të madh të ndërmarrjeve të mbyllura e kanë sërish bashkitë e përmendura më lart të cilat kanë raportuar edhe numrin më të madh të bizneseve të hapura. Bashkia e Tiranës raporton numrin më të madh të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të mbyllura në 2021 (2560), Bashkia Shkodër (881), Bashkia Himarë (855).

### Problemet dhe sfidat .....

- Kapacitetet e ulëta të bashkive për të ofruar këshillime dhe orientime të bizneseve të reja dhe mundësitat që egzistojnë për ngrijen e sturt-up-eve.
- Kapacitetet njerëzore dhe burimet financiare tepër të limituara për hartimin e planeve vendore të zhvillimit.

- Mungesë informacioni mbi tregun e punës nga kërkuesit por edhe ofruesit për kualifikimin e punëkërkuesve.
- Instrumenta të pamjaftueshëm dhe mungesa e financimeve për promovimin e produkteve agropërpunuese sipas prodhimeve karakteristike të zonave.
- Ofrimi i një numri të kufizuar të shërbimeve të integruara për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Sfidë mbetet lufta kundër informalitetit.

### Rekomandime .....

- Ndërtimi i instrumentave dhe programeve për mbështetjen e NVM-ve si dhe krijimin e incentivave për t'ju qasur sektorëve më prioritarë dhe potencialeve të zhvillimit në territorin e Bashkisë.
- Bashkëpunimi më i ngushtë me institucionet ndërkombëtare dhe donatorët që mbështesin me programe të dedikuara zhvillimin e NVM-ve egzistuese si dhe krijimin e Start-up-ve.
- Krijimi i mekanizmave efektivë të konsultimit me bizneset dhe partnerët socialë dhe rritjen e shërbimeve mbështetëse të biznesit për të përmirësuar aksesin në financa dhe njohuritë e sipërmarrjes.
- Lehtësimi i aksesit në informacion përmes hapjes së seksionit të dedikuar për bizneset në procedurat e ankimimit administrativ në regjistrin elektronik të kërkesave në njësitë e vetëqeverisjes vendore<sup>75</sup>.
- Orientimi i shpenzimeve publike drejt zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe inovacionit, dhe stimulimi i lidhjes ndërmjet bizneseve inovative dhe akademisë.

## PËRFUNDIME MBI EKZISTENCËN E NJË EKONOMIE TREGU FUNKSIONALE

**Nxitja e zhvillimit ekonomik dhe rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë vendore ka vijuar të jetë në vëmendjen e Bashkive përmes hartimit dhe miratimit të planeve vendore të zhvillimit.** Në vitin 2021 janë 54 Bashki që kanë miratuar një Plan Vendor Zhvillimi për të orientuar vendimarrjen drejt prioriteteve lokale dhe siguruar një zhvillim të qëndrueshëm. Sfidë vazhdon të mbetet zbatimi i planeve vendore dhe pamjaftueshmëria e buxheteve të bashkive për tju përgjigjur nevojave të mëdha për projekte strategjike zhvillimore.

**Progres është shënuar në përmirësimin e kuadrit Strategjik dhe Ligjor për nxitjen e krijimit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme duke rritur kapacitetet teknologjike.** Megjithë efektet nga Pandemia e COVID 19 në ekonominë lokale edhe në 2021 janë ndërmarrë disa iniciativa për të zvogëluar impaktin negativ tek bizneset përmes lehtësirave fiskale të ofruara në një numër të madh të bashkive. **Kapacitetet njerëzore dhe financiare të Bashkive për të mbështetur me aktivitete dhe financime direkte për krijimin e bizneseve të reja mbeten shumë të ulta dhe e përqëndruar tek bashkitë e mëdha.**

**Janë bërë përpjekje nga një pjesë e bashkive për të orientuar dhe këshilluar NVM-të mbi mundësitë dhe potencialet për zhvillim duke i orientuar drejt tregut,** megjithatë më pak se gjysma e bashkive ofrojnë shërbimet në mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. **Hapja e bizneseve të reja ka vazhduar edhe gjatë vitit 2021.** Numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që kanë filluar aktivitetin në territorin e bashkive ka patur një rritje prej 40% krahasuar me vitin 2020. Ndërveprimi më i mirë i strukturave të bashkive me bizneset përmes lehtësimit të aksesit në informacion është një nga gjetjet në raportin e monitorimit të vitit 2021 të Sekretariatit të Këshillit të Investimeve. **Për këtë rekomandohet ngritja e një seksioni të dedikuar për bizneset në procedurat e ankimimit administrativ në njësitë e vetëqeverisjes vendore.**

<sup>75</sup> Raporti Monitorimit 2021 i Këshillit Shqiptar të Investimeve

3

AFTËSIA  
PËR TË MARRË  
PËRSIPËR  
DETYRIMET  
E ANËTARËSIMIT



### 3.1 KAPITULLI 11: BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI DHE RURAL

Politika e përbashkët bujqësore (PPB) mbështet fermerët dhe zhvillimin rural. Kjo kërkon sisteme të forta menaxhimi dhe kontrolli. Ka gjithashtu edhe rregulla të përbashkëta të BE-së për politikën e cilësisë dhe bujqësinë organike.

“Shqipëria ka një lloj niveli përgatitjeje në bujqësi dhe zhvillim rural. Është arritur njëfarë progresi duke siguruar kapacitete administrative për zbatimin e instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit për programin e zhvillimit rural (IPARD II). Progres u arrit në përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor për prodhimin organik me acquis të BE-së.”<sup>76</sup>.

**Ka patur progres të kufizuar drejt krijimit të një regjistri fermash.** Krijimi i tij dhe bërja plotësisht funksional mbetet një prioritet kyç si një element i sistemit të integruar të administrimit dhe kontrollit. Vendi nuk ka shënuar progres në krijimin e një sistemi identifikimi të parcelave të tokës (LPIS) dhe nuk ka rrjet të të dhënave të kontabilitetit të fermave (FADN).

Pagesat direkte të shoqëruara me prodhimin dhe që nuk u nënshtrohen rregullave të ndër-përputhshmërisë u ulën në periudhën 2020-2021, si në terma absolutë ashtu edhe në krahasim me mbështetjen indirekte (shpërndarja e naftës për fermerët). Nuk ka pasur përparim në **organizimin e tregut të përbashkët (CMO)**. Për **politikën e cilësisë**, progres është arritur me miratimin e legjislacionit zbatues të skemës tradicionale të garantimit të specialitetit. Legjislacioni i Politikës së Cilësisë është pjesërisht i harmonizuar me acquis të BE-së. Në 2021, pati vijueshmëri në mbështetjen për bujqësinë organike<sup>77</sup>.

Në mbështetje të bujqësisë, Qeveria alokoi 1 miliard lekë në bankat e nivelit të dytë si Fond Sovran Garancie nga shteti për të financuar 50% të kolateralit për kredi në bujqësi. Fondi është i vlefshëm për operatorët të cilët janë duke planifikuar një investim në prodhimin e produkteve bujqësore, dhe ato të lidhura me ekonominë blu, për ndërtimin e serrave, rritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së paketimit të prodhimeve vendase, në sistemet e ujitjes me pika në parcelat e tyre, në përpunimin e produkteve, dhe në raftet e supermarkatave në mënyrë që produktet shqiptare të mos jenë produkte gjenerike, por produkte të seleksionuara dhe të paketuara për konsumatorin final.

Thirrja IV e programit IPARD II, me financimet nga BE dhe Qeveria shqiptare për Turizën Rural dhe Zejtari u hap me një buxhet prej 5.2 milione euro. Një nga synimet e marrëveshjes Open Balkan me Serbinë e Maqedoninë është rritja e eksporteve shqiptare. Në 2021, eksportet bujqësore u rritën në vlerë prej 15.6% krahasuar me vitin 2020.


*Në nivel vendor, synimet e politikës kombëtare për bujqësinë dhe zhvillimin rural dhe në kuadër të integrimit evropian, vlerësojnë progresin në arritjen e rezultateve të lidhura me tre objektiva specifike: (i) forcimi i kapaciteteve të administratës të vetëqeverisjes vendore për sistemin e bujqësisë, zhvillimit rural dhe këshillimor, (ii) përmirësimi i produktivitetit dhe konkurrencës në sektorin e bujqësisë, (iii) zbatimi i qasjes LEADER.*

#### **Rritja e kapaciteteve të administratës vendore në sistemin e bujqësisë, zhvillimit rural dhe këshillimor:**


Veprimtari e rëndësishme e shërbimit këshillimor është nxitja e organizimit të fermerëve dhe këshillimin në rritjen e produktivitetit dhe cilësisë dhe përballimin e sfidave të prodhimit dhe vështirësive të motit. Në 2021, ka patur progres të lehtë në ngritjen e **Zyrës të Informacionit dhe të Këshillimit Bujqësor (ZIKB)**, e cila ka qenë funksionale në **41 bashki** krahasuar me 38 bashki në fund të vitit 2020 (N=59). Bashkitë që kanë ngritur ZIKB, gjatë vitit 2021, janë Bashkia Lezhë, Vorë dhe Belsh.

<sup>76</sup> Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

Harta 10: ZIKB funksionale




Grafik 30: ZIKB në NJVV, 2021



Fondi bujqësor për zhvillimin rural ka pësuar ulje mesatarisht në 4.16% të buxhetit vendor krahasuar me 5.3% të raportuar në vitin 2020 dhe 7.7% në 2019 (N=55). Bashkia Fushë-Arrëz ka patur alokimin më të lartë për bujqësinë (20%) në buxhetin vendor ndjekur nga Bashkia e Divjakës, Libohovës (15%) dhe Bashkia Dropull (14%). Rreth 50% e NJVV kanë patur një fond për bujqësinë dhe zhvillimin rural më të lartë se 4% të buxhetit vendor.

Grafiku 31: Fondi vendor për zhvillimin bujqësor dhe rural, 2021



**Numri i personave të cilët kanë përfituar nga trajnimi dhe këshillimi**, gjatë vitit 2021, ka qenë rreth 29882 duke ruajtur pothuajse të njëjtin nivel me vitin 2020 (N=52). Bashkia Elbasan dhe Divjakë raportojnë numrin më të lartë të përfituesve (6000), Bashkia Prrenjas 3100 fermerë, Fier 2500, Roskovec 1630. Rreth 22 bashki nuk kanë ofruar të dhëna të vlefshme për treguesin (Bashkia Mat, Këlcyrë, Pukë, Mirditë, Berat, Has, Cërrik, Peqin, Dimal, Kavajë, Tropojë, Mallakastër, Skrapar, Kamëz, Delvinë, Poliçan, Malësi e Madhe, Tepelenë, Durrës, Vorë, Krujë).

### Kutia 7: Sfida për këshillimin në bujqësi

**Bashkia Devoll:** Shërbimi dhe shpërndarja e informacionit në lidhje me rrugët e reja të zhvillimit të bujqësisë ka qenë i vazhdueshëm nga ana e specialistëve të bujqësisë, por sfida mbetet stoku i prodhimeve bujqësore, duke l bërë fermerët të mos jenë shumë aktive në aktivitetet e zhvilluara. Fondi prej 4.9% për bujqësinë nuk është i mjaftueshëm për zgjidhjen e problemeve.

**Bashkia Dibër:** Bashkëpunimi me institucionet e qeverisë qendrore sidomos me autoritetin për mbrojtjen e bimëve për dhënien e ndihmës teknike për fermerët në kohën e duhur. Nevojitet mbështetje për logjistikë për inspektime në terren.

**Bashkia e Durrës:** Duhet të plotësohen me agronomë njësitë administrative në zonat rurale.

**Bashkia Gjirokastrë:** Rritja e cilësisë së dhënies së shërbimit.

**Bashkia Kamëz dhe Rrogozhinë:** Ngritja e ZKIB dhe rritja e financimit nga buxheti i bashkisë.

**Bashkia Klos:** Krijimi një strukture (drejtorie) për bujqësinë dhe pyjet.

**Bashkia Korçë:** Plotësimi i strukturës së zyrës me staf. Planifikimi i një fondi të caktuar për programe në fushën e bujqësisë.


**Bashkia Selenicë:** Shërbim sa më i mirë për qytetarin.

**Objekivi specifik:** përmirësimi i produktivitetit dhe konkurrencës në sektorin bujqësisë, përmirësimi i infrastrukturës rurale, zhvillimi i balancuar territorial dhe ekonomik i zonave rurale.

Treguesit e performancës në lidhje me këtë objektiv specifik përfshijnë: (i) përmirësimin e menaxhimit dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes, (ii) përmirësimin e menaxhimit dhe mirëmbajtjen e sistemit të kullimit (iii) grante të dhëna për fermerët.

Bazuar në raportimin e NJVV për vitin 2021, ka një ulje të lehtë të normës së shërbimeve bashkiake për mirëmbajtjen e **sistemit të rrjetit të ujitjes** në **52.8%** krahasuar me nivelin 54% për vitin 2020 (N=57). Bashkitë që kanë një nivel të ulët të mirëmbajtjes së sistemit të rrjetit ujitës janë Bashkia Patos (10%), Gramsh (7.6%), Kamëz dhe Belsh (rreth 5%), dhe Mallakastër (2%).


Grafiku 32: Shkalla e mirëmbajtjes së rrjetit ujitës, 2021



Ka patur përmirësim në ofrimin e shërbimeve për mirëmbajtjen e rrjetit të kullimit në **63.9%**, ose +2.9 p.p. krahasuar me vitin 2020 (N=58). **Më shumë bashki kanë rritur normën e mirëmbajtjes për rrjetin e kullimit.** 46 NJVV (ose 75% e tyre) ka një normë mirëmbajtje të rrjetit kullues mbi 60%.


Siç paraqitet në grafikun më poshtë, norma e mirëmbajtjes së sistemeve të ujitjes dhe kullimit, të administruar nga NJVV-e, ka patur luhatje të lehta në vitet 2018-2021.

Grafiku 33: Shkalla mesatare e mirëmbajtjes së rrjetit të ujitjes dhe kullimit nga NJVV, 2018-2021




Bashkitë raportojnë se mesatarisht **79.5% e rrjetit ujitës dhe kullues është marrë në dorëzim nga NJVV** (n=55). Treguesi duhet të jetë më i lartë, për arsye se disa bashki raportojnë një normë të ulët të inventarizimit (nën 50%), ndërsa disa bashki nuk kanë ofruar të dhëna për treguesin, si bashkia Durrës, Has, Mallakastër, Memaliaj, Skrapar, Poliçan, Malësi e Madhe, Delvinë dhe Fushë-Arrëz.

Grafiku 34: Shkalla e marrjes në inventar nga bashkitë të rrjetit të ujitjes dhe kullimit, 2021



Në 2021 raportohet një ulje e normës mesatare të sipërfaqes së ujitur krahasuar me sipërfaqen e plotë të tokës bujqësore të administruar nga NJVV, në **38.3% mesatarisht** në krahasim me vitin 2020 (42.48%). Nëntë (9) bashki kanë patur një normë të ujitjes 0,02% – 10%, ndërsa 3 bashki nuk kanë ofruar të dhëna për treguesin (Bashkia Durrës, Skrapar dhe Poliçan), N=58.

Grafiku 35: Sipërfaqja e tokës bujqësore që ujitet në raport me totalin e sipërfaqes



### Kutia 8: Sfida për mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes dhe kullimit

**Bashkia Belsh:** Mungesa e fondeve ka ngadalësuar procesin e rehabilitimit të sistemit kullues.

**Bashkia Berat:** Investimet me anë të projekteve në infrastrukturen ujore do të kontribuojnë në përmirësimin e gjendjes ekzistuese për kanalet ujëtare. 3675 ha është sipërfaqja ujëtare totale sipas inventarit për Bashkinë Berat.

**Bashkia Devoll:** Është e papërballeshme nga fondet e Bashkisë Devoll për të vënë në funksionim të plotë skemat ujëtare me stacione pompimi.

**Bashkia Dibër dhe Dropull:** Nevojiten investime për përmirësimin e segmenteve të rrjeteve ujëtare.

**Bashkia e Dropull:** Mungesë të fondeve dhe infrastruktura rurale e vështirëson akoma me shumë punën.

**Bashkia Kamëz:** Përcaktimi i buxhetit specifik për mirëmbajtjen dhe vënien në funksion të sistemit.

**Bashkia Korgë:** Rritja e nivelit deri në 70%.

**Bashkia Kurbin:** Sfidë është rehabilitimi i plotë i kanaleve të tjera parësore dhe sekondare.

**Bashkia Lezhë:** Të bëhet lirimi i kanaleve kulluese të zëna, të fillojë puna për rikonstruksionin e KU në fillim të vitit.

**Bashkia Maliq:** Pastrimi i kanaleve të 3-të, në këtë mënyrë quhet i plotë kullimi i gjithë fushës. Rritja e përqindjes së kanaleve të pastruar duke kryer ciklin e dytë të pastrimit.

**Bashkia Kolonjë:** Rritja e kapaciteteve financiare për përmirësimin në zonat rurale.

**Bashkia Përmet:** Kapacitete të ulta financiare për investime

**Bashkia Sarandë:** 80% përmirësim

**Bashkia Mirditë:** Përfshirja në skemën e vaditjes edhe të 400 ha tokë të tjera falë investimit nga Projekti me financim nga RDPA për rehabilitimin e 9.8 km kanal vaditës (përfundon në Shkurt 2022).


**Bashkia Patos:** Sfidë mbetet implementimi i skemave të reja ujëtare me burim uji alternativ si p.sh. Lumi Seman ose Kolektori Roskovec-Hoxhare.

#### Objektivi specifik: zbatimi i metodës LEADER


Progres është bërë më lidhur me zbatimin e përfaqes LEADER<sup>78</sup> nga Bashkitë në vitin 2021. Shtatë bashki raportojnë krijimin e Grupeve Vendore të Veprimit (GVV/LAG) duke arritur në 25 gjithsej (ose 41% e bashkive), krahasuar me 18 bashki në vitin 2020 (N=60). Bashkitë që kanë ngritur GVV për zhvillimin rural në vitin 2021 kanë qenë Bashkia Kukës, Vorë, Peqin, Divjakë, Kolonjë, Finiq dhe Sarandë.

<sup>78</sup> Metoda LEADER lidhet me fuqizimin vendor nëpërmjet zhvillimit të strategjisë vendore në bujqësi dhe rritjes së mundësisë për përthithjen e fondeve. Instrument për zbatimin e metodës është krijimi i Grupit Vendor të Veprimit (GVV), i cili është me përfaqësi nga aktorë të ndryshëm: sektori publik, sektori privat (fermerë, etj) dhe shoqëria civile. Qëllimi është të mbështeten fermerët dhe aktorët tjerë të rëndësishëm nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të strategjisë së integruar të zhvillimit rural

Grafiku 36: Ngritja e Grupit Vendor të Veprimit, 2019-21



Harta 11: Ngritja e GVV, 2021



Disa nga sfidat dhe rekomandimet janë të vlefshme për periudhën e raportimit:

**Problemet dhe sfidat** .....

- Mungesë e agronomëve në Njësitë Administrative (rurale), mungesë strukturore (drejtorie) dhe punonjës të kualifikuar për bujqësinë dhe pyjet në disa bashki.
- Sfidë mbetet stoku i prodhimeve bujqësore, duke i bërë fermerët të mos jenë shumë aktive në aktivitetet e zhvilluara me zyrën e këshillimit.
- Mungesë të financimit të mjaftueshëm nga NJVV për të vënë në funksionim të plotë skemat ujitëse me stacione pompimi dhe për të rritur nivelin e pastrimit dhe mirëmbajtjes të gjithë rrjetit ujitës dhe kullues.
- Inventarizimi i ulët dhe jo i përditësuar i rrjetit ujitës dhe kullues të disa bashkive duke hequr kanalet që nuk ekzistojnë më.
- Nivel i ulët i pagesës për tarifën e shërbimit të ujitjes, menaxhim financiar i dobët apo jo transparent, pasiviteti i Organizatave të Përdoruesve të Ujit (OPU-ve).

**Rekomandime**

- Rritja e financimit nga qeveria për bujqësinë dhe zhvillim rural krahas financimit nga programi IPARD<sup>79</sup>, si dhe financimi nga buxheti vendor i bashkive për këtë sektor të rëndësishëm.
- Drejtoritë Rajonale të U&K dhe bashkitë, në bashkëpunim me OPU-të, duhet të hartojnë buxhetin vjetor të sistemit ujitës bazuar në nevojat dhe kërkesat e fermerëve të përshkruara në Planin e Shërbimit të Ujitjes.
- Hartimi i skemave ujitëse bazuar në buxhete specifike dhe në performancë shërbimi.
- Planifikimi i fondeve specifike në buxhetin vendor për mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes dhe kullimit dhe raportimi mbi shpenzimet për këtë funksion i shoqëruar me tregues të performancës për të llogaritur kosto-efektivitetin e shërbimit.
- Rritja e përpjekjeve për krijimin e një sistemi identifikimi të parcelave të tokës (SIPT)<sup>80</sup>.
- Zgjerimi i aktiviteteve të këshillimit dhe trajnimit të ZIKB në të gjitha NJVV.
- Ngritja e GVV /LAG në të gjitha bashkitë te vendit dhe operacionalizimi efektiv i tyre.
- Mirëmbajtja dhe rikonstruksioni i rezervuareve dhe veprave, dhe krijimi i një fondi specifik në buxhetin e bashkisë për këtë qëllim.

**PËRFUNDIME MBI BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL**

**Progres i lehtë është kryer lidhur me krijimin e një regjistri fermash, dhe krijimin e një sistemi identifikimi të parcelave të tokës (LPIS).** Mungon rrjeti i të dhënave të kontabilitetit të fermave (FADN). Për politikën e cilësisë, progres është arritur me miratimin e legjislacionit zbatues të skemës tradicionale të garantimit të specialitetit dhe në sigurimin e vijueshmërisë të mbështetjes për bujqësinë organike<sup>81</sup>. U rrit mundësia e kreditimit nga Qeveria, e cila alokoi 1 miliard lekë në bankat e nivelit të dytë si Fond Sovran Garancie nga shteti, për të financuar 50% të kolateralit për kredi në bujqësi.

**NJVV kanë financuar më pak sektorin e bujqësisë krahasuar me vitin 2020 dhe 2019** - norma mesatare ka qenë 4.16% në vitin 2021. Përmirësim është kryer me zgjerimin e Zyrave të Informacionit dhe të Këshillimit Bujqësor, por numri i përfituesve të mbështetur më shërbime nga ZIKB ka qenë në nivel të njëjtë krahasuar me vitin 2020.

**Evidentohet një ulje e lehtë e mirëmbajtjes së sistemit të rrjetit ujitës krahasuar me vitin e mëparshëm, por ka patur përmirësim lidhur me mirëmbajtjen e kanaleve të kullimit.** Për bashkitë, sfida mbeten rritja e financimit për sektorin e bujqësisë, eliminimi i stokut të prodhimeve bujqësore, mungese e strukturave dhe stafëve në disa bashki.

**Rekomandohet** zgjerimi i aktiviteteve të këshillimit dhe trajnimit të ZIKB në të gjitha NJVV, ngritja e GVV /LAG në të gjitha bashkitë te vendit dhe operacionalizimi efektiv i tyre, hartimi i buxhetit vjetor të sistemit ujitës bazuar në nevojat dhe kërkesat e fermerëve dhe bazuar në performancë shërbimi, si dhe plotësimi i strukturave me punonjës të kualifikuar dhe agronomë për njësitë administrative rurale.

<sup>79</sup> Progres Raporti për Shqipërinë (Nëntor 2021)

<sup>80</sup> Raport Progresi për Shqipërinë (Nëntor 2021)

<sup>81</sup> Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

## 3.2 KAPITULLI 12: POLITIKAT E SIGURISË USHQIMORE, VETERINARISË DHE FITOSANITARE

Rregullat e higjienës në BE për prodhimin e produkteve ushqimore sigurojnë një nivel të lartë të sigurisë ushqimore. Shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve dhe siguria ushqimore me origjinë shtazore garantojnë së bashku me cilësinë e farave, materialin për mbrojtjen e bimëve, mbrojtjen nga organizmat e dëmshëm dhe ushqimin e kafshëve<sup>83</sup>.

Shqipëria ka një lloj niveli përgatitjeje në këtë fushë dhe ka bërë njëfarë progres gjatë periudhës së raportimit. Është krijuar Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, i cili nuk ka fituar ende kapacitetet të plotë operacional. Nevojitet një politikë sektoriale koherente dhe për të nisur përafrimin e acquis-it të BE-së mbi kontrollet zyrtare, shëndetin e kafshëve dhe shëndetin e bimëve<sup>84</sup>.

Në 2021, është miratuar vendimi i Qeverisë (VKM nr.443, Korrik 2021) "Për miratimin e Rregullores për parapaketimin", dhe tre udhëzime për foshnjat dhe fëmijët e vegjël, ushqimin për qëllimet të veçanta mjekësore (Udhëzim Nr.20, datë 22.11.2021), Udhëzim i Ministrit mbi kërkesat specifike të higjienës për mishin dhe produktet e mishit (Udhëzim Nr. 17, Shtator 2021), dhe Udhëzim i Ministrit mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimorë (Nr. 15, Shtator 2021).


Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) ka një qasje të re institucionale, për garantimin e sigurisë ushqimore. Bordi i AKU u rithemelua me përfaqësues nga shkenca, shoqatat e konsumatorëve, agrobiznesit, bashkive, etj për të mundësuar transparencë të plotë për publikun. AKU ka shtuar kontrollet dhe drejtoritë rajonale, dhe po mbështetet me asistencë nga një projekt<sup>85</sup> me financim të BE-së që synon forcimin organizativ dhe kapacitetet njerëzore të institucioneve shqiptare në lidhje me sigurinë ushqimore, rritjen e ndërgjegjësimit mbi sigurinë ushqimore dhe mbështetje për hartimin e legjisllacionit dhe rregullores në përputhje me standardët e BE-së. Gjithashtu asistencë po jepet për hartimin e një politike afat-gjatë dhe planin e veprimit për sistemin e sigurisë agro-ushqimore, si dhe organizimi i trajnimeve për 450 veterinerë zyrtarë, në bashkëpunim me Autoritetin Kombëtar për Veterinarinë dhe Mbrojtjen e Bimëve në përdorimin e një sistemi për regjistrimin dhe identifikimin e kafshëve (RUDA), si dhe një sistem monitorimi të situatës epidemiologjike në nivel kombëtar<sup>86</sup>.

Progresi i bashkive në fushën e sigurisë ushqimore dhe veterinarisë, vlerësohet nga dy objektiva specifike (9 tregues performance).

### Objektivi specifik: përmirësimi i kushteve sanitare dhe veterinarë me qëllim që të mbrohet shëndeti i konsumatorëve

Në 2021, rreth **29 raste** të shkeljeve në lidhje me sigurinë ushqimore janë raportuar nga 53 NJVV në lidhje me sigurinë ushqimore dhe veterinarë nga bashkia (mesatarisht 3 raste për 9 bashkitë që kanë raportuar raste të shkeljeve), N=53.

Grafiku 37: Numri i rasteve të shkeljeve në lidhje me sigurinë ushqimore të raportuara nga NJQV, 2021



<sup>83</sup> Raport i Progresit të KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)


<sup>84</sup> Raport i Progresit për Shqipërinë (Nëntor 2021)

<sup>86</sup> Raport i Progresit të KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)



Referuar treguesit mbi numrin e **tregjeve të kafshëve të gjalla të licensura** kundrejt numrit gjithsej të tregjeve të kafshëve të gjalla, raportohet një normë mesatare prej 20.9% (n=54), duke evidentuar përkeqësim të lehtë krahasuar me vitin 2020 (me normë mesatare **23%**).

Grafiku 38: Shkalla mesatare e liçensimit të tregjeve në NJQV, 2017-2021




Tetë (8) Bashki - Klos, Berat, Shkodër, Dimal, Prrenjas, Korçë, Vau i Dejës, Durrës, Vlorë raportojnë një normë 100% të liçensimit të tregjeve, ndërsa katër Bashki – Pogradec, Elbasan, Peqin dhe Bulqizë raportojnë një normë 33.3%. Bashkitë e tjera raportojnë zero ose nuk kanë ofruar të dhëna.

Gjithashtu, **vihet re një ulje e normës mesatare të treguesit “Shkalla e konformitetit të tregjeve publike të shitjes me pakicë** në 36.7% (n=54) krahasuar me vitin 2020 (40%)

**Ngritja e qendrave për mbrojtjen e kafshëve**, si një masë e politikës sektoriale të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, e cila duhet të gjejë zbatim nga NJVV, ka patur progres të lehtë - gjashtë (6) qendra kanë qenë funksionale krahasuar me pesë qendra në vitin 2020.

Harta 12: Zyra për mbrojtjen e konsumatorit




**Objektivi specifik: Funkionimi eficient i sistemit të mbrojtjes së konsumatorëve**

Progres është bërë në **ngritjen e zyrave të konsumatorit** pranë NJVV – në 2021. Raportohen se kanë qenë funksionale 34 zyra (56% e bashkive), ose 7 zyra më shumë krahasuar me vitin 2020 (27 zyra funksionale), N=61. Bashkitë të cilat kanë krijuar zyrat për mbrojtjen e konsumatorit gjatë vitit 2021 janë Bashkia Malësi e Madhe, Kukës, Elbasan, Durrës, Rrogzhinë, Mallakastër, Kolonjë dhe Fushë-Arrëz. Bashkia Lushnjë raporton se nuk e ka zyrën funksionale në vitin 2021 në dallim nga viti 2020.

Rritja e numrit të zyrave të konsumatorit mundëson rritjen e aksesit dhe ankimimit nga qytetarët për çështje të sigurisë ushqimore. **Numri i përgjithshëm i ankesave të dorëzuara nga qytetarët mbi sigurinë ushqimore ka qenë më i lartë në 2021** (378 ankesa në 2021 krahasuar me 292 ankesa në 2020). 18 LGUs kanë patur ankesa nga qytetarët, me një normë mesatare 21 ankesa; NJVV të tjera nuk kanë patur ankesa (N=53). Numri më i madh i ankesave raportohet nga Bashkia e Tiranës (81 ankesa), Bashkia Bulqizë (50 ankesa), Bashkia Dimal (36) dhe Bashkia Devoll (35).

**Norma e adresimit të ankesave** nga ana NJVV ka qenë 79% (297 ankesa të adresuara nga 378 ankesa gjithsej) (N=51); Ka patur bashki, të cilat kanë një normë adresimi 100%, si Bashkia e Tiranës, Bulqizë, Dimal, Fier; pak bashki kanë raportuar zero masa për adresimin e ankesave, si Bashkia Durrës, Bashkia Kukës ndërsa Bashkia Klos (50%).

Grafiku 39: Numri i ankesave të qytetarëve për sigurinë ushqimore dhe norma e adresimit të tyre nga NJVV



**Probleme dhe sfida**

- Riskonstruksioni i tregjeve për të siguruar përputhshmëri me standartet higjieno-sanitare.
- Krijim i një plani dhe planifikim buxhetor për të krijuar një treg të kafshëve në përputhje me standartet për bashkitë që nuk kanë një të tillë (psh. për Bashkinë Patos, Mallakastër, Klos)
- Mungesa e investimeve në ngritjen dhe përmirësimin e kushteve dhe standardeve të tregjeve.
- Ngritja e zyrës së konsumatorit pranë çdo bashkie.

- Kapacitetet e monitorimit dhe kontrollit të bashkive në lidhje me sigurinë ushqimore dhe veterinarisë janë të vogla prandaj ndërveprimi e koordinimi me drejtoritë rajonale të AKU dhe Agjencinë Kombëtare të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve është shumë domosdoshëm.

Disa nga rekomandimet për periudhën e mëparshme janë relevante edhe për këtë raportim:

#### Rekomandime .....

- Miratimi i një metodologjie të re të bazuar në rrezikun për planifikimin e kontrolleve zyrtare të sigurisë ushqimore; kontrollet zyrtare të kryhen sipas planeve vjetore të përditësuar të inspektimit mbështetur në një metodologji të përmirësuar të bazuar te rreziku për planifikimin e kontrolleve zyrtare të sigurisë ushqimore<sup>87</sup>.
- Përfundimi i ngritjes së zyrave për mbrojtjen e konsumatorëve i shoqëruar me trajnime për fuqizimin e kapaciteteve të nëpunësve të këtyre strukturave (fuqizimi i rolit monitorues/inspektues të shërbimeve bashkiake).
- Rritja e financimit nga ana e NJVV për të përmirësuar standardet e tregjeve dhe liqensimi i tyre plotë, në përputhje me protokollet dhe standardet e kërkuara.
- Adresimi i plotë i ankesave të qytetarëve në lidhje me sigurinë ushqimore dhe bërja transparente e masave të mara në përgjigje të ankesave të qytetarëve.
- Ngritja e qendrave për kafshët endacake në disa bashki që e kanë shumë të nevojshme, në përputhje me masat e politikës sektoriale.

## PËRFUNDIME MBI POLITIKAT E SIGURISË USHQIMORE, VETERINARE DHE FITOSANITARE

**Reforma e sektorit të veterinarisë është në proces zbatimi** dhe progres është bërë në forcimin e kapaciteteve organizative dhe profesionale të veterinerëve për mbrojtjen e konsumatorëve, sigurinë ushqimore dhe veterinare. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve nuk ka fituar ende kapacitet të plotë operacional. Nevojitet një politikë sektoriale koherente dhe përafrimi i acquis-it të BE-së mbi kontrollet zyrtare, shëndetin e kafshëve dhe shëndetin e bimëve. Legjislacioni është zgjeruar mbi rregullat e paketimit dhe disa udhëzime të Ministrisë për sigurinë ushqimore si dhe zhvillimi i një sistemi monitorimi të situatës epidemiologjike në nivel kombëtar.<sup>88</sup>

Në nivel vendor, progress i lehtë është bërë me krijimin e 7 zyrave për mbrojtjen e konsumatorëve në NJVV për adresimin e rasteve të ankmuara nga qytetarët lidhur me sigurinë ushqimore. Më shumë ankesa nga qytetarët mbi sigurinë ushqimore janë rregjistruar nga NJVV-e gjatë vitit 2021 krahasuar me një vit më parë, për të cilat bashkitë kanë marrë masat përkatëse në një nivel mesatar 79%.

**Sfida për bashkitë mbeten krijimi i zyrave për mbrojtjen e konsumatorëve në të gjitha bashkitë, parashikimi i investimeve nga buxheti vendor për përmirësimin e infrastrukturës së tregjeve të shitjes** me pakicë dhe tregjet e kafshëve në përputhje me standardet e shërbimit, fuqizimi i rolit monitorues të shërbimeve përkatëse të bashkisë përkundrejt funksionimit të tregjeve dhe rritja e ndërveprimit me strukturat e Agjencisë Kombëtare të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe të AKU lidhur me sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e konsumatorëve.

<sup>87</sup> Raport i Progresit të KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

<sup>88</sup> Raport i Progresit të KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

### 3.3 KAPITULLI 14: POLITIKA E TRANSPORTIT

BE ka rregulla të përbashkëta për standardet teknike dhe të sigurisë, standardet sociale, ndihmën shtetërore dhe liberalizimin e tregut në transportin rrugor, hekurudhat, rrugët ujore brenda territorit të shtetit, transportin e kombinuar, aviacionin dhe transportin detar.

Shqipëria ka një lloj niveli përgatitjeje në fushën e politikës së transportit, me një progres të arritur vitin e kaluar. Rekomandimet e vitit të kaluar janë adresuar pjesërisht me zbatimin e planit të rishikuar kombëtar të transportit (ANTP3), miratimin e strategjisë për sistemet inteligjente të transportit dhe fillimin e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Transportit për 2021-2026. Është miratuar legjislacioni për ngritjen e agjencisë kombëtare hekurudhore.<sup>89</sup>

Në kuadër të planit kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin janë hartuar 4 planet rajonale të zhvillimit rajonal (2021), që kanë për qëllim të përcaktojnë drejtimet kryesore të zhvillimit rajonal, fushat tematike dhe potenciale rajonale, mekanizmin financiar, sistemin e tij të monitorimit dhe vlerësimit. Në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Vendore është diskutuar dhe konsultuar gjatë vitit 2021 mbi Projekt Vendimin “Për Krijimin, Përbërjen, Organizimin, Veprimtarinë dhe Rregullat e Funkionimit të Komitetit Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin”.

Pjesë e kuadrit institucional (bazuar në Ligjin 102/2020 “ Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin”, janë edhe bordet e monitorimit të zhvillimit rajonal me përbërje nga NJVV. Ato promovojnë interesat e rajoneve të zhvillimit dhe veprojnë si një organ i përbashkët i NJVV të rajoneve të zhvillimit. Përmirësimi i transportit rrugor, aksesit si dhe ngritja e kapaciteteve të NJVV për menaxhimin e rrjetit rrugor janë synime të programit të rindërtimit (8.7 milion USD), për 2020-2022, për zonat e prekura nga tërmeti. Mbështetje për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve dytësore është parashikuar nën Programin e konektivitetit (me financim nga Qeveria dhe kredi nga Banka Botërore dhe BERZH me vlerë 100 milion USD). Në këtë program, do të rehabilitohen 9 rrugë ekzistuese dhe 1 segment të ri rrugor në 8 bashki, zhvillimi dhe mirëmbajtja e një sistemi informacioni gjeografik (GIS), baza e të dhënave për rrugët rajonale dhe lokale.<sup>90</sup>

Ngritja e kapaciteteve për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (Kostoja totale 1 milion USD, financuar nga IBRD), do të sigurojë mbështetje për NJVV në dy fusha të përgjegjësisë të tyre, që janë menaxhimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve të tyre rrugore dhe mbështetja në zbatimin e programeve të zhvillimit rural që mund të financohen nga vete NJVV-të nga Qeveria apo partnerë të tjerë të zhvillimit<sup>91</sup>.

Bashkitë janë përgjegjëse për të kryer shërbimet e ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve lokale, për të kryer klasifikimin e rrjetit rrugor, krijimin e hartave të rrugëve dhe kadastrës së rrjetit rrugor në administrimin e NJQV, dhënien e autorizimit, lejet për ndërtimin, mbrojtjen e rrugëve dhe hapësirave publike, kanalet e ujit, iv) linjat e energjisë, telekomunikacionit, deklasifikimin e rrugëve lokale, v) instalimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit, sinjalistikës rrugore dhe administrimin e transportit rrugor<sup>92</sup>.

Zbatimi i politikave të transportit në nivel të veçqeverisjes vendore dhe në kuadër të procesit të integrimit evropian, vlerësohet përkundërt tre objektive specifike dhe 14 treguesve të performancës: (i) rritja e sigurisë rrugore në nivel vendor (9 tregues); (ii) përmirësimi i transportit publik (2 tregues), (iii) Promovimi i ecjes në këmbë dhe biçikleta (3 tregues).

*Objektivi specifik: rritja e sigurisë rrugore në nivel vendor*

- **Progres i lehtë është bërë në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës rrugore urbane në vitin 2021** - norma mesatare e përmbushjes së standardeve të rrugëve të rrjetit urban që administrohet nga bashkia, ka qenë **60.1%** (N=58) krahasuar me vitin 2020 (59%) dhe 2019 (53%). Bashkia Belsh dhe Kolonjë

<sup>89</sup> Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (2021)


<sup>90</sup> Fondi Shqiptar i Zhvillimit; [https://www.albaniandf.org/wp-content/uploads/2021/04/Raporti-vietor-2020\\_compressed.pdf](https://www.albaniandf.org/wp-content/uploads/2021/04/Raporti-vietor-2020_compressed.pdf)

<sup>91</sup> Burim: Fondi Shqiptar i Zhvillimit

<sup>92</sup> Ligj Nr. 139/2015, neni 23, Urdhër i Kryeministrit (nr. 127/2015), VKM Nr. 915/2015 për transferimin e funksionit, Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë, Ligjin për transportin rrugor Nr. 83/1998.


kanë patur përmirësim të ndjeshëm të rrjetit rrugor në nivelin 100%; Normë e ulët e treguesit është raportuar nga Bashkia Skrapar (11%), Libohovë (7%), Finiq (3%), Klos (0,16%).

Grafiku 40: Norma e përputhshmërisë të rrjetit urban me standartet në NJVV, 2021




- Në vitin 2021, norma mesatare e përputhshmërisë të rrjetit rrugor rural me standartet e ndërtimit ka patur përmirësim më të lartë krahasuar me rrjetin rrugor urban, përkatësisht në **38.7%** (n=57), krahasuar me vitin 2020 (35%), ndërsa norma mesatare e përputhshmërisë së sinjalistikës të rrjetit rrugor të administruar nga NjVV ka qenë në **44.7%** ose 2.4 p.p më shumë krahasuar me vitin 2020. (42.31%), N=61.

Grafiku 41: Shkalla e përputhshmërisë të sinjalistikës me standartet, 2021




Për periudhën 2018 – 2021, vihet re tendecë në rritje të tre treguesve të lidhur me përmirësimin e infrastrukturës rrugore përkundrejt standardeve me përjashtim të treguesit për rrugët rurale në vitin 2019, i cili ka rezultuar me përkeqësim.

Grafiku 42: Tendeca e përputhshmërisë të rrjeteve rrugore dhe sinjalistikës me standartet e miratuara, 2018-2021



- **Lidhja e fshatrave midis tyre vlerësohet me normë mesatare 79%** (N=58) në vitin 2021; Treguesi ka patur përmirësim në krahasim me vitin 2020 (76.8%).


Grafiku 43: Norma e konektivitetit të fshatrave ndërmjet tyre, 2019-2021



Gjashtë NjVV raportojnë se kanë patur funksionale konektivitetin e fshatrave me qendrën e bashkisë nëpërmjet transportit ujor (liqenor), dhe pikërisht Vau i Dejës (12%), Tropojë (3%) dhe Fushë-Arrëz (1.4%), N=53.

Financimi nga buxheti vendor i NJVV për **mirëmbajtjen e rrugëve** ka qenë në një normë mesatare 5.3% në 2021 duke rezultuar më i ulët krahasuar me vitin 2020 (9.49%, N=53). Gjithashtu, edhe financimi për **ndërtimin e rrugëve** me një normë mesatare 12.91%, në vitin 2021, raportohet nga NjVV më i ulët krahasuar me vitin 2020 (14.7% të buxhetit vendor), N=53. Mungojnë të dhëna të vlefshme nga Bashkitë Peqin, Vau i Dejës, Shijak, Memaliaj, Dibër, Skrapar, Divjakë dhe Vorë, Poliçan.

Grafiku 44: Buxheti vendor për mirëmbajtjen, ndërtimin e rrugëve dhe rritjen e sigurisë (sinjalistikën), 2018 - 2021



**Objektivi specifik: përmirësimi i transportit publik**



Rritja e efikasitetit të transportit nga NjVV është parashikuar në Planin e Veprimit 2020-2022 të SKNDQV, specifikisht referuar rishikimit të rolit të organeve të bashkisë në përcaktimin e organizimit të transportit qytetas dhe ndërqytetas, amendimin e bazës ligjore për transportin rrugor dhe përcaktimin e kompetencave rregullatore dhe monitoruese të NJQV, dhe rishikimin e kuadrit rregullator lidhur me tarifat e transportit publik për kategori të veçanta<sup>93</sup>. Përmirësimi i transportit publik vlerësohet nëpërmjet tre treguesve të performances në këtë raportim:

**Progres i lehtë është bërë në lidhje me publikimin e hartës së linjave të transportit publik.** Gjithsej kanë qenë 21 bashki të cilat e kanë mundur këtë shërbim krahasuar me 19 bashki në vitin 2020 (N=57). Ndonëse ndryshimi është me dy NjVV për treguesin, pesë bashki kanë raportuar se kanë arritur që të plotësojnë kërkesën

<sup>93</sup> Raporti i Monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizim dhe Qeverisje Vendore (Ministria e Brendshme, 2021)

për publikimin e hartës gjatë vitit 2021 (Bashkitë Cërrik, Divjakë, Konispol, Memaliaj dhe Pogradec), ndërsa katër (4) bashki, të cilat kanë raportuar pozitivisht në vitin 2020, raportojnë negativisht në vitin 2021 (bashkia Elbasan, Fier, Bulqizë dhe Klos). 32 bashki kanë publikuar oraret e lëvizjes së mjeteve të transportit publik (N = 58).

Harta 13: Publikimi i orareve të lëvizjes së mjeteve të transportit publik




Objektivi specifik: nxitja e ecjes në këmbë dhe e përdorimit të biçikletës

Progresi lidhur me këtë objektivi specifik është vlerësuar me anë të tre treguesve të performancës. Në 2021, ka patur progres të lehtë nga NjVV për zgjerimin e rrjetit të korsive të dedikuara për lëvizjen më biçikleta. Në nivel kombëtar, norma mesatare ka qenë **5.12%** të gjatësisë së rrjetit **rrjetit urban** krahasuar

me vitin 2020 (**4.59%**), n=56. Bashkia Tiranës raporton rritjen më të madhe në 73% të rrjetit urban (krahasuar me 29.4% në 2020), Bashkia Fier (55%), Korçë (22%). Rreth 56% e bashkive kanë raportuar zero ose nuk kanë raportuar për treguesin.

**Norma e rrjetit rrugor të brendshëm të zonave urbane të bashkisë, e plotësuar me trotuarë, mesatarisht raportohet 56.9%.** Dyzet (40) bashki kanë një normë të barabartë me 50% të rrjetit urban ose më të lartë se 50%. Treguesi do të rezultonte në nivel më të lartë për vitin 2021, por disa bashki kanë raportuar vlera shumë të ulta ose zero, si Bashkia Pukë dhe Pustec (7%), Finiq (2%), Libohovë (0.4%), Blesh (0.2%), Klos (0.014%), ndërsa Bashkitë që nuk kanë raportuar janë Tiranë, Durrës, Peqin, Devoll dhe Vorë (N=58).

Grafiku 45: Norma e rrjetit rrugor urban të plotësuar me trotuarë, 2021



Bashkitë kanë organizuar më shumë fushata **ndërgjegjësimi për promovimin e lëvizjes së qytetarëve në këmbë dhe me biçikleta**, gjithsej janë organizuar 84 fushata (ose 21 fushata më shumë krahasuar me vitin 2020), N=55. Bashkitë me numrin më të lartë të fushatave të ndërgjegjësimit kanë qenë Bashkia Shkodër (7 fushata)), Bashkia Përmet, Librazhd, Tiranë, Kamëz, Elbasan, Pogradec dhe Devoll (5 fushata). Rreth 50% të bashkive raportojnë zero fushata ndërgjegjësimi për vitin 2021 ose nuk kanë raportuar aspak për treguesin.

### **Kutia 9: Sfida të bashkive për mirëmbajtjen e rrugëve dhe sinjalistikën gjatë vitit 2021**

**Bashkia Berat dhe Kamëz:** Parashikohet që me investimet e reja, të rritet cilësia e infrastrukturës në rrjetin rrugor urban sipas standardeve.

**Bashkia Dibër, Dropull:** Mungesë e statistikave të sakta nga drejtoritë përkatëse dhe mungesë e mirëmbajtjes dhe projekteve të reja (investime). Dëmtimi i sinjalistikës egzistuese si dhe fonde të kufizuara për vendosjen e tabelave të reja.

**Bashkia Klos:** Marrja e fondeve për rritjen e investimeve dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor urban.

**Bashkia Korçë:** Mungesë e fondeve për realizimin e investimeve.

**Bashkia Mirditë:** Përmirësim i mëtejshëm i rrjetit rrugor sipas standardeve të kërkuara me qëllim përmirësimin e lëvizjes në rrugë. Plotësimi me sinjalistikë orientuese të paktën për destinacionet kryesore turistike dhe kulturore.

**Bashkia Sarandë, Selenicë:** Rritja e shkallës së rrjetit rrugor urban ekzistues në përputhje me standardet dhe kodin rrugor.

**Bashkia Shkodër:** Fondet e pamjaftueshme për investime dhe mirëmbajtje në të gjithë territorin e bashkisë.

**Bashkia Vlorë:** Rivitalizimi i të gjitha rrugëve urbane sipas standardeve ligjore.

**Bashkia Devoll:** Vendosja e sinjalistikave horizontale në rrjetin rrugor ekzistues rural (vijëzimet). Realizimi i infrastrukturës së nevojshme rrugore për fshatrat Kurile, Arze, Vidohovë, Grapsh, Gjyrez dhe Vernik.

**Bashki Lezhë dhe Mallakastër:** Mbetet sfida që i gjithë rrjetit rrugor ekzistues në territorin e bashkisë të jetë sipas standardeve të kodit rrugor për sinjalistikën.

**Bashkia Kolonjë:** Rritja e financimit për investime në rrugë.

*Disa nga sfidat dhe rekomandimet të raportimit të mëparshëm mbeten të vlefshme:*

#### **Problemet dhe sfidat** .....

- Burime financimi të limituara për projekte të rehabilitimit/ndërtimit dhe mirëmbajtjes të rrjetit urban dhe rural.
- Rrjeti rrugor që lidh fshatrat me qendrën e bashkisë ka problematika si në cilësinë e infrastrukturës rrugore, ashtu dhe në sinjalistikë duke penguar lëvizjen e qytetarëve dhe mjeteve gjatë gjithë vitit.
- Transferta nga qeveria e pamjaftueshme për përmirësimin e infrastrukturës rrugore.
- Numri i kufizuar i linjave të transportit ndërrurban (nuk ka mbulim të gjithë territorit).
- Rreth 65% e bashkive nuk publikojnë hartën e linjave të transportit publik dhe 50% e bashkive nuk publikojnë orarin e lëvizjes së mjeteve të transportit publik (urban dhe ndërrurban).
- Mungesë e terminaleve të përshtatshme të mjeteve të transportit publik në të gjitha bashkitë.



**Rekomandime**

- Fuqizimi i kapaciteteve të menaxhimit për funksionin e administrimit të rrugëve nga NjVV.
- Zbatimi efektiv e Strategjisë për Sigurinë Rrugore dhe Strategjisë për Aplikimin e Sistemeve Inteligjente në Transportin Rrugor sipas planeve të veprimit dhe miratimi i Strategjisë për sektorin e transportit 2021-2026<sup>94</sup>.
- Sigurimi i mbështetjes në zbatimin e programeve të zhvillimit rural që mund të financohen nga vetë NjVV-të, nga Qeveria apo partnerë të tjerë të zhvillimit.
- Mbështetje financiare për ndërtimin e terminaleve të reja të mjeteve të transportit publike / stacione multimodale (ose përmirësimi i terminaleve ekzistuese), në përputhje me Planin e Zhvillimit të Territorit të bashkisë.
- Shtimi i linjave të reja të transportit publik ndërurban për të përmirësuar mbulimin e territorit dhe popullsisë me këtë shërbim.
- Zgjerimi i rrjetit të korsisë për lëvizjen me biçikleta në të gjitha NJVV dhe rritja e ndërgjegjësimit qytetar për lëvizjen e tyre në këmbë dhe biçikleta me anë të organizimit të më shumë fushatave të ndërgjegjësimit.

**PERFUNDIME MBI POLITIKËN E TRANSPORTIT**

**Ka patur progres në fushën e transportit** me zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe me zbatimin e planit të rishikuar kombëtar të transportit. Është hartuar draft Strategjia Kombëtare e Transportit 2021-2026. Është planifikuar mbështetje për *ngritja e kapaciteteve për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore* lidhur me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të tyre rrugore si dhe mbështetje në zbatimin e programeve të zhvillimit rural që mund të financohen nga vetë NjVV, nga Qeveria apo partnerë të tjerë të zhvillimit është planifikuar të ofrohet gjatë viteve 2022-2023 (me financim të IBRD (1 milion USD)).

*Përmirësim është bërë në drejtim të rritjes së normës së përputhshmërisë me standartet e kodit rrugor të rrjeteve rrugore urbane dhe rurale dhe sinjalistikë krahasuar me vitin 2020. Gjithashtu është përmirësuar shkalla e konektivitetit të fshatrave ndërmjet tyre nëpërmjet mirëmbajtjes dhe ndërtimit të rrugëve për periudhën 2019-2021. Ndonëse ka patur përmirësim të disa treguesve të performancës për vitin e raportimit, financimi nga fondet e veta të NJVV për mirëmbajtje dhe ndërtim të rrugëve ka pësuar ulje krahasuar me vitin e mëparshëm.*

*Gjithashtu, përmirësim është bërë për publikimin e hartës të linjave të transportit publik dhe të lëvizjes së mjeteve të transportit publik në stacionet e autobuzëve, rritjen e gjatësisë së rrjetit për lëvizje me biçikleta si dhe organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit qytetar për të lëvizuar në këmbë (më shumë fushata të kryera krahasuar me vitin e mëparshëm).*

Mbeten sfida përmirësimi i kapaciteteve të menaxhimit dhe mirëmbajtjes së rrjeteve rrugore dytësore dhe terciare, rritjen e financimit për investime e mirëmbajtje të rrugëve, rritjen e rrjetit për lëvizjen me biçikleta dhe përmirësimin e sinjalistikës.

<sup>94</sup> Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

### 3.4 KAPITULLI 15: ENERGJIA

Politika energjetike e BE-së përfshin furnizimin me energji, infrastrukturën, tregun e brendshëm të energjisë, konsumatorët, energjinë e rinovueshme, efikasitetin e energjisë, energjinë dhe sigurinë bërthamore dhe mbrojtjen nga rrezatimi.

“Shqipëria është përgatitur mesatarisht në këtë fushë. Janë bërë disa përpjekje mbi kuadrin ligjor për Eficiencën e Energjisë (EE) ndërsa zbatimi i planit të EE mbeti i ngaldalshëm. Mekanizmat alternativë të financimit të EE-së ndaj fondit të braktisur të EE nuk kanë avancuar. Një nga rekomandimet që vlen edhe për bashkitë është: të zbatojë legjislacionin dytësor në lidhje me Direktivën e Performancës Energjetike të Ndërtesave, të përshejtojë trajnimin dhe certifikimin e auditorëve dhe menaxherëve të energjisë”<sup>95</sup>

**Ligji Nr. 28/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 124/2015 “Për eficiencën e energjisë”, të ndryshuar, përcakton masat për eficiencën e energjisë që lidhen me blerjen nga autoritetet publike (neni 9) dhe përgjegjësitë e NJVV për hartimin e planeve vendore të veprimit për EE, zbatimin e tyre dhe raportimin (neni 9/1).**

Politikat në fushën e energjisë përcaktojnë tre objektiva<sup>96</sup>:

- i) Mbështetje për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik.
- ii) Rritjen e sigurisë të furnizimit me energji,
- iii) Mbrojtjen e mjedisit (dimensioni i dekarbonizimit).

Rregulla të reja balancimi kanë hyrë në fuqi (që nga 1 prilli 2021), në zbatim të akteve nënligjore të Këshillit të Ministrave për ngritjen e operatorit të tregut dhe ngritjen e Bursës Shqiptare të Energjisë (ALPEX). Ato prezantojnë prokurimin e bazuar në treg të shërbimeve balancuese dhe formimin e çmimeve të çekuilibrit. Kuadri ligjor i ERE-s është përgjithësisht në përputhje me acquis, më përjashtim të disa kompetencave që mungojnë: e drejta për të vendosur masa për të nxitur konkurrencën, dhe për t’u kërkuar operatoëve të sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes të ndryshojnë termat dhe kushtet e tyre dhe për të rritur nivelin e gjobave që mund të vendosë ERE. Progres është bërë në vendosjen e kuadrit rregullator për **energjinë e rinovueshme**. Dy kontrata të mëdha për dy ferma diellore PV janë nënshkruar dhe në vitin 2021 është nisur një ankad për fermat me erë. Kontratat e shumta koncesionare për hidrocentralet nuk janë një opsion i qëndrueshëm. HEC-et e vegjël gjenerojnë ndikime të rëndësishme në biodiversitetin dhe komunitetet lokale; mungon një vlerësim mjedisor strategjik në mjedis (VSM). Zbatimi i planit për **eficiencën e energjisë** PKVM 2017-2020 nuk ka përmbushur pritshmëritë në drejtim të kursimit kumulativ të energjisë së përdorur deri në vitin 2020 (rreth 2% në vend të 6.8%). Njëfarë progresi është bërë duke amenduar Ligjin për EE në mars 2021 për t’u përfaqësuar me Direktivën për EE dhe hartimin e legjislacionit dytësor, në fushën e performancës energjetike në ndërtesa.<sup>97</sup>

*Objektivat specifike të zhvillimit në kuadër të axhendës së integrimit evropian, në nivel vendor, në fushën e energjisë janë (i) Rritja e eficiencës së përdorimit të energjisë, (ii) përmirësimi i zbatimit të kërkesave minimale për ndërtesat, shërbimet publike dhe private dhe (iii) rritja e përdorimit të burimeve të rinovueshme dhe politikat promovuese për përdorimin e burimeve të rinovueshme.*

*Objekti i specifik: Rritja e eficiencës së përdorimit të energjisë.*



**Nuk ka patur progres lidhur me caktimin e menaxherit për eficiencën e energjisë, në bashkitë e vendit, si pjesë e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Eficiencën e Energjisë, 2019-2030.** Ndërsa treguesi ka mbetur në nivelin e vitit të mëparshëm të raportimit, pesë (5) bashki të reja kanë raportuar mbi caktimin e menaxherit për EE në vitin 2021, përkatësisht bashkitë Pogradec, Kukës, Fushë-Arrëz, Memaliaj dhe Lezhë, por 5 bashki të tjera raportojnë se nuk kanë menaxher për EE (të raportuar të vlefshëm për vitin 2020, përkatësisht Bashkia Gjirokastrë, Përmet, Skrapar, Korçë dhe Bashkia Kamëz (N=59).

<sup>95</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Nëntor 2021)

<sup>96</sup> Drafti i Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën, 2020-2030 (MIE, miratuar në Dhjetor 2021)

<sup>97</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Nëntor 2021)

Harta 14: Menaxheri për efijencën e energjisë (EE)      Grafik 46: Caktimi i menaxherit për EE në NJVV




Trajnimi dhe çertifikimi i menaxherit për EE është një kërkesë detyruese – raportohet se është kryer nga 15 NJVV (ose 93% të bashkive që kanë caktuar menaxherin për EE), N=57. Njëfarë progresi është bërë përkundrejt detyrimit mbi hartimin dhe miratimin e **Planit të Veprimit Vendor për efijencën e energjisë**; 21 bashki raportojnë se kanë miratuar planin e veprimit vendor për EE (N=58). Para miratimit nga këshilli bashkiak, projektplanet vendore të veprimit për EE duhet të konsultohen

me Agjencinë për Efijencën e Energjisë, me përfaqësues të grupeve të interesit dhe të shoqërisë civile për vlerësimin e përputhshmërisë së tij me politikat kombëtare të EE. Bashkitë përmes menaxherëve të energjisë:


- monitorojnë rregullisht zbatimin e planit dhe arritjen e objektivave të kursimit të energjisë,
- krijojnë dhe mirëmbajnë bazën e të dhënave për konsumin e energjisë në objektet nën kontrollin e tyre,
- monitorojnë kursimet e realizuara nga zbatimi i masave në ndërtesat publike, sistemet e ujësjellësve, të ndriçimit dhe të gjitha aktivitetet me konsum të lartë të energjisë<sup>98</sup>.

<sup>98</sup> Ligj Nr. 28/2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 124/2015 “Për efijencën e energjisë”, të ndryshuar (neni 9/1)

Harta 15: Bashki që kanë hartuar plan veprimi për EE (2021)



Grafiku 47: Bashki që kanë hartuar plan veprimi vendor për EE, 2019-2021




Numri i projekteve të zbatuara sipas kërkesave të efikasitetit të energjisë ka qenë 704 (krahasuar me 70 projekte në vitin 2020) që janë realizuar nga 49 bashki (N=49). Numri më i madh i projekteve është raportuar nga Bashkia e Krujës (450 projekte), Bashkia Kamëz (82), Bashkia Kurbin (63), ndërsa bashkitë e tjera raportojnë më pak se 19 projekte. Në zbatim të masës së dekarbonizimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Energjinë dhe Klimën, Bashkia e Tiranës po zbaton një projekt për përmirësimin e transportit publik (përdorimi

i mjeteve ekologjike). Rreth 74% e bashkive raportojnë zero projekte të zbatuara sipas kërkesave të efikasitetit të energjisë (N=49).

**Objekivi specifik:** Rritja e efikasitetit të përdorimit të energjisë: përmirësimi i zbatimit të kërkesave minimale për ndërtesat dhe shërbimet publike.

Bashkitë po mbështeten nga një projekt<sup>99</sup> “Bashkitë e zgjuara të energjisë/Smart energy municipalities” me qëllim menaxhimin e energjisë në mënyrë të qëndrueshme dhe të afta për të zbatuar politikën kombëtare për energjinë. Bashkitë krahas promovimit që duhet të bëjnë në nivel vendor të politikave kombëtare për EE dhe informimit qytetar për përfitimet nga masat për rritje të efikasitetit dhe mënyrën e realizimit të tyre (Ligj Nr. 28/2021, neni 9/1) gjithashtu kanë detyrimin që të kryejnë kontrolle mbi zbatimin e masave dhe kërkesave të përcaktuara në ligjin e ndryshuar për EE<sup>92</sup>. Në vitin 2021 raportohen që janë kryer 286 kontrolle (ose 52% të numrit të kontrolleve të realizuara në vitin 2020), N=49. Në këto kontrolle janë konstatuar 40 shkelje për moszbatimin e rregullave të EE, të cilat janë raportuar nga Bashkia e Tropojës (36 raste) dhe Bashkia Cërrik (4 raste), N=52.

Grafiku 48: Numri i kontrolleve mbi zbatimin e masave për efikasitetin e energjisë të kryera nga bashkitë



<sup>99</sup> Projekt i financuar nga SDC

*Objekti i specifik: Rritja e përdorimit të burimeve të rinovueshme dhe politikat promovuese për përdorimin e burimeve të rinovueshme*

Në vitin 2021, dymbëdhjetë bashki kanë zbatuar **42 projekte, të bazuara në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë** (më shumë projekte krahasuar me vitin 2020, gjithsej 12). Bashkia e Dimalit ka zbatuar 17 projekte të bazuara në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, e ndjekur nga Bashkia e Elbasanit (12 projekte), dhe bashki të tjera me një numër më të vogël, si Bashkia Krujë (4), Roskovec (2 projekte), dhe bashkitë me 1 projekt si, Bashki Korçë, Himarë, Pustec, Gjirokastër, Berat, Vau i Dejës, Malësi e Madhe dhe Finiq.

**Vetëm 16 bashki kanë siguruar të ardhura nga shfrytëzimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, që ndodhen në territorin e bashkisë së tyre**, si Bashkia e Tiranës (100%), Bashkia Përmet (100%), të ndjekura nga Bashkia Kolonjë (90%), Pogradec (87%) dhe Fushë-Arrëz (81%). Bashki të cilat kanë gjeneruar më pak të ardhura nga shfrytëzimi i burimeve të rinovueshme të energjisë janë Bashkia Prrenjas, Kurbin, Mirditë, Librazhd, Kukës, Elbasan, Finiq, Gramsh, Tropojë, Maliq, Devoll dhe Roskovec (N=52).

**Si edhe në raportimin e mëparshëm, bashkitë nuk kanë aplikuar politika fiskale specifike dhe lehtësuese ndaj biznesit, të cilat të promovojnë përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë gjatë 2021.**

#### **Kutia 10: Sfidat e bashkive për zbatimin e politikave për efikasitetin e energjisë në vitin 2021**

**Bashkia Roskovec:** Bashkitë e vogla nuk kanë kapacitete për të mbuluar financiarisht pozicionin e menaxherit të energjisë.

**Bashkia Tropojë, Selenicë, Prrenjas:** Caktimi i menaxherit të energjisë.

**Bashkia Shkodër:** Rritja e numrit të specialistëve të trajnuar.

**Bashkia Dibër dhe Kolonjë:** Mungesë të kapaciteteve për hartimin e një plani vendor mbi EE.

**Bashkia Kurbin dhe Librazhd:** Prioritet hartimi i planit vendor për EE në vitin 2022.

**Bashkia Sarandë:** Të zbatohen projekte në përputhje me planin vendor të veprimit për EE.

**Bashkia Tiranë:** Zbatimi efektiv i planit të veprimit për EE

**Bashkia Fier:** Janë përfshirë pjesërisht masa për EE në projektet e rikonstruksionit të ndërtesave arsimore.

*Disa nga sfidat dhe rekomandimet e raportimit të mëparshëm janë të vlefshme edhe për këtë periudhë raportimi.*

#### **Problemet dhe sfidat** .....

- Kapacitete të vogla në mjaft bashki për hartimin e planit vendor për EE në përputhje me planin kombëtar të veprimit dhe sipas kërkesave të Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë.
- Burime financiare të limituara për të mbuluar pozicionin e menaxherit për efikasitetin e energjisë dhe miratimin e strukturës përkatëse).
- Parashikimi i fondeve në PBA për zbatimin e masave të planit të veprimit për efikasitetin e energjisë.
- Burime inspektuese të vogla në mjaft bashki për zbatimin e masave të kontrollit në ndërtesat për shërbimet publike dhe private dhe ndërtime për banesa sipas kërkesave të ligjit (Ligji Nr. 124/2015 “Për efikasitetin e Energjisë”, ndryshuar).
- Hartimi dhe zbatimi i projekteve të bazuara në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë.

**Rekomandime**

- Caktimi i menaxherit për eficiency e energjisë në të gjitha bashkitë, trajnimi dhe çertifikimi i tij.
- Hartimi dhe miratimi i planit të veprimit vendor për EE, në përputhje me Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (2021-2030) dhe parashikimi i tij në PBA për të mbështetur zbatimin e tij.
- Rritja e kapaciteteve për prokurimin e gjelbërt.
- Organizimi nga bashkitë i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere për qytetarët në lidhje me përdorimin eficient të energjisë, dhe sigurimin e bashkëfinancimit nga bashkitë për projekte që sjellin përdorimin eficient të energjisë në banesat me pronësi të përbashkët.
- Rritja e kapacitetit kontrollues dhe inspektimit të shërbimeve bashkiake në zbatimin e masave të kontrollit dhe kërkesave në ndërtesat për shërbimet publike dhe private dhe ndërtimet për banesa.

**PËRFUNDIME MBI ENERGJINË**

*Bashkitë nuk kanë bërë progres në lidhje me zbatimin e politikës kombëtare për eficiency e energjisë, specifikisht lidhur me caktimin e menaxherit për eficiency e energjisë, trajnimin e tij si edhe hartimin e planit vendor të veprimit për eficiency e energjisë, në përputhje me Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën. Më shumë projekte janë zbatuar nga NJVV të cilat janë bazuar në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë. Gjithashtu ka patur një rritje të konsiderueshme të projekteve të zbatuara sipas kërkesave të eficiency së energjisë. Realizimi i të ardhurave nga shfrytëzimi i burimeve të rinovueshme të energjisë konstatohet në një numër të vogël të bashkive. Më pak kontrole janë kryer nga shërbimet përkatëse të bashkive lidhur me respektimin e kërkesave të eficiency së energjisë në ndërtesat private të banimit dhe në ndërtesat për shërbime publike dhe private sipas standardeve të përcaktuara në ligj.*

Sfida të bashkive mbeten caktimi i menaxherit për eficiency e energjisë, trajnimi e çertifikimi i tij, hartimi i planit vendor të veprimit për eficiency e energjisë, rritja e kapaciteteve në drejtim të prokurimeve të gjelbërta dhe menaxhimi i kontratave të shërbimeve bazuar në performancën e energjisë, si dhe rritja e kapaciteteve vendore për hartimin dhe zbatimin e projekteve të bazuara në përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë.

**3.5 KAPITULLI 16: TAKSAT**

*Rregullat e BE-së mbi taksimin mbulojnë taksën mbi vlerën e shtuar dhe detyrimet e akcizës, si dhe aspektet e taksimit të korporatave, si dhe me bashkëpunim midis administratave tatimore, përfshirë shkëmbimin e informacionit për të parandaluar evazionin fiskal.*

*“Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar në fushën e taksave. Është bërë njëfarë, duke arritur harmonizimin e pjesshëm me Direktivën e Bashkimeve, duke reduktuar stokun e detyrimeve të prapambetuar në rimbursimet e TVSH-së dhe shkëmbimin e parë joreciprok të informacionit të llogarive financiare. Në vitin e ardhshëm, vendi duhet: (i) të thjeshtojë sistemin e taksave për të inkurajuar pajtueshmëri më të madhe tatimore; (ii) të miratojë një kalendar të ri për akcizën e duhanit me synimin për të përafëruar në mënyrë progresive normat e akcizës me minimumin e BE-së; (iii) të përputhet me planet e kontraktuara të ripagimit për rimbursimet e TVSH-së.”<sup>100</sup>*

Për *tatimet indirekte*, norma standard e TVSH-së është 20% dhe normat e reduktuara janë 6% dhe 10%, por ka rritje të numrit të përjashtimeve si për jahtet dhe mjetet ujore jo më të vjetra se 20 vjet. Përsa i përket tatimeve direkte, institucionet financiare janë të detyruara ligjërisht të llogarisin, mbajnë në burim dhe deklarojnë tatimin mbi të ardhurat dhe të ardhurat nga kursimet. Që nga janari 2021, tatimpaguesit më të ardhura totale vjetore deri në 14 milion leke i nënshtrohen një norme 0% të tatimit mbi fitimin, ndërsa ata që e kalojnë këtë prag i nënshtrohen një norme 15%. Zbatimi i bazës ligjore për kadastrën fiskale (miratuar në


<sup>100</sup> Raport Progresi KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

2018), është vonuar, për shkak të të dhënave jo të plota. NJVV kanë vijuar me përpilimin e informacionit të nevojshëm, ndërsa është planifikuar të ndryshohet baza ligjore.<sup>95</sup>

**Burimet financiare të bashkive kanë shënuar rritje gjatë vitit 2021 si kontribut i përmirësimit në performancën nga burimet e veta vendore, dhe kryesisht nga rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.** Të ardhurat e pushtetit vendor kanë qenë në nivelin 29,498,427 (mijë lekë) ose 21.8 p.p më shumë krahasuar me vitin 2020 (24,204,982 mijë lekë<sup>101</sup>), N=61.

Rritjen më të lartë të të ardhurave të veta (2021 krahasuar me 2020), e ka patur Bashkia Kuçovë (91%), Bashkia Mallakastër (89%) dhe Bashkia Himarë (76%), ndërsa normën më të ulët negative e ka patur Bashkia Kukës (-31%), Bashkia Pukë (-28%), dhe Bashkia Memaliaj (-18.5%). Rreth 23% e bashkive kanë patur ulje të të ardhurave të veta në vitin 2021 krahasuar me 2020.

Grafiku 49: Norma e ndryshimit të të ardhurave të veta të bashkive (2021/2020)




Burim: MFE/Drejtoria e Financave Vendore

Në total, të ardhurat nga taksat vendore kanë patur një trend rritës krahasuar me vitin paraardhës për periudhën 2010-2021.

<sup>101</sup> Burim MFE: Drejtoria e Financave Vendore

Grafiku 50: Të ardhurat nga taksat vendore<sup>102</sup> (9M2021)




**Performanca pozitive në taksat vendore udhëhiqet nga rritja e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, ndjekur nga taksa mbi pasuritë e paluajtshme, të cilat përbëjnë rreth 80% të të ardhurave totale nga taksat vendore<sup>103</sup>. Në 2021, pushteti vendor ka rritur kontributin në ekonomi e në Produktin e Brendshëm Bruto – të ardhurat e veta kanë përbërë 1.67% të PBB krahasuar me 1.51% në vitin 2020.**

*Objektivi Specifik: Përmirësimi i administrimit të sistemit të taksave dhe tarifave vendore në drejtim të rritjes së bazës së tatueshme.*

Në vitin 2021, 42 bashki (ose 7 bashki më pak se 2020) kanë miratuar programe të politikave tatimore që kanë për qëllim nxitjen e formalizimit të ekonomisë në territorin e bashkisë. Inspektorët e shërbimit të taksave kanë kryer gjithsej 15,447 inspektime (mesatarisht 257 inspektime) në terren me qëllim parandalimin e ekonomisë joformale (ose rreth 29% më pak të numrit të kontrolleve në subjekte të kryera gjatë vitit 2020).

**Më pak dëgjesa publike me grupet e interesit (grupet e biznesit) janë organizuar nga shërbimet e bashkive me qëllimin informimin dhe konsultimin mbi politikat fiskale dhe ndryshimet në paketën fiskale, gjithsej 309 dëgjesa në vitin 2021 (krahasuar me 342 dëgjesa në vitin 2020), N=60.**

Grafiku 51: Numri i dëgjesave publike të organizuara nga bashkia me bizneset, 2021




<sup>102</sup> Financat publike vendore – 9M2021 (Co-PLAN)

<sup>103</sup> Financat publike vendore – 9M2021 (Co-PLAN)




Bazuar në të dhënat e raportuara, rezulton se treguesi lidhur me bazën e të dhënave (funktionale), që bashkitë kanë në përdorim mbi subjektet, me detyrime të prapambetura, ka patur luhatje në vitet 2018-2021 (N=59).

Harta 16: Bashki me bazë funksionale për debitorët (2021)



Grafiku 52: Baza e debitorëve funksionale



Disa nga sfidat dhe rekomandimet të periudhës së mëparshme janë të vlefshme edhe për këtë raportim:

### Problemet dhe sfidat

- Rritja e të ardhurave të veta dhe ulja e detyrimeve të prapambetura.
- Mungesa e një sistemi unik dhe modern për administrimin e taksave vendore nga të gjitha bashkitë.
- Vonesë në bërjen funksionale të kadastrës fiskale dhe aplikimin e plotë të taksës së ndërtesës në përputhje me ndryshimet ligjore.
- Ulja e informalitetit dhe ndërgjegjësimi i bizneseve. Mbulim i territorit me anë të inspektimit dhe kontrollit financiar duke konsideruar territorin e zgjeruar të bashkive mbas reformës administrative dhe territoriale.

### Rekomandime

- Thjeshtëzimi i sistemit të tatimeve duke inkurajuar rritjen e pajtueshmërisë së tatimeve.
- Zbatimi i plotë i fiskalizimit dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për formalizimin e bizneseve.
- Rritja e të ardhurave në mënyrë miqësore dhe forcimi i administrimit fiskal.

- Përmirësimi i transparencës mbi performancën në ekzekutimin e buxhetit dhe të ardhurave të pushtetit vendor, kundrejt rritjes së pajtueshmërisë me sistemin e tatimeve dhe rritjes potenciale të tarifave vendore, si dhe rritjes së investimeve dhe përmirësimit në ofrimin e shërbimeve publike.

## PËRFUNDIME PËR TAKSAT

Në sajë të përmirësimit të performancës në administrimin e taksave vendore, janë rritur burimet financiare të bashkive gjatë vitit 2021. Të ardhurat e pushtetit vendor janë realizuar 21.5% më shumë se të ardhurat faktike në vitin 2020, duke arritur në nivelin 29,498,427 (mijë lekë).

Për disa tregues të performancës të sektorit, ka patur një trend zbritës, krahasuar me vitin 2020, dhe specifikisht më pak NJVV kanë miratuar programe të politikave tatimore që kanë për qëllim nxitjen e formalizimit të ekonomisë në territorin e bashkisë, më pak inspektime të kryera në terren dhe më pak dëgjesa publike të organizuara me grupet e interesit lidhur me konsultimin publik mbi politikat fiskale gjatë vitit të raportimit. Përmirësimi i lehtë është arritur lidhur me rritjen e numrit të bashkive që kanë funksionale databazën për debitorët, në 2021 krahasuar me 2020, por mbetet në nivel më të ulët krahasuar me vitet 2018 dhe 2019.

Sfida për shërbimet e taksave të bashkive, është përmirësimi i sistemit të administrimit të taksave vendore (digjitalizimi dhe unifikimi i sistemit për të gjitha bashkitë), informimi dhe ndërgjegjësimi për formalizimin e bizneseve dhe grumbullimi i të ardhurave nga tarifa dhe taksat vendore përkundrejt planifikimit, si dhe rritja e transparencës mbi performancën në administrimin e të ardhurave të pushtetit vendor.

## 3.6 KAPITULLI 19: POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMI

“Për politikën e punësimit, Shqipëria po zbaton Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (NESS) 2020-2022 Gjatë vitit 2021, u bënë përpjekje shtesë për promovimin e shërbimeve të punësimit në nivel vendor, së bashku me territorin dhe kohezionin social. Megjithatë, nëpunësimi dhe informaliteti mbeten të rëndësishme dhe nevojiten përpjekje të forta në lidhje me përafrimin e arsimit dhe trajnimit (përfshirë arsimin e të rriturve dhe mësimin gjatë gjithë jetës) me nevojat e tregut të punës. Për më tepër, nevojiten ndërhyrje solide për të siguruar mbështetje për njerëzit me aftësi të kufizuara dhe njerëzit më të rrezikuar nga përjashtimi, veçanërisht pas krizës së zgjatur epidemiologjike. Reforma e shërbimeve sociale po përparon. Shqipëria duhet të sigurojë një rikuperim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës nga pandemia, me një mbulim të shtuar dhe shpërndarje financiare të Fondit Social për financimin e shërbimeve të kujdesit social të të gjitha bashkive dhe të sigurojë zbatimin në praktikë të legjislacionit dytësor për prokurimin publik për shërbimet sociale.<sup>104</sup>”

Gjatë vitit 2021 kanë ndodhur disa zhvillime pozitive në sektorin e punësimit dhe atë social sic është edhe miratimi në Korrik 2021 i Deklaratës së Ballkanit Perëndimor për sigurimin e integrimit të qëndrueshëm të të rinjve në tregun e punës. Shqipëria është angazhuar të ndër marrë hapa konkretë për të krijuar dhe zbatuar gradualisht skemën e Garancisë për Rininë. **Sipas raportit të indeksit të hendekut gjinor të Forumit Ekonomik Botëror 2021, Shqipëria renditet e 25-ta nga 153 vende (krahasuar me vendin e 20-të për vitin 2020), duke reflektuar pasojat e krijuara nga tërmeti dhe pandemia COVID-19. Diferenca më e madhe në treguesit e tregut të punës midis grave dhe burrave është në shkallën e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, me një hendek prej 17.2 për qind. Shkalla e papunësisë në Shqipëri është rreth dyfishi i asaj të BE-28<sup>105</sup>**

<sup>104</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

<sup>105</sup> Indeksi i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë 2020

Gjatë vitit 2021 janë diskutuar disa projektat/te në Këshillin Konsultativ (KK) për vetëqeverisjen vendore sic janë:

- Projektvendimi “Për organizimin, funksionimin dhe mënyrën e përfaqësimit të organeve të qeverisjes vendore në Këshillin Konsultativ trepalësh rajonal”. Në zbatim të nenit 200/1 të Kodit të Punës është hartuar projektvendimi për ngritjen e Këshillit Konsultativ trepalësh në 12 qarqe me asistencën e Zyrës Ndërkombëtare të Punës. Ky projektvendim synon dialogun social dhe përcakton rregullat e Këshillit Konsultativ trepalësh në nivel rajonal.
- Projektvendimi “Treguesit statistikorë të vlerësimit të ndihmës ekonomike të pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore si dhe periudicitetin e mbledhjes së tyre.

Progresi në zbatimin e politikave në fushën sociale dhe punësimin në nivel vendor lidhet me tre objektiva specifike dhe vlerësimin e 23 treguesve të performancës.


Objektivi specifik: Mbrojtja sociale në nivel vendor

Progresi i objektivit specifik mbrojtja sociale në nivel vendor vlerësohet me treguesit e mëposhtëm:

- Numri i nëpunësve të administratës vendore përgjegjës për përfshirjen sociale në bashki për vitin 2021 në kategorinë “Njësia për mbrojtjen e fëmijëve” është në total 109 nëpunës me kohë të plotë, ose mesatarisht 1.79 për Bashki (N=61). Treguesi ka ulje në krahasim me vitin 2020 ku janë raportuar në total 128 nëpunës për këtë kategori.
- Numri i nëpunësve të administratës vendore përgjegjës për përfshirjen sociale në bashki, për vitin 2021 në kategorinë “Nëpunësi për barazinë gjinore” është në total 69 nëpunës ose mesatarisht 1.13 për bashki (N=61) nga 80 nëpunës ose mesatarisht 1.38 te raportuar në 2020.
- Numri i nëpunësve të administratës vendore përgjegjës për përfshirjen sociale në bashki, në kategorinë “Nëpunësi për dhunën në familje” është në total 65 ose mesatarisht 1 nëpunës me kohë të plotë për Bashki (N=60) nga 72 nëpunës ose mesatarisht 1.24 nëpunës për bashki të raportua në 2020. Bashkia Çërrik nuk ka ofruar të dhëna për këtë tregues.
- Kapacitetet njerëzore në bashki me nëpunës shtesë për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e ndihmës ekonomike (NE) kanë pësuar rritje ku janë raportuar në total 330 nëpunës ose mesatarisht 5.4 nëpunës për bashki (N=61). Në vitin 2020 janë raportuar 248 nëpunës ose mesatarisht 4.28 nëpunës në bashki. Numrin më të madh të nëpunësve shtesë e ka Bashkia Elbasan (26), Bashkitë Dibër, Kukës dhe Lushnjë me (17) dhe Bashkia Shkodër (14).


Vihet re se rreth 50% e Bashkive kanë nga një nëpunës për cdo kategori dhe në disa prej tyre është vetëm një nëpunës që mbulon të tre kategoritë (Bashkia Kurbin, Bashkia Dropull dhe Bashkia Skrapar kanë vetëm një nëpunës për të tre funksionet atë të mbrojtjes së fëmijëve, barazisë gjinore dhe dhunës në familje).

Grafiku 53: Numri i nëpunësve shtesë të administratës vendore përgjegjës për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndihmës Ekonomike 2021



Kapacitetet e bashkive me nëpunës shtesë për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e ndihmës ekonomike (NE) në Bashki ka pësuar rritje në vitin 2021 ku janë raportuar 24% më shumë se në 2017.

Grafiku 54: Numri i nëpunësve shtesë për ndihmën ekonomike në vite 2017-2021





- Në vitin 2021 buxheti i bashkive i planifikuar për shpenzime të kujdesit social përbën mesatarisht 7% të buxhetit total të bashkive. Buxheti ka pësuar ulje në krahasim me 10,26% raportuar për planifikimin për kujdesin social në vitin 2020. *Bashkitë Vorë, Memaliaj, Konispol, Këlcyrë, Cërrik, nuk kanë raportuar për këtë tregues.*
- Mesatarisht 7.75 % e strehimit social janë ofruar për viktimat e trafikimit ndaj numrit gjithsej të përfituesve të strehimit social në bashki gjatë vitit 2021. Treguesi ka pësuar rritje nga viti 2020 ku është raportuar mesatarisht 1.54% e rasteve të strehimit social për viktimat e trafikimit. Ndërkohë që 27 % e totalit të nevojave të paraqitura për strehim në bashki janë dhënë për strehim social duke pësuar rritje prej 4 p.p. nga viti 2020.
- Numri i personave nga grupet vulnerabël që përfitojnë shërbime sociale në qendrat e themeluara të kujdesit social në 2021 është në total 12,351 ose mesatarisht 213 persona për Bashki (N=58). Treguesi ka rritje të lehtë nga 2020 ku janë raportuar në total 11,092 ose mesatarisht 191 persona për bashki. *Numrin më të madh e raporton sërish Bashkia Shkodër me të njëjtin numër si në 2020 prej 6600 persona, pasuar nga Bashkia Tiranë (1254), Bashkia Elbasan (870) dhe Bashkia Durrës (657).*
- Në 2021, hartimi i Raportit të Vlerësimit për mbrojtjen sociale në territorin e Bashkisë në vitin e raportimit është bërë nga vetëm 28 Bashki ndërsa Sektori i Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit është ngritur në vetëm 22 bashki. Të dy treguesit kanë regres në krahasim me vitin 2020 ku janë raportuar 35 Bashki që kanë hartuar Raport Vlerësimi dhe 30 Bashki që kanë ngritur sektorin e vlerësimit të nevojave.

Harta 17: Plan Veprimi për Përfshirjen Sociale 2021

Objektivi specifik: Përfshirja sociale në nivel vendor


- Ka vazhduar hartimi dhe miratimi nga Bashkitë i **planit vendor për përfshirjen sociale**. Në 2021 janë 93% e Bashkive që kanë hartuar dhe e kanë miratuar atë me vendim të Këshillit Bashkiak; treguesi evidenton rritje +3 p.p., krahasuar me vitin 2020. **Bashkitë që nuk e kanë miratuar ende janë: Shijak, Sarandë dhe Këlcyre.** Bashkia Devoll nuk ka raportuar asnjë të dhënë.

Grafiku 55: Plan Veprimi për Përfshirjen Sociale 2017-2021



Gjatë 2021 janë zhvilluar 203 trajnime për nëpunës vendor mbi metodologjitë e matjes së treguesve të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale ose mesatarisht 3.44 trajnime për bashki (N=59). Trajnimet kanë arritur në rritje nga viti 2021 me një total prej 183 ose me 150% krahasuar me vitin 2017 (79 trajnime).

Harta 18: Bazë të dhënash për përfshirjen sociale 2021



**Baza statistikore për përfshirjen sociale është ngritur dhe bërë funksionale në 57 % të Bashkive.** Treguesi evidenton përmirësim të lehtë me vetëm një Bashki më shumë në krahasim me vitin 2020. *Bashkitë Vlorë, Shijak dhe Polican nuk kanë ofruar të dhëna për këtë tregues.*


Në 2021 është raportuar për 3,982 nxënës që kanë ndjekur arsimin profesional të cilët kanë përfituar bursa për vitin shkollor ose mesatarisht 71.11 nxënës për bashki (N=56). Ka patur rritje nga viti 2020 ku në total kanë qënë 3,733 nxënës që kanë përfituar bursa.

Numri i të papunëve që marrin ndihmë ekonomike të cilët janë mbështetur financiarisht nga Bashkia për arsim dhe trajnim profesional në përputhje me nevojat e tregut në nivel vendi janë raportuar gjithsej 5,109 ose mesatarisht 94.61 persona (N=54). Treguesi ka një rënie të ndjeshme prej 50% krahasuar me vitin 2020 ku është raportuar 10,859 persona, ose mesatarisht 217 persona për bashki.

**Numrin më të madh e ka Bashkia Mallakastër me 1389 persona dhe Bashkia Kurbin me 971.**

Siç shihet dhe nga grafiku i mëposhtëm numri i personave të papunë punëkërkues të mbuluar me skemën e Ndhimës Ekonomike është zvogëluar 5 herë në 2021 krahasuar me vitin 2018.

Grafiku 56: Të papunë të mbuluar nga skema Ndhimës Ekonomike në bashki 2017-2021



\*Në 2017 kanë raportuar vetëm 8 bashki ndaj shifra nuk është e plotë

**Problemet dhe sfidat** .....

- Kapacitetet njëzore në strukturat e mbrotjes sociale sipas tre kategorive janë të pamjaftueshme, për trajtimin e rasteve të lidhura më mbrojtjen e fëmijëve, dhunës në familje dhe barazisë gjinore. Në pjesën më të madhe të bashkive të tre funksionet mbulojnë nga një person i vetëm.
- Burime të kufizuara teknike dhe financiare për krijimin e bazës së të dhënave statistikore sipas treguesve të BE-së për përfshirjen sociale nga të gjitha bashkitë në vend.
- Sfidë mbetet shtimi i nëpunësve në Sektorin e Shërbimeve Sociale, duke bërë të mundur një koordinim dhe mirëorganizim të punës;
- Mungesa e banesave sociale dhe e programeve të strehimit social është një sfidë për bashkitë, kundrejt nevojave të paraqitura për strehim.
- Përfitimi i shërbimeve sociale në qendrat e themeluara të kujdesit social duhet të jetë më i gjerë dhe më gjithëpërfshirës.
- Përfshirja në skemën e ndihmës ekonomike të familjeve më në nevojë dhe dhënia prioritet grave kryefamiljare dhe atyre me probleme sociale.

**Rekomandime** .....

- Rritja e numrit të nëpunësve të administratës vendore përgjegjës për përfshirjen sociale në bashki për të tre kategoritë si edhe për ndihmën ekonomike. Ndarja e funksioneve me persona të dedikuar sipas tematikave.
- Organizimi i vazhdueshëm i trajnimeve të dedikuara për barazinë gjinore dhe aspekte të tjera të mbrotjes së fëmijëve dhe rastet e dhunës në familje.
- Miratimi i planeve sociale vendore nga të gjitha bashkitë dhe harmonizimin e tyre me programin buxhetor afatmesëm.
- Hartimi i raportit të vlerësimit të nevojave si dhe ngritja e sektorit të vlerësimit të nevojave dhe referimit nga të gjitha bashkitë.
- Krijimi i qendrave komunitare për të gjitha grupet vulnerabël në secilën bashki me qëllimin e marrjes së shërbimeve.
- Rritja e bashkëpunimit me OJF-të lokale të specializuara për ofrimin e shërbimeve sociale si dhe krijimi i instrumentave financiarë për të mbështetur me fonde dhe projekte të dedikuara.
- Funkcionalizimi i sistemit të informacionit të menaxhimit për shërbimet e përkujdesit social në mënyrë që të sigurohet ndjekja sistematike e menaxhimit, raportimit dhe monitorimit të rasteve të përfituesve të shërbimeve të kujdesit social.
- Ndarja e buxhetit komunal për shërbimet e kujdesit social dhe krijimi i fondit social lokal.
- Funkcionalizimi i regjistrimit elektronik të shërbimeve të kujdesit social në nivel vendor

**Objektivi specifik: Mbështetje për programet aktive të punës**


- Në vitin 2021 numri i PAK që janë përkrahur nga Bashkia për arsim dhe trajnim profesional raportohen në total 6660 ose mesatarisht 122 persona për Bashki (N=55). Dy bashkitë me numrin më të madh janë Bashkia Tiranë me 6000 persona ose 90% e totalit dhe Bashkia Elbasan me 535 PAK. 60 % e Bashkive kanë raportuar 0 Persona me Aftësi të Kufizuara të mbështetur dhe 6 Bashki nuk kanë dhënë informacion<sup>107</sup>. **Treguesi ka pësuar një rritje të konsiderueshme në krahasim me vitin 2020 ku janë mbështetur gjithsej 230 dhe në 2019 gjatë të cilit janë mbështetur 262 individë.**
- Në total 199 të rinj që kanë përfunduar arsimin universitar dhe programin e formimit profesional në 2021 janë mbështetur nga shërbimet e bashkisë dhe aktorë të tjerë për hapjen e një biznesi në fushat e tyre respektive ose mesatarisht 3.83 individë për bashki (N=52). **Ky tregues mbetet në nivele të njëjta me vitin 2020 me 176 përfitues dhe në 2019 me 179 të rinj të mbështetur.**

<sup>107</sup> Bashkitë Cërrik, Devoll, Këlcyrë, Selenicë, Vlorë, Vorë

23.61 të rinj (N=54). **Treguesi ka ulje krahasuar me vitin 2020 ku janë raportuar 1477 ndërkohë që ka rritje nga 2019 janë raportuar vetëm 59 të rinj që kanë përfituar.**

- Në 2021 numri i bashkive që kanë firmosur Memorandum Bashkëpunimi me Zyrën e Punës për punësimin e të rinjve si edhe për riintegrimin socio-ekonomik të personave të trajtuar me Ndhimë Ekonomike ka arritur në 43 në total (N=57) nga 41 të raportuara në 2020.

Grafiku 57: Numri i të rinjve që kanë përfituar nga iniciativat e bashkëpunimit me Zyrën e Punës, 2021



### Problemet dhe sfidat

- Burimet financiare dhe njerëzore të ulëta mbeten sfidë për të kryer analizën në terren si dhe bashkërendimi i veprimeve ndërmjet bashkive, ministrive të linjës, agjencive rajonale dhe zyrave në nivel vendor është në ende i kufizuar.
- Mungesa e fondeve dhe kapaciteteve profesionale në bashki për personat që trajtohen nga skema e Ndhimës Ekonomike me qëllim integrimin e tyre në tregun e punës.
- Mungesë koordinimi ndër-institucional për të nxitur punësimin dhe në mënyrë të veçantë për shtresat në nevojë.
- Mungesë informimi dhe edukimi i të rinjve për mundësitë e integrimit të tyre në tregun e punës dhe bashkëpunimi jo i mirë me OSHC që veprojnë në këtë fushë.
- Kapaciteti i qeverisjes vendore për të vlerësuar nevojat, për të aplikuar për fonde qeveritare dhe për të menaxhuar shërbimet sociale mbetet i dobët<sup>108</sup>.

### Rekomandime

- Nxitja e të rinjve për të ndjekur arsimin profesional përmes ndërmarrjes së fushatave informuese dhe ndërgjegjësuese është domosdoshmëri për të përmirësuar tregun e punës në të ardhmen.
- Rritja e bashkëpunimit me Zyrën e Punës mbi përmirësimin dhe zgjerimin e mundësive për arsim dhe aftësim profesional.
- Rritja e kapaciteteve financiare të Bashkive për të mbështetur financiarisht të rinjtë për fillimin e një biznesi privat në fushën e tyre profesionale.
- Të sigurohet zbatimi i Fondit Social të Punësimit dhe të vazhdojë forcimi i strukturave të punësimit në nivel vendor.

<sup>108</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)



- Zbatimi i akteve nënligjore për kriteret e përfaqësimit për anëtarësim në Këshillin Kombëtar të Punës dhe miratimin e akteve nënligjore për krijimin e këshillit trepalësh të qarkut.<sup>109</sup>

## PËRFUNDIME MBI POLITIKAT SOCIALE DHE PUNËSIMIN

**Shqipëria ka një kuadër të mirë Strategjik dhe Ligjor për Çështjet Sociale, Punësimin dhe Formimin profesional të harmonizuar edhe me standartet e BE-së.** Ndryshimet në Kodin e Punës futën më shumë masa për të mbështetur barazinë gjinore në tregun e punës, kryesisht të lidhura me ndërgjegjësimin dhe mbështetjen e fuqizimit ekonomik të grave në tregun e punës. Për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, strategjia kombëtare për mbrojtjen sociale 2015-2020 u rishikua dhe u zgjat deri në vitin 2023.

**Problematikat në zbatimin e politikave dhe legjisllacionit në nivel vendor janë të lidhura kryesisht me mungesën e kapaciteteve financiare dhe njëzore të bashkive.** Shpenzimet publike për programet e shërbimeve të kujdesit social janë ende të kufizuara dhe nuk ka një mekanizëm për monitorimin e situatës së kategorive që janë të më të cënueshëm dhe pa akses në shërbime të tilla. **Progres është shënuar në drejtim të rritjes së numrit të personave që dalin nga skema ekonomike dhe ri-integrimit në tregun e punës përmes formimit profesional apo bashkëpunimit me zyrat e punës.** Gjithashtu është rritur mbështetja me programet aktive të punës për personat PAK duke rritur iniciativat për arsim dhe trajnim profesional të kësaj kategorie.

**Ka vijuar hartimi dhe miratimi i planit vendor për përfshirjen sociale nga bashkitë si dhe janë zhvilluar më shumë trajnime nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për nëpunës vendor mbi metodologjitë e matjes së treguesve të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale.** Me gjithë trendin pozitiv në numrin e trajnimeve sërish kapacitetet e bashkive për të hartuar raportet e vlerësimit për nevojat sociale janë në nivele të ulëta. **Gjithashtu, ngritja e sektorit të vlerësimit të nevojave dhe referimit nuk është realizuar nga gjysma e bashkive.**

**Ngritja e bazës statistikore për përfshirjen sociale ka vijuar me ritme të ngadalëta dhe në një pjesë të madhe të tyre ende nuk është funksionale.** Qeveria duhet të shtojë përpjekjet për të zbatuar sistemin e Menaxhimit të Informacionit për shërbimet e kujdesit social në të 61 bashkitë dhe ofruesit e shërbimeve sociale të licencuara jo publike, në mënyrë që të sigurojë raportim të saktë për përfituesit e shërbimeve të kujdesit social<sup>110</sup>.

## 3.7 KAPITULLI 22: POLITIKAT RAJONALE DHE KOORDINIMI I INSTRUMENTAVE STRUKTURORË

“Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e politikës rajonale dhe koordinimit të instrumenteve strukturore. Është bërë progres i kufizuar veçanërisht me miratimin e Ligjit për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin në vitin 2020. Qeveria Shqiptare duhet të vazhdojë me hartimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Zhvillimin dhe Kohezionin Rajonal (2021-2027) dhe të plotësojë Planet e Zhvillimit Rajonal (2021-2024) të cilat duhet të nxisin potencialin e zhvillimit të të gjitha rajoneve në Shqipëri me synimin për t'u ofruar atyre mundësi që të zhvillojnë vetë dhe vazhdojnë me ndërhyrje të decentralizuara bazuar në plane dhe strategji të integruara lokale dhe/ose rajonale<sup>111</sup>”.

Në korrik të vitit 2021 në Këshillin Konsultativ (KK) për vetëqeverisjen vendore është paraqitur për diskutim projektvendimi “Për përcaktimin e rajoneve të zhvillimit dhe kufijve të tyre”. Projektvendimi del në zbatim të ligjit nr.102/2020 për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin i cili synon të hartojë kuadrin institucional për të siguruar zhvillimin e balancuar rajonal të vendit. Me qëllim menaxhimit, zbatimin dhe vlerësimin e politikës së zhvillimit rajonal dhe kohezionit, territorit i Republikës së Shqipërisë ndahet në katër zona/rajone zhvillimi. Sipas përcaktimit të ligjit rajonet e zhvillimit janë territoret për të cilat hartohet, zbatohet dhe vlerësohet politika kombëtare për zhvillimin dhe kohezionin rajonal.

<sup>109</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)


<sup>110</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

<sup>111</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

Objekti i specifik: forcimi i bashkëpunimit në zhvillimin rajonal dhe lokal në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe të zvogëlojnë pabarazitë (të sigurohet kohezioni ekonomik dhe social ndërmjet rajoneve).

- Në 2021 janë ndërmarrë në total 152 iniciativa me interes të përbashkët me bashkitë e tjera ose mesatarisht 2.71 iniciativa për bashki (N=56), duke shënuar një rritje në krahasim me vitin 2020 (134 iniciativa). 43% e bashkive nuk kanë raportuar asnjë iniciativë për bashkëpunim me bashki fqinje ose në nivelin rajonal ndërkohë që pesë bashki Vorë, Shijak, Memaliaj, Has dhe Durrës nuk kanë dhënë asnjë informacion për këtë tregues. Numrin më të madh të bashkëpunimeve e ka Bashkia Maliq me 20 iniciativa dhe Bashkia Lezhë me 16.

Grafiku 58: Numri i bashkëpunimeve ndërmjet NJQV, 2021



- Janë raportuar në total 113 pjesëmarrje në iniciativa të përbashkëta rajonale dhe Evropiane me synim reduktimin e diferencave rajonale (programet e bashkëpunimit rajonal dhe transnacional, ose mesatarisht 2.31 iniciativa për bashki (N=49). Vetëm 48% e bashkive raportojnë për bashkëpunime rajonale dhe Evropiane, ku numrin më të madh e ka Bashkia Lezhë me 20 dhe Bashkia Gjirokastër me 18. Treguesi ka përmirësim të lehtë me vetëm 11 pjesëmarrje në Iniciativa rajonale më shumë se në vitin 2020.

### Kutia 1: Praktika të bashkëpunimit në zhvillimin rajonal dhe lokal

**Bashkia Lezhë:** Në kuadër të konkursit të praktikave të mira janë 16 bashki të cilat kanë shprehur interesin për replikimin e praktikës së Bashkisë Lezhë "Menaxhimi i mbetjeve".


**Bashkia Maliq:** Ka patur 20 bashkëpunime në fusha të ndryshme (ekonomi, turizëm, shërbim social) të njëpasnjëshme me të pesta bashkitë e qarkut.

**Bashkia Mirditë:** Bashkëpunim me Bashkinë Mat për bërjen të mundur furnizimin me ujë të pijshëm të fshatit Trangë të Njësisë Administrative Selitë të Bashkisë Mirditë nga ujësjellësi i Matit.

**Bashkia Patos:** Bashkëpunon me Bashkinë Fier për të përdorur Qendrën Multifunkionale për fëmijët me Aftësi të Kufizuar të territorit të Bashkisë Patos. Fëmijët me AK përfitojnë shërbime ditore pa pagesë në atë institucion.

**Bashkia Dropull:** Bashkëpunon me 7 Bashki homologe të Qeverisë Greke për zhvillimin ekonomik dhe forcimin e marrëdhënieve të dy vendeve.

Grafiku 59: Pjesëmarrje në iniciativa të përbashkëta rajonale dhe Evropiane të NJVV, 2021



### Rekomandime

- Rritja e bashkëpunimit midis institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor për një zhvillim më të mirë rajonal dhe kohezionin social përmes hartimit dhe zbatimit të planeve zhvillimore rajonale.
- Fuqizimi i bashkëpunimit ndërbashkiak dhe në nivel rajonal për të nxitur iniciativa dhe projekte zhvillimore të përbashkëta ndër-rajonale.
- Rritja e aktivizimit dhe ndërgjegjësimit të stafeve të bashkive për rëndësinë e bashkëpunimit rajonal si edhe në nivel Evropian përmes organizimit të fushatave sensibilizuese dhe aktiviteteve të përbashkëta.
- Shtimi i numrit të projekteve dhe financimeve që marrin bashkitë nga BE si edhe donatorë të tjerë për iniciativa ndër-rajonale dhe projekte zhvillimore në nivel qarku dhe rajoni.
- Forcimi i kapaciteteve të stafeve të bashkive për hartimin e projekteve dhe pjesëmarrjes me aplikime të suksesshme në programet e BE-së rajonale dhe ndërkufitare.

### PËRFUNDIME MBI POLITIKAT RAJONALE

Kanë vazhduar përpjekjet e Bashkive për të rritur bashkëpunimin rajonal dhe atë Evropian por sërish niveli i iniciativave të përbashkëta të ndërmarra mbetet i kufizuar. Rreth 40 % e Bashkive nuk raportojnë bashkëpunime apo pjesëmarrje në projekte të përbashkëta rajonale. Kapacitetet e bashkive për hartimin e projekteve dhe thithjen e financimeve nga fondet e BE-së dhe donatorëve të tjerë me përfitues disa bashki mbeten ende të limituara dhe të varura nga partnerët e vendeve të rajonit apo ato evropianë.

**Hap pozitiv shënoi miratimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 459 datë 30.07.2021 “Për përcaktimin e rajoneve të zhvillimit dhe kufijve të tyre” në zbatim të ligjit nr.102/2020 “Për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin”** i cili synon të definojë kuadrin insitucional për të siguruar zhvillimin e balancuar rajonal të vendit. Me qëllim menaxhimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikës së zhvillimit rajonal dhe kohezionit, territori i Republikës së Shqipërisë ndahet në katër zona/rajone zhvillimi. Sipas përcaktimit të ligjit rajonet e zhvillimit janë territoret për të cilat hartohet, zbatohet dhe vlerësohet politika kombëtare për zhvillimin dhe kohezionin rajonal.

**Për një politikë rajonale të suksesshme tashmë Shqipëria duhet të vazhdojë me hartimin e Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Zhvillimin dhe Kohezionin Rajonal (2021-2027) dhe Planet e Zhvillimit Rajonal (2021-2024)** me qëllim që të nxisin potencialin e zhvillimit të të gjitha rajoneve në Shqipëri dhe për t'u ofruar atyre mundësi që të vazhdojnë me ndërhyrje të decentralizuara bazuar në plane dhe strategji të integruara lokale dhe/ose rajonale<sup>112</sup>.

<sup>112</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

### 3.8 KAPITULLI 23: GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE


“Shqipëria ka ratifikuar shumicën e konventave ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e të drejtave themelore. Progres është shënuar në të drejtat e pronësisë në lidhje me regjistrimin, dixhitalizimin dhe zbatimin e skemës së kompensimit. Kuadri ligjor për anti-diskriminimin është përmirësuar më tej, por praktika gjyqësore ende nuk është zhvilluar në mënyrë thelbësore. Është bërë përparim në aspekte të tjera të të drejtave themelore, për shembull në zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe në barazinë gjinore. Vlerësimi i nivelit të zbatimit të legjislacionit, politikave dhe strategjive për të drejtat e njeriut mbetet një sfidë për shkak të mungesës së monitorimit dhe të dhënave gjithëpërfshirëse. Shqipëria ka avancuar në ngritjen e një kuadri ligjor që rregullon të drejtat e fëmijës. Janë forcuar kapacitetet institucionale për të adresuar vështirësitë në zbatimin e të drejtave të fëmijëve. Megjithatë, mungesa e mjeteve të kompensimit të duhur për shkeljet e të drejtave mbetet shqetësuese.”<sup>113</sup>

Progresi në ushtrimin e funksioneve dhe rolit të NJVV për këtë fushë vlerësohet mbi bazën e 47 treguesve të performancës për gjashtë objektiva specifike.


*Objekti i specifik: forcimi i sistemit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*

**Një hap pozitiv është shënuar me hartimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026.** Agjenda e miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 659, datë 03.11.2021 është diskutuar edhe në Këshillin Konsultativ të Qeverisjes Qëndrore me Qeverinë Vendore. Agjenda paraqet një hap të rëndësishëm në realizimin e angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të fëmijëve. Ky dokument adreson sfidat më domethënëse të çështjeve që lidhen me dhe për fëmijët, përfshirë ato të krijuara edhe për shkak të pandemisë së Covid-19.

Harta 19: Ngritja e NJMF në Bashki



Harta 20: Krijimi i sistemit të monitorimit për MF në Bashki




<sup>113</sup> Raport i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

➔ Progresi në këtë objektiv sipas treguesve është si më poshtë:


- Në 2021 kanë ngritur Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve në administratën vendore 55 Bashki (N=61) me vetëm dy bashki më shumë nga viti 2020. Njësia rezultoi e pa ngritur ende në gjashtë bashki: Devoll, Dropull, Mat, Patos, Sarandë dhe Shijak.
- 70% e bashkive raportojnë krijimin e një sistemi për monitorimin e rasteve për shkelje të të drejtave të fëmijës në vitin 2021 (N=61). Treguesi nuk ka shënuar progres krahasuar krahasuar me 2020.
- Në 2021 janë zhvilluar në total 856 takime të përbashkëta të grupeve ndërdisiplinore në nivel bashkie ose mesatarisht 14.3 takime për bashki (N=60). Numrin më të madh të takimeve e ka bërë bashkia Tiranë me 366 ndërsa Bashkia Vorë nuk ka ofruar të dhëna. Treguesi ka rritje nga viti 2020 me një mesatare takimesh prej 13.5 takime nga 10.85 takime që ka qënë në 2019 dhe 2018.
- Numri total i rasteve të identifikuar dhe të trajtuara për shkelje të të drejtave të fëmijëve është raportuar 1,248 ose mesatarisht 21.52 takime për bashki (N=58) me një rritje të lehtë nga viti 2020 ku janë raportuar mesatarisht 19.55 raste për bashki. Numrin më të madh e raportojnë Bashkia Tiranë me 371 raste, Bashkia Durrës me 139 raste, Bashkia Fier me 97 dhe Shkodër me 70 raste.
- Shkalla mesatare e urdhërave për mbrojtje të lëshuara ndaj numrit të rasteve të identifikuar është rreth 45% (N=59).** Referuar shërbimeve të posaçme, mesatarisht për 50% të rasteve të identifikuar të fëmijëve, bashkitë kanë mundur ofrimin e shërbimeve të veçanta. Treguesi ka rritje nga 2020 ku shërbimet ishin ofruar në 39.61% të rasteve, por përsëri mbetet e ulët shkalla e ofrimit të shërbimeve kundrejt rasteve të identifikuar.
- Mesatarisht, 5.2% e buxhetit për mbrojtjen sociale është përdorur nga NJQV për rastet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve (N=55). **Treguesi ka rritje nga 2020 me dy herë me shumë krahasuar me 2.63% të buxhetit të alokuar.** Gjashtë bashki nuk kanë ofruar të dhëna për treguesin<sup>114</sup>.
- Në 2021 bashkitë kanë raportuar gjithsej 132 punonjës social për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF), ose mesatarisht 2.16 punonjës social për bashki (N=61). **Treguesi ka rënie nga viti 2020 ku janë raportuar 177 punonjës.** Numrin më të madh të punonjësve social e ka raportuar Bashkia Tiranë me 27 dhe Bashkia Gramsh 10. **Bashkitë Konispol, Has, Dibër, Delvinë, kanë raportuar 0 punonjës social për Mbrojtjen e Fëmijëve në vitin 2021.**
- Në vitin 2021, janë organizuar në total 613 aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve ose mesatarisht 10.57 aktivitete për Bashki (N=58). Treguesi ka rritje me 59% krahasuar me vitin 2020 ku janë raportuar në total 361 aktivitete. **Numrin më të madh të aktiviteteve e ka Bashkia Tiranë me 172 pasuar nga Bashkia Shkodër me 68 aktivitete të organizuara.**

Grafiku 60: Aktivitete të organizuara nga NJQV për promovimin e të drejtave të fëmijëve, 2021



<sup>114</sup> Vorë, Shijak, Memaliaj, Elbasan, Cerrik, Belsh

Grafiku 61: Aktivitete të organizuara nga NJQV për promovimin e të drejtave të fëmijëve 2017-2021



### Problemet dhe sfidat .....

- Njësia për mbrojtjen e fëmijëve ende nuk është funksionale në një pjesë të bashkive. Gjithashtu kapacitetet njerëzore dhe financiare mbeten ende të ulëta në nivel lokal.
- Punonjësit socialë në bashki për mbrojtjen e fëmijëve janë në numër shumë të kufizuar dhe në një pjesë të bashkive ende nuk ka asnjë punonjës social.
- Mungesa e një planifikimi buxhetor koherent me nevojat për trajtimin e rasteve të dhunës apo mbrojtjen e fëmijëve në gjithë territorin e Bashkisë.
- Fondi nga buxheti i bashkive për mbrojtjen sociale për rastet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve mbetet në nivele shumë të ulëta.
- Sistemi i monitorimit të rasteve të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve nuk është ende funksional në të gjitha bashkitë.
- Ekziston një mungesë kritike e shërbimeve (psikolog, ndërmjetësim), duke përfshirë koordinimin dhe trajnimin e profesionistëve të angazhuar në shërbimet e drejtësisë për të miturit)<sup>115</sup>.

### Rekomandime .....

- Ngritja dhe bërja funksional i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve duke u lidhur me të gjitha institucionet e shërbimeve shoqërore për referimin e rasteve.
- Rritja e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor në lidhje me zbatimin e legjislacionit, procedurat e mbrojtjes së fëmijëve, identifikimin proaktiv dhe bashkëpunimin ndër-sektorial.
- Alokimi i buxheteve adekuate dhe të dedikuara për të mbuluar kostot që rrjedhin nga menaxhimi i rasteve.
- Përmirësimi i njohurive dhe kapaciteteve të Grupeve Teknike Ndërmministrorë për menaxhimin e rasteve të Fëmijëve në Nevojë për Mbrojtje.
- Sigurimi i aksesit në shërbime të fëmijëve nga zonat rurale të thella si dhe fëmijët në situatë rruge, përmes bashkërendimit të veprimeve dhe shkëmbimin e informacionit midis strukturave përgjegjëse për trajtimin e rasteve.

<sup>115</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

- Zgjerimi i shportës së shërbimeve dhe ofrimi i tyre në një hapësirë kohore më të gjatë. Bashkpënimimi më i mirë me OJF e licensuara për ofrimin e shërbimeve të specializuara në mbrojtje të fëmijëve.

*Objektivi specifik: zbatimi efektiv i ligjit 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"*

Gjatë vitit 2021 në Këshillin Konsultativ (KK) për vetëqeverisjen vendore është paraqitur për diskutim "Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI+, 2021 - 2027". Ky është plani i tretë veprimit në nivel kombëtar me fokus mbrojtjen e të drejtave, ofrimin e shërbimeve cilësore, rritjen e ndërgjegjësimit dhe zvogëlimin e nivelit të papranueshmërisë së shoqërisë kundrejt personave LGBTI+ në Shqipëri.

Progresi nga NJQV në këtë objektiv sipas treguesve është si më poshtë:

- **Në vitin 2021 janë trajnuar 221 nëpunës të administratës lokale mbi ligjin e mbrojtjes nga diskriminimi** ose mesatarisht 3.81 nëpunës për bashki (N=58). Treguesi ka pësuar ulje nga viti 2020 ku janë trajnuar 256 persona. Numrin më të madh të nëpunësve të trajnuar e ka bashkia Durrës me 84 dhe Lushnjë me 15.<sup>116</sup> **Ndërkohë 31% e bashkive raportuese nuk kanë ndjekur asnjë trajnim për ligjin kundër diskriminimit.**
- Në 2021 sistemi i monitorimit të rasteve të identifikuar të diskriminimit është ngritur në 21 Bashki (N=58) nga 24 Bashki në vitin 2020. Sistemi i monitorimit të rasteve është një instrument për trajtimin efektiv të rasteve nga nëpunësit vendor në bashkërendim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>117</sup>.
- **Në 2021 janë ndërmarrë në total 55 fushata ndërgjegjësuese të organizuara nga 16 Bashki** (N=58) në shkolla dhe komunitete për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI+. Numrin më të madh të fushatave e ka Bashkia Pogradec me 18 aktivitete dhe Bashkia Elbasan me 8. *Numri i aktiviteteve është në rritje në krahasim me vitin 2020 ku janë ndërmarrë në total 21 dhe 14 fushata në 2019.*

*Objektivi specifik: zbatimi efektiv i ligjit 96/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e pakicave etnike"*

Gjatë vitit 2021 në Këshillin Konsultativ (KK) për vetëqeverisjen vendore është paraqitur për diskutim Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje të Romëve dhe Egjiptianëve 2021 -2025". Vizioni i "PKVBPPRE 2021-2025" është "Krijimi i kushteve të përshtatshme për të arritur barazinë, pjesëmarrjen dhe përfshirjen e Minoritetit Rom dhe Egjiptian në Republikën e Shqipërisë, në të gjitha aspektet e jetës shoqërore vecanërisht qasjen në arsim, punësim, strehim, shërbime shëndetësore dhe sociale, për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe mirëqënien, si dhe të zvogëlojë hendekun social - ekonomik dhe kulturor ndërmjet romëve dhe egjiptianëve nga njëra anë dhe pjesës tjetër të shoqërisë.

➡ **Progresi nga NJQV në këtë objektiv sipas treguesve është si më poshtë:**

- Në vitin 2021 sistemi i monitorimit për shkelje të të drejtave të pakicave është ngritur dhe është funksional në vetëm 19 Bashki nga 20 bashki në 2020.<sup>118</sup> Treguesi ka shënuar regres.
- Në 2021 janë organizuar 235 aktivitete kulturore dhe fushata ndërgjegjësimi për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Minoriteteve Etnike ose mesatarisht 4 aktivitete për bashki (N=58). Numri i aktiviteteve është rritur me 60 % krahasuar me vitin 2020.<sup>119</sup> **Numrin më të madh të aktiviteteve e ka Bashkia Shkodër me 51 dhe Bashkia Mat me 20.**
- Numri i nëpunësve lokalë të trajnuar për zbatimin e Planit Kombëtar për Romët dhe Egjiptianët në vitin 2021 është në total 65 ose mesatarisht 1.14 nëpunës për bashki (N=57). **Kanë marrë trajnime 52% e bashkive duke shënuar rritje krahasuar me vitin 2020 ku vetëm 23% e bashkive kanë ndjekur trajnime. Numrin më të madh të nëpunësve të trajnuar në 2021 e kanë Bashkia Rrogozhinë me 7, pasuar nga Durrësi dhe Përmeti me 6 nëpunës.**


<sup>116</sup> Bashkitë Cërrik, Memaliaj, Vorë nuk kanë dhënë informacion për këtë tregues

<sup>117</sup> Bashkitë Vlorë, Shijak, Fushë-Arrëz, Durrës, dhe Cërrik nuk kanë dhënë informacion

<sup>118</sup> Bashkitë: Vlorë dhe Cërrik nuk kanë dhënë informacion

<sup>119</sup> Bashkitë Vorë, Vlorë dhe Cërrik nuk kanë dhënë informacion


Grafiku 62: Numri i nëpunësve lokalë të trajnuar për zbatimin e Planit Kombëtar për Romët dhe Egjiptianët 2021




Objekivi specifik: Përmirësimi i koordinimit të punës ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e minoriteteve Rome dhe Egjiptiane 2016-2020

- Në 2021 janë trajnuar gjithsej 32 nëpunës civil të administratës lokale mbi angazhimet e Bashkisë për Planin Kombëtar për Romët dhe Egjiptianët. **Mesatarisht 1.8 persona janë trajnuar për bashki (N=58). Treguesi është në nivele të njëjta me vitin 2020.**

Harta 21: PV për Integrimin e pakicave, 2021




Grafiku 63: Plani lokal i veprimit për përfshirjen e R&E






- **36% e bashkive** kanë raportuar se plani i veprimit për integrimin e pakicave Rome dhe Egjiptiane në nivel vendor është hartuar dhe miratuar nga Këshilli Bashkiak në vitin 2021 (N=59). **Treguesi shënon ulje në krahasim me 2020. Bashkitë Selenicë dhe Tepelenë nuk japin informacion për këtë tregues.**
- Në vitin 2021, trajnimet për grumbullimin e të dhënave dhe raportimin në kuadër të sistemit ROMALB janë ndjekur nga 40 nëpunës (N=57) mesatarisht më pak se një trajnim për bashki; treguesi është në ulje në krahasim me vitin 2020 ku janë trajnuar 72 nëpunës. **Numrin më të madh të nëpunësve të trajnuar e ka Bashkia Shijak me 4 dhe Skrapar, Finiq e Fier me nga 3.**
- Shfrytëzimi i rregullt i sistemit ROMALB për statistika dhe analiza, si dhe raportim për vendimmarrjen e Bashkisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është raportuar në vitin 2021 nga 32 bashki. (N=54). Treguesi është në të njëjtin nivel me vitin 2020.
- Rreth 11.7% janë përfitues R&E nga programet e strehimit social në bashki në raport me numrin gjithsej të aplikimeve për vitin e raportimit (N=54). Treguesi ka ulje nga viti 2020 ku janë raportuar 22% përfitues. **Numrin më të madh e raportojnë bashkia Klos dhe Rrogozhinë.**

Grafiku 64: Numri i përfituesve R&amp;E nga programet e strehimit, 2021



- **Në 2021 janë zbatuar 72 projekte**, ose mesatarisht 1.24 projekte për bashki (N=58) në mbështetje të pakicave rome dhe egjiptiane, nga 75 projekte në vitin 2020. Numrin më të madh e ka Bashkia Tiranë me 15 projekte.
- **Numri i të punësuarve të pakicave rome dhe egjiptiane në vitin 2021 është në total 661 ose mesatarisht 12.47 për bashki (N=53).** Numri i të punësuarve është në ulje nga 837 të punësuar në total nga këto komunitete në vitin 2020. **Numrin më të madh të punësuarve të komunitetit R&E e kanë Bashkia Shkodër me 263 dhe Bashkia Berat me 103.**
- **Në 2021 të punësuarit nga pakicat rome dhe egjiptiane në institucionet e bashkisë dhe shërbimet publike është 214 në total ose mesatarisht 3.96 për bashki (N=54).** Numri është në ulje nga viti 2020 me 280 në total ose 5.28 mesatarisht për bashki. Numrin më të madh të punësuarve R&E e ka bashkia Shkodër me 37, pasuar nga Bashkia Përmet me 28, Bashkitë Sarandë dhe Dibër me 20.

Grafiku 65: Numri i të punësuarve R&amp;E në institucionet e Bashkisë gjatë vitit 2021



### Problemet dhe sfidat .....

- Planet e veprimit për integrimin e pakicave në komunitet nuk janë hartuar nga të gjitha bashkitë e vendit.
- Sistemi i monitorimit për shkelje të të drejtave të pakicave nuk është ngritur ende në një numër të konsiderueshëm të bashkive.
- Burimet financiare të pamjaftueshme për mbështetjen me programe të vecanta, me projekte dhe strehim si dhe për organizimin e aktiviteteve të drejtpërdrejta për pakicat R&E.
- Numri i ulët i organizatave të shoqërisë civile të specializuara që ofrojnë shërbime për qytetarët në luftën kundër diskriminimit dhe njohjen e të drejtave të minoriteteve.
- Mungesa e trajnimeve nga institucionet nderkombëtare dhe organizata të specializuara për mbrojtjen e të drejtave të pakicave.

### Rekomandime .....

- Shtimi i burimeve njerëzore pranë shërbimit social të bashkive për çështjet e pakicave rome dhe egjiptiane për të vlerësuar situatën, monitorimin në terren dhe ndjekjen e problematikave.
- Miratimi i planeve vendore për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane nga bashkitë që ende se kanë realizuar si dhe përfshirjen në PBA të fondeve për zbatimin e tyre.
- Ngritja e sistemit të monitorimit për shkeljen e të drejtave të pakicave si dhe përdorimi i sistemit ROMALB nga të gjitha bashkitë.
- Mbështetja me trajnime për stafet e bashkive që trajtojnë çështjet e pakicave etnike R&E.

### Objektivi specifik: Forcimi i sistemit për sigurimin e barazisë gjinore

Gjatë vitit 2021 në Këshillin Konsultativ (KK) për vetëqeverisjen vendore është paraqitur për diskutim:

**Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 -2030 ”.** SKBGJ-2021-2030 e hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 400, datë 30.6.2021. Strategjia e re i kushton vëmendje të veçantë arritjes së barazisë gjinore si dhe zvogëlimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kushte drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

**Projektvendimi “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare si dhe procedimin e tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës”.** Ky vendim ka si qëllim parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës



ndaj grave, kryesisht, përmes referimit dhe menaxhimit të rasteve të dhunës, mbështetjes dhe rehabilitimit të viktimave të të gjitha formave të kësaj dhune.

➔ **Progresi nga NJVV në këtë objektiv sipas treguesve është si më poshtë:**

- Në 2021 numri i bashkive që kanë krijuar funksionin e barazisë gjinore arriti në 42 ose 68% (N=60). Numri është rritur me vetëm një bashki më shumë se në 2020. **Bashkia Skrapar nuk ka raportuar asnjë të dhënë.**
- 85% të bashkive kanë emëruar nëpunësin vendor në kapacitetin e koordinatorit lokal për çështjet gjinore në vitin 2021 (N=60), duke shënuar një rritje prej 5 p.p. krahasuar me vitin 2020. **Bashkia Fushë-Arrëz nuk ka ofruar informacion lidhur me emërimin apo jo të koordinatorit.**
- Në 2021 aplikimi i mekanizmave në kuadër të harmonizimit të masave për të luftuar dhunën në familje është funksional në 97 % të bashkive (N=60), me një rritje prej 2 p.p. në krahasim me 2020. **Bashkia Mirditë nuk e ka ngritur mekanizmin ndërsa Bashkia Tepelenë nuk jep informacion.**

Harta 22: Sektori i barazisë Gjinore i ngritur në NJVV


Harta 23: Mekanizmi i sistemit të referimit ndaj dhunës në familje 2021



- Në 2021, numri i programeve të trajnimit për çështjet e barazisë gjinore (programe të ofruara nga ASPA dhe ofrues të tjerë) është raportuar në total 272 ose 4.69 trajnime për bashki (N=58) në të njëjtat nivele krahasuar me vitin 2020.
- Për rastet e raportuara dhe të identifikuara të viktimave të dhunës në familje, bashkitë ofrojnë shërbime të specializuara në qendra komunitare të përkujdesit social, shërbime me psikologë dhe trajtime të tjera;


në vitin 2021 janë ofruar gjithsej 380 shërbime nga 441 në vitin 2020. Numrin më të madh të shërbimeve e ka Bashkia Kavajë me 69, Bashkia Krujë me 52 dhe Kuçovë me 40 (N=59).

Grafiku 66: Shërbime të specializuara të ofruara nga NJVV për viktimat e dhunës në familje, 2021



- **Në vitin 2021 janë bërë në total 2092 raportime për rastet e dhunës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përmes sistemit REV-ALB, ose mesatarisht 38 raste për bashki (N=55). Treguesi shënon rritje të konsiderueshme me 4.3 herë më shumë raportime se në vitin 2020.** Numrin më të madh të raportimeve e ka Bashkia Durrës me 632, Bashkia Tiranë me 341 dhe Bashkia Vlorë me 228. *Bashkitë Belsh, Dibër, Këlcyrë, Kurbin, Libohovë, Tropojë nuk kanë bërë asnjë raportim prane MSHMS në vitin 2021 ndërkohë që 6 Bashki<sup>120</sup> nuk japin informacion.*

Grafiku 67: Aktivitete të Bashkive dhe OSHC për diskriminimin gjinor, 2021




- **Raportime për çështje të barazisë gjinore në MSHMS janë kryer nga 54 bashki me një total prej 1053 ose mesatarisht 19.5 raportime për bashki (N=54).** Numri i raportimeve është rritur 7 herë në krahasim me vitin 2020. **Numrin më të madh sërisht e ka Bashkia Durrës me 632 që përkon me raportimin e bërë përmes sistemit REV-ALB dhe që shpjegon se rastet e raportuara nga bashkia Durrës kanë qënë të lidhura me çështjet e barazisë gjinore.**

<sup>120</sup> Bashkitë Vorë, Skrapar, Peqin, Memaliaj, Delvinë, Cërrik


- Në kuadër të bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe projektet e donatorëve janë realizuar në total 258 aktivitete kundër diskriminimit gjinor ose mesatarisht 4.37 aktivitete për bashki (N=59). Treguesi mbetet në të njëjtat nivele me vitin 2020. **Numrin më të madh të aktiviteteve e kanë Bashkia Tiranë (31), Bashkia Shkodër (28) dhe Bashkia Durrës (20).**
- Në vitin 2021, janë raportuar gjithsej 568 shërbime për menaxhimin e rastit ose mesatarisht 9.79 për bashki (N=58). Treguesi ka rritje të lehtë me vitin 2020 ku janë ofruar 501 shërbime. **Bashkia Kavajë raporton numrin më të madh 130 shërbime pasuar nga Bashkia Elbasan me 85.**

Grafiku 68: Numri i shërbimeve sipas menaxhimit të rasteve, 2021



- Në 2021 janë raportuar 537 kopshte dhe çerdhe që kanë marrë shërbime për mirëmbajtje dhe rindërtim nga bashkitë (N=54) ose mesatarisht 9.94 për bashki. **Treguesi ka rënie nga viti 2020 me një total prej 732 dhe nga viti 2019 me 1,032 kopshte dhe çerdhe.**
- Vetëm 6.95% e buxhetit të bashkive (N=55) është alokuar në vitin 2021 për çështje të mbrojtjes së viktimave nga dhuna në familje. **31% e bashkive raportuese kanë akorduar 0% buxhet për çështje të mbrojtjes së dhunës në familje ndërkohë që 6 bashki nuk japin asnjë të dhënë. Fondi ka pësuar rënie të lehtë nga viti 2020 ku është alokuar 7.24% e buxhetit.**
- **Janë ndërmarrë në total 352 aktivitete për promovimin e barazisë gjinore dhe në zbatim të Kartës Evropiane për barazinë gjinore ose mesatarisht 5.87 aktivitete për Bashki (N=60). Treguesi shënon rritje nga viti 2020 ku janë realizuar 231 aktivitete dhe nga 2019 me 198 aktivitete. Numrin më të madh të aktiviteteve e raporton Bashkia Kukës me 42 ndërkohë që Bashkia Memaliaj nuk jep asnjë të dhënë.**

Grafiku 69: Aktivitete promovimi per barazinë gjinore, 2017-2021



### Problemet dhe sfidat

- Kapacitetet e ulëta të nëpunësve vendorë dhe personelit të qendrave komunitare për përballimin e shërbimeve dhe menaxhimin e të gjitha rasteve.
- Mungesë koordinimi ndër-institucional dhe funksionimi jo efektiv i mekanizmave në nivel vendor në kuadër të harmonizimit të masave për të luftuar dhunën në familje.
- Buxheti i Bashkive i alokuar për çështje të mbrojtjes së viktimave nga dhuna në familje është në nivele tejet të ulëta.
- Mospërdorimi i plotë i sistemit REV-ALB nga të gjitha bashkitë dhe mungesa e raportimit të rregullt në MSHMS.
- Aktivitetet e promovimit të barazisë gjinore me mbështetjen dhe në koordinim me OSHC nuk janë ndërmarrë nga të gjitha bashkitë.

### Rekomandime

- Duhet të rritet asistenca teknike dhe financiare ndaj bashkive në drejtim të caktimit të buxhetit të dedikuar për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe e bashkive që kanë hartuar PBA me ndjeshmëri gjinore.
- Duhet të përmirësohet ndërveprimi midis bashkive dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuere (në zonat urbane dhe rurale) për mbrojtjen nga çdo formë diskriminimi, për çështje të barazisë gjinore, për mbrojtjen e komuniteteve rome dhe egjiptiane, si dhe për njohjen e të drejtave të minoriteteve dhe të drejtave të njeriut.
- Duhet të ofrohen shërbime të specializuara dhe riintegruese për viktimat dhe duhet të forcohet më tej puna në menaxhimin e rasteve


**Objekivi specifik: Zbatimi efektiv i ligjit 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesin e personave me aftësi të kufizuara"**

- Në vitin 2021 janë realizuar në total 125 aktivitete ndërgjegjësimi dhe trajnime mbi standartet e aksesueshmërisë nga personat me aftësi të kufizuara (PAK) ose mesatarisht 2.16 për bashki (N=58). **Numri është pothuaj në të njëjtin nivel me vitin 2020. Nga bashkitë raportuese 33% e tyre (19 Bashki) nuk**

kanë ndërmarrë asnjë aktivitet ndërgjegjësimi. Numrin më të madh të aktiviteteve dhe trajnimeve e ka Bashkia Lushnjë me 10, Bashkia Tiranë me 8 dhe Maliq me 7<sup>121</sup>.


- Në 2021, është raportuar ngritja e Njesisë për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit në 20 Bashki (N=57). **Përgatitja e Planit Lokal të Veprimit për Përfshirjen Sociale të PAK është realizuar nga 50 % e bashkive** (31 Bashki) me një rritje nga 26 bashki në 2020.
- Në 2021 është raportuar **8.24 % rritja e fondit të buxhetit lokal për heqjen e pengesave mjedisore dhe infrastrukturore të PAK** (N=50). **Rritja e fondit është në të njëjtat nivele me vitin 2020.**

Grafiku 70: Aktivitete ndërgjegjësimi dhe trajnime mbi standartet e aksesueshmërisë nga personat me aftësi të kufizuara (PAK), 2021




- Mesatarisht 33.09 % e shkollave të sistemit para-universitar kanë infrastrukturë të aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe (N=55), duke mbetur në të njëjtat nivele me vitin 2020. **Bashkitë Mat, Tiranë, Roskovec, Kamëz raportojnë 100% infrastrukturë të aksesueshme nga PAK, ndërkohë që 18% e bashkive kanë raportuar zero përqind** (10 bashki).

Grafiku 71: Numri i shkollave të aksesueshme për fëmijët me aftësi ndryshe, 2021




<sup>121</sup> Bashkitë Vorë, Skrapar dhe Memaliaj nuk kanë dhënë asnjë informacion

Grafiku 72 : Shkalla e aksesueshmërisë së infrastrukturës shkollore nga fëmijë me aftësi ndryshe 2017-2021



- Në 2021, vlera mesatare e raportit të institucioneve publike të aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe kundrejt numrit total të institucioneve në nivel vendor ka qenë 36.9 % (N=54); treguesi mbetet në të njëjtat nivele me vitin 2020. **Rreth 15 % e bashkive kanë raportuar zero përqind infrastrukturë publike të aksesueshme**<sup>122</sup>. Bashkitë Kamëz dhe Roskovec kanë raportuar 100% infrastruktura të institucioneve publike të aksesueshme nga PAK.

Grafiku 73: Shkalla e institucioneve publike të aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe, 2021




- Në 2021 janë raportuar 264 nëpunës vendorë të punësuar në strukturat e përkrahjes dhe mbrojtjes sociale për PAK, ose measatarisht 4.4 nëpunës për bashki (N=60), me një rritje të lehtë krahasuar me 240 nëpunës në 2020. **Bashkitë Belsh dhe Fushë-Arrëz nuk kanë asnjë punonjës për PAK ndërkohë që Bashkia Memaliaj nuk ka ofruar të dhëna për treguesin.**

<sup>122</sup> Bashkitë Dibër, Cërrik, Durrës, Memaliaj, Polican, Shijak dhe Vorë nuk kanë dhënë informacion




Grafiku 74: Nëpunës vendor për çështje të personave me aftësi ndryshe, 2021



- Rreth 26.27 % është mesatarja e infrastrukturës rrugore e aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe në raport me gjatësinë e rrjetit urban në territorin e bashkisë (N=55). Treguesi shënon rënie me -2.5 p.p. krahasuar me 2020 ku është raportuar 28.8%. **Bashkitë Mat dhe Roskovec raportojnë se 100% e rrugëve urbane janë të aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe.** Ndërkohë që 22% e bashkive raportojnë 0 % infrastrukturë rrugore të aksesueshme.

Grafiku 75: Shkalla e rrjetit urban e aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe, 2021



- Në 2021 numri i qendrave historike dhe kulturore në territorin e Bashkisë të pajisura me infrastrukturën e duhur për personat me aftësi ndryshe është raportuar në total 86 (N=56).** Rreth 38% e bashkive (23 bashki) kanë raportuar se nuk kanë infrastrukturën e duhur dhe 6 bashki<sup>123</sup> nuk kanë dhënë asnjë informacion.

**Problemet dhe sfidat** .....

- Mungesë e burimeve të mjaftueshme njerëzore për të mbuluar nevojat e këtij grupi të synuar në nivelin vendor.
- Mbeten sfida zhvillimi i një databaze në nivel kombëtar për grumbullimin e të dhënave për personat me aftësi ndryshe.
- Rritja e nivelit të aksesueshmërisë në shkolla, institucione publike dhe shërbime të ndryshme, përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe objekteve kulturore.
- Mungesa e instrumentave dhe mundësive për punësim në përputhje me nevojat dhe aftësitë për punë të PAK me qëllim rritjen e punësimit të tyre.

<sup>123</sup> Divjakë, Mallkastër, Memaliaj, Shijak, Tepelenë, Vlorë

- Në institucionet bazë mungon aksesimi për personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të marrin edhe ata shërbimin e duhur në kohë dhe me cilësi.

### Rekomandime .....

- Rekomandohet ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve referuese, vlerësuese dhe monitoruese dhe koordinimi ndërinstytucional i reformës së sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.
- Forcimi i bashkëpunimit me strukturat e arsimit, formimit profesional, punësimit si dhe me shërbimet shëndetësore, psiko-sociale, integruese, rehabilituese, etj. për të krijuar një rrjet mbështetjeje për personat me aftësi të kufizuara.
- Bashkëpunimi me organizatat që ofrojnë shërbime psiko-sociale për individët pranë këtyre organizatave, shkëmbimin e informacionit lidhur me vlerësimin, si edhe marrjen e informacionit nga këto ofrues shërbimesh për përfituesit.
- Ngritja e kapaciteteve për personelin përgjegjës vendor për përdorimin e sistemit të integruar të informacionit dhe asistimin e NJQV nga Shërbimi Social Shtetëror.
- Përmirësimi i koordinimit midis aktorëve të ndryshëm në nivel lokal dhe qendror si dhe monitorimi periodik i shërbimeve të përkujdesit shoqëror që ofrohen për kategoritë në nevojë.
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në mënyrë që të lehtësohet aksesimi i Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe i infrastrukturës shkollore që përmbush standardet për fëmijët me aftësi të kufizuara.

## PËRFUNDIME MBI GJYQËSORIN DHE TË DREJTAT THEMELORE

Progres është shënuar në hartimin e një kuadri strategjik dhe ligjor që garanton të drejtat themelore të harmonizuar me standartet e BE-se dhe Konventat Ndërkombëtare. Çështjet e fëmijëve, pakicave etnike, të barazisë gjinore dhe personave me aftësi të kufizuara kanë qënë në fokus të politikave në nivel qendror dhe vendor.

Edhe në vitin 2021 kanë vazhduar përpjekjet e bashkive për të ngritur Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve si dhe për të krijuar sistemin për monitorimin e rasteve për shkelje të të drejtave të fëmijës. Sfidë mbeten kapacitetet njëzore të pamjaftueshme për të menaxhuar rastet si dhe burimet financiare shumë të limituara. Në 2021 bashkitë kanë alokuar mesatarisht 5.2% të buxhetit për rastet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Megjithëse treguesi ka pësuar rritje nga vitet e kaluara ai sërish mbetet në nivele të ulëta në krahasim me nevojat e bashkive për të trajtuar të gjitha rastet.

Përsa i përket zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi, progres është shënuar me hartimin e "Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI+, 2021 - 2027". Megjithatë roli i bashkive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komunitetit LGBTI+ në nivel vendor si dhe bashkëpunimi me Organizatat e Shoqërisë Civile mbetet ende i kufizuar.

Progres është shënuar në rritjen e raportimeve për rastet e dhunës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përmes sistemit REV-ALB. Gjithashtu ka vijuar me ritme të kënaqshme krijimi dhe funksionimi i Njësive së Barazisë Gjinore si dhe emërimi i nëpunësve vendor në kapacitetin e koordinatorit lokal për çështjet gjinore. Buxhetimi me bazë gjinore i politikave vendore mbetet ende larg standarteve ndërkombëtare për politika me ndjeshmëri gjinore.

Nuk ka progres në rritjen e aksesit të personave më Aftësi të Kufizuara në infrastrukturën bashkiake dhe në institucionet publike. Sërish numri i shkollave të sistemit para-universitar që kanë infrastrukturë të aksesueshme nga personat me aftësi ndryshe mbetet i ulët. E njëjta situatë problematike paraqitet në sigurimin e infrastrukturës së aksesueshme nga personat PAK në qendrat historike dhe kulturore në disa Bashki.

### 3.9 KAPITULLI 24: DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA

“Shqipëria ka miratuar një strategji të re kundër krimeve të organizuara dhe të rënda për 2021-2025 dhe planin e saj të veprimit për 2021-2022<sup>124</sup>. Gjithashtu është miratuar një Plan Veprimi për Parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale për kultivimin e bimëve narkotike për vitin 2021<sup>125</sup>. Sa i përket **migracionit**, kuadri ligjor për migracionin është kryesisht i përafër me acquis të BE së, por ka nevojë të përditësohet në përputhje me zhvillimet e fundit”<sup>126</sup>

Gjatë vitit 2021 në Këshillin Konsultativ (KK) për vetëqeverisjen vendore është paraqitur për diskutim projektligji “Për policinë bashkiake”. Ky projektligj ka për qëllim të rregullojë misionin, organizimin, funksionimin, kompetencat e Policisë Bashkiake dhe marrëdhëniet e punës të punonjësit të policisë bashkiake në Republikën e Shqipërisë. “Masat kyçe do të lidhen me rishikimin e ligjit për Policinë Bashkiake, i cili do të mundësojë kërkesa dhe standarde më të larta për këto struktura në funksion të sigurisë publike, si dhe përmirësimin e kuadrit rregullator dhe fuqizimin e bashkëpunimit të strukturave të Policisë Bashkiake me strukturat e Policisë së Shtetit”.



*Objektivi specifik: Avancimi i luftës kundër krimit të organizuar*

- Në 2021 grupi i punës për zbatimin e Planit të Veprimit për luftën kundër krimit të organizuar në nivel vendor është krijuar në 48% të bashkive (N=55); treguesi nuk ka rritje krahasuar me vitin 2020. Gjithashtu nuk është bërë progres lidhur me hartimin e Strategjisë për Sigurinë Publike në nivel vendor duke mbetur në të njëjtin nivel me 2020 në vetëm 38 Bashki ose rreth 62% (N=55).

*Grafiku 76: Grupi i punës në Bashki për zbatimin e*

*Planit të Veprimit për Luftën kundër Krimit të Organizuar*

*Grafiku 77: Strategjia për sigurinë publike në bashki*



<sup>124</sup> Strategjia Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2022, miratuar me VKM nr. 1140, datë 24.12.2020



<sup>125</sup> Plani i Veprimit i DPPSH nr. 142, datë 05.02.2021, “Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike, për vitin 2021”.

<sup>126</sup> Raport i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)



Harta 26: Këshilli i Sigurisë Vendore kundër krimit të organizuar 2021

Grafiku 78: Ngritja e Këshillave të Sigurisë Vendore 2017-2021



### Problemet dhe sfidat

- Mungesa e Strategjive të Sigurisë Publike për një pjesë të bashkive ka krijuar sfida në menaxhimin e situatës.
- Mosngritja dhe funksionimi i plotë i Këshillave të Sigurisë Vendore në të gjitha bashkitë e vendit.
- Mbetet sfidë krijimi i grupit të punës në luftën kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimi me strukturat e Policisë së Shtetit.
- Bashkëpunimi i ulët me autoritetet e tjera publike dhe mungesa e fushatave ndërgjegjëse në komunitet.
- Sfidë është ngritja dhe funksionimi i zyrës së policimit në komunitet dhe kryesisht në Njësitë Administrative dhe në zonat rurale.
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve për të referuar cdo rast është ëë nivele të ulëta.
- Mbetet sfidë krijimi i një databaze për të mbajtur të dhënat e sakta për numrin e rasteve.

### Rekomandime

- Ngritja e Zyrës së Policimit në komunitet në të gjitha bashkitë dhe në secilën njësi administrative.
- Hartimi dhe miratimi i Strategjive të Sigurisë Publike vendore dhe Ngritja e Këshillave të Sigurisë Publike nga të gjitha bashkitë.

- Funksionimi i plotë i shërbimit të policimit në komunitet. Forcimi i bashkëpunimit për menaxhimin e rasteve me të gjithë partnerët e përfshirë në proces.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel qendror me ministrinë e linjës dhe në nivel lokal nëpërmjet KVSP-ve për vlerësimin e riskut dhe dëmit dhe marrja e masave parandaluese në lidhje me çështje të sigurisë.

## PËRFUNDIME MBI DREJTËSINË LIRINË DHE SIGURINË

**Strategjia Kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda, 2021-2025 dhe Plani i Veprimit 2021-2022 kanë shtuar sfidat e pushtetit vendor për luftën ndaj krimin dhe rritjen e sigurisë në komunitet.** Qasja e re për sigurinë është reflektuar në Strategjinë Ndër-sektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026, e cila synon përmirësimin e parametrevave të sigurisë në komunitet duke rritur ndërveprimin e strukturave policore me komunitetin, përmes metodave proaktive për parandalimin dhe zbulimin e veprave penale. Strategjia bazohet në rritjen e bashkëpunimit me aktorët institucionale qendrore dhe vendore, qytetarët dhe komunitetin, institucionet e tjera jo qeveritare, bizneset, institucionet fetare, media etj, për të krijuar një kulturë të re të sigurisë publike gjithëpërfshirëse.<sup>127</sup>

**Ngritja dhe funksionimi i strukturave të parashikuara në Strategji si dhe në kuadrin ligjor në nivel vendor ka vazhduar me ritme të moderuara.** Grupi i punës për zbatimin e Planit të Veprimit për luftën kundër krimin të organizuar dhe Këshilli i Sigurisë Vendore, një mekanizëm në luftën kundër krimin të organizuar, është ngritur në pjesën më të madhe të Bashkive. **Hartimi dhe miratimi i Strategjisë për Sigurinë Publike në nivel vendor mbetet në të njëjtat nivele me vitin 2020.**

**Prioritet mbetet krijimi i besueshmërisë dhe rritja e sigurisë së komunitetit përmes policimit në komunitet. Në 2021 ngritja e Zyrës së Policimit në komunitet në secilën njësi administrative ka vijuar me ritme të ulëta.** Disa nga prioritetet e identifikuar nga Policia e Shtetit në raportin e monitorimit të vitit 2021 të Ministrisë së Brendshme janë: (i) Identifikimi i zonave me risk të lartë dhe prioritare, dhe angazhimi me projekte pilot për policimin në komunitet. (ii) Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të policimit në komunitet dhe të pikave kufitare rreth tendencave të radikalizimit, metodave të rekrutimit, radikalizimit në internet dhe mekanizmave të referimit të problematikës; (iii) Kryerja e fushatave ndërgjegjësuese të policisë në zonat me rrezik të lartë për të promovuar policimin në komunitet dhe rolet e tyre për komunitetin (e parë kjo në këndvështrimin gjinor).

## 3.10 KAPITULLI 26: ARSIMI DHE KULTURA

“Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e arsimit dhe kulturës. Njëfarë progresi u regjistrua me forcimin e Agjencisë së re Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë, ristrukturimin e vazhdueshëm të Agjencisë Kombëtare të Arsimit. Janë marrë masa të veçanta për përshtatjen e shpejtë me një model edukimi në distancë të imponuar nga pandemia COVID-19. Për shkak të kufizimeve të burimeve financiare dhe kapaciteteve, cilësia e arsimit mbetet një problem në të gjithë vendin, veçanërisht i pamjaftueshëm në zonat rurale dhe të izoluar ku mjediset e shkollës, shpesh në kushte të këqija, përdoren si për edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme dhe arsimin fillor, dhe është e vështirë për të tërhequr mësues të kualifikuar. Është bërë disa progres në zbatimin e strategjisë për kulturën 2019-2025, por duhet bërë përpjekje për të përfunduar miratimin e legjislacionit zbatues për Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë<sup>128</sup>”.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 22.10.2021 është miratuar Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe plani i veprimit për zbatimin e saj. Vizioni i strategjisë është: “Sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimit gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë

<sup>127</sup> Raporti monitorimit-tuor 2021, Ministria e Brendshme

<sup>128</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian”.


Në kuadër të procesit të decentralizimit të kompetencave të pushtetit qendror tek ai vendor, **arsimi parashkollor është ndër funksionet e fundit të decentralizuara**. Bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, **administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe janë funksione të bashkisë**.

**Funksionet e bashkive në fushën e kulturës**, referuar pikës 1 dhe 2 të nenit 25 të ligjit nr. 139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore janë të lidhura kryesisht me: (i) Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve; (ii) Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

*Objekti i specifik: Rritja e pjesëmarrjes në klasa përgatitore për arsimin parashkollor*

- Në vitin 2021, kanë funksionuar 1683 kopshte në total, ose mesatarisht 27.59 kopshte (N=61). Treguesi është pothuaj në të njëjtin nivel me 2020 ku janë raportuar 1658 kopshte. **Numrin më të madh e kanë bashkia Elbasan me 107 kopshte, bashkia Lushnjë me 75, dhe Fier me 73 kopshte.**

Grafiku 79: Numri i kopshteve sipas NJVV, 2021




- Në 2021 raportohet se vetëm 8.3 % e kopshteve janë mbi kapacitetet e lejuara (mbipopullim), në të njëjtat nivele me vitin 2020 (N=57). **Përqindjen më të lartë të mbipopullimit e raportojnë Bashkia Këlcyrë e Polican me 100% dhe Bulqizë me 93.75%**
- Ndërkohë 27.37 % e kopshteve janë me numër fëmijësh nën kapacitetet e lejuara sipas raportimeve të Bashkive në vitin 2021 (N=59). Në vitin 2020 treguesi ka qënë në nivelin 23.61%. **Bashkia Dibër ka numrin më të madh të kopshteve nën kapacitet me 87.43%.**
- Në 2021 raportohet se bashkitë kanë ndërmarrë **151 fushata ndërgjegjësimi** ndaj prindërve për përfshirjen e fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor ose mesatarisht 2.7 për bashki (N=56). **Numrin më të madh e ka Bashkia Gjirokastrë me 20 fushata, Bashkia Berat 12 dhe Cërrik me 10 fushata.** Treguesi ka ulje nga viti 2020 ku janë ndërmarrë 223 fushata.
- Në 2021 fondi i alokuar nga buxheti vendor për rindërtimin e kopshteve ekzistuese ose ndërtimin e kopshteve të reja është 2.7 % (N=54)** me një rritje fare të lehtë nga viti 2020. Rreth 54% e bashkive (33 bashki) kanë raportuar zero përqind fond të alokuar në buxhetin e tyre ndërkohë që 7 bashki nuk japin asnjë informacion<sup>129</sup>. Treguesi ka ulje me fondin vendor të planifikuar në 2019 ka qënë më vlerë mesatare 6.73% por edhe me 2018 (2.9%).

<sup>129</sup> Bashkitë Dibër, Elbasan, Mallakastër, Polican, Shijak, Vlorë, Vorë nuk raportojnë të dhena

- Në 2021, numri i fëmijëve në Bashki të grup moshës të arsimit bazë ( të detyrueshëm) që i përkasin grupeve të marxhinalizuara është raportuar në total 15, 610 ose mesatarisht 346.89 fëmijë për Bashki (N=45). Numri ka rritje me 30% krahasuar me vitin 2020 ku raportuar 12,161 fëmijë të grupeve të marxhinalizuara në bashki. Numrin më të madh e ka Bashkia Tiranë me 2445 dhe Bashkia Elbasan me 2059 fëmijë.

Grafiku 80: Numri i fëmijëve në Bashki të arsimit bazë që i përkasin grupeve të marxhinalizuara, 2021



Objektivi specifik: rritja e pjesëmarrjes në institucionet e arsimit të detyrueshëm për fëmijët e grupeve të marxhinalizuara

- Parashikimi i infrastrukturës PAK** në projektet për rindërtimin/ndërtimin e shkollave në bashki në vitin 2021 është bërë nga 78% e bashkive (N=58); Janë 10 bashki që nuk kanë parashikuar infrastrukturën për PAK dhe 3 bashki që nuk raportojnë asnjë të dhënë<sup>130</sup>. Treguesi është në të njëjtin nivel me vitin 2020.
- Mesatarisht është alokuar 3.11 % e **fondit të investimit vendor për ndërtimin e shkollave të reja dhe rikonstruksionin e shkollave** ekzistuese në raport me buxhetin vendor të miratuar në vitin 2021. Treguesi shënon ulje nga viti 2020 me 5.64% dhe nga 2019 ku fondi i parashikuar për rindërtimin e shkollave ekzistuese ose ndërtimin e shkollave të reja ka qënë mesatarisht 7.55%.

Objektivit specifik: Përmirësimi i proçesit të vendimarrjes në shkollat e arsimit parauniversitar

- 90% e bashkive kanë përfaqësimin e nëpunësit të bashkisë në bordin e shkollës në vitin 2021 duke pësuar ulje nga viti 2020 me 95%. Nuk ka të dhëna të vlefshme për treguesin “nisma të bashkisë për të mbështetur ngritjen e komunikimit shkollë-prindër-qeveri” ashtu si edhe në vitin 2020.

### Problemet dhe sfidat .....

- Vazhdon të mbetet sfidë buxheti i ulët i bashkive për ndërtimin dhe rikonstruksionin e ndërtesave të kopshteve dhe shkollat e arsimit parauniversitar.
- Mbipopullimi i kopshteve mbetet problematikë për disa bashki dhe pamundësia për ti plotësuar nevojat e të gjithë komunitetit për regjistrimin e fëmijëve.
- Vështirësia për të regjistruar në arsimin parashkollor vecanërisht fëmijë të komunitetit Rom dhe Egjiptian si prioritet për integrimin e këtyre komuniteteve në arsim.

<sup>130</sup> Bashkia Shijak, Konispol, Elbasan nuk raportojnë të dhëna



- Mungesa e infrastrukturës për sigurimin e aksesit të Personave me Aftësi të Kufizuar në disa institucione arsimore.
- Sfidë mbetet parashikimi në buxhet dhe aplikimi në thirrjet për projekte të financuara nga BE dhe donatorë të tjerë apo gjetja e burimeve alternative të financimit për bashkë-financime për projektet e shkollave.
- Rritja e ndërgjegjësimit të prindërve dhe fëmijëve për vendimmarrje.

### Rekomandime .....

- Përmirësimi i infrastrukturës së shkollave duke planifikuar dhe akorduar më shumë buxhet për këtë qëllim.
- Bashkitë duhet të ndërmarrin nisma për të rritur vetëdijësimin shoqëror dhe gjetja e mekanizmave vendorë për të ndërtuar kanale komunikimi ndërmjet prindërve, mësuesve dhe bashkisë në mënyrë që të rriten njohuritë për arsimin, si dhe ngritja e zërit për shqetësime të ndryshme.
- Rritja e kapaciteteve të administratës vendore për monitorimin dhe raportimin vjetor mbi përgjegjësitë dhe detyrat e NJQV në mirëadministrimin e kopshteve dhe shkollave si dhe bërja publike e raporteve të monitorimit në faqen zyrtare të bashkisë.
- Krijimi i lehtësirave dhe mekanizmave për sigurimin e infrastrukturës së duhur në shkolla për fëmijët PAK si dhe grupeve të tjera të marginalizuara.

*Objekti i specifik: Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jo-materiale, thesari kombëtar i gjenerimit të popullit shqiptar*

- Në 2021, **rastet e shkeljeve dhe ndërtimeve të paligjshme në zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore janë raportuar në total 12 (N=55) nga katër Bashki: Himara dhe Kruja nga 4 raste, Gjirokastrë 3 dhe Finiq 1 rast.** Ndërkohë 51 bashki ose 83% raportojnë 0 raste shkeljesh ndërsa 6 bashki nuk japin të dhëna<sup>131</sup>. Treguesi shënon ulje nga viti 2020 me gjithsej 35 raste.
- **Në vitin 2021, janë ndërmarrë gjithsej 855 masa kundër shkeljeve (N=55) dhe masa të tjera për ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore (nga 106 masa në vitin 2020).** Numrin më të madh të masave e raporton Bashkia Tiranë me 840 masa megjithëse raporton 0 raste shkeljesh. Bashkitë më sipër Himarë, Krujë, Gjirokastrë dhe Finiq raportojnë numrin e masave të njëjtë me atë të shkeljeve.


*Objekti i specifik: Mbështetja e krijimtarisë dhe veprimtarisë krijuese të artistëve shqiptarë përmes forcimit të veprimtarisë kulturore dhe përfshirjes së artistëve*

- Në vitin 2021, numri i aktiviteteve kulturore të miratuar nga bashkia për promovimin e kulturës së zonës dhe kulturës kombëtare është në total 979 ose mesatarisht 16.32 (N=60). Numri ka rritje të paktë nga viti 2020 me vetëm 36 aktivitete më shumë të miratuara. **Tirana ka numrin më të madh të projekteve kulturore të miratuara 123, ndërsa bashkia Vorë nuk ka raportuar për këtë tregues.**
- **Numri i aktiviteteve të realizuara është 770 ose mesatarisht 12.83** aktivitete për bashki (N=60). Numri vjen në rritje krahasuar me vitin 2020 ku u organizuan 729 aktivitete kulturore, ndërsa në vitin 2019 janë raportuar 807 në total. **Numrin më të madh të aktiviteteve e ka realizuar Bashkia Shkodër me 74 nga 62 të planifikuara. Ndërsa Bashkia Tiranë ka realizuar vetëm 20 nga 123 të planifikuara**<sup>132</sup>. Aktivitetet në rritje janë mundësuar edhe nga lehtësimi i masave për shkak të përmirësimit të situatës së pandemisë COVID 19. Bashkia Vorë nuk ka raportuar për këtë tregues.
- **Fondi vendor i miratuar për aktivitete kulturore të bashkisë në raport me buxhetin për trashëgiminë kulturore në 2021 është raportuar 7.64 % (N=55).** Buxheti për aktivitete kulturore ka ardhur në rritje nga viti 2020 ku është raportuar 5.56%.

<sup>131</sup> Bashkitë Vlorë, Vorë, Shijak, Cërrik, Durrës, Lezhë nuk japin të dhëna

<sup>132</sup> Bashkia Tiranë raporton se për shkak të pandemisë shumë projekte janë shtyrë duke pasur të nevojshme përsëritjen e procedurës

Grafiku 81: Aktivitete kulturore të organizuara nga NJQV, 2021



### Problemet dhe sfidat

- Sfidë kryesore është alokimi i fondeve për të zhvilluar më shumë aktivitete promovuese kulturore pasi buxheti i bashkive është shumë i limituar.
- Mungesë bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës dhe institucionet e tjera qendrore për të ruajtur dhe trashëguar traditat kulturore si këngët folklorike, veshjet e punimet artizanale të krahinave.
- Bashkëpunim i ulët me komunitetin. Banorët gjenden midis nevojës për përmirësim të kushteve të jetesës dhe kërkesës për ruajtjen e autenticitetit të trashëgimisë së tyre kulturore.
- Mundësi të ulëta financiare për të promovuar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar trashëgiminë kulturore, organizimin e festivaleve të për vitshme, ruajtja e muzikës folklorike; Gjithashtu shtimi i aktiviteteve mbështetëse dhe promovuese për librin dhe lexuesit e tij mbetet sfidë.
- Rritja e bashkëpunimit me institucione të tjera publike dhe private, sipërmarrës si dhe me artistë të rinj për të ndikuar në ide të reja rreth zhvillimit të aktiviteteve kulturore për promovimin e zonës.

### Rekomandime:

- Forcimi i bashkëveprimit dhe koordinimit midis administratës vendore dhe strukturave të policisë së shtetit për të parandaluar shkeljet e paligjshme dhe dëmtimin e trashëgimisë kulturore.
- Hartimi i planeve të menaxhimit të pasurive kulturore përmes evidentimi të detajuar të llojit dhe rëndësisë së objektit me vlera të trashëgimisë kulturore.
- Përgatitja e analizës së kostove për mirëmbajtjen e objekteve kulturore dhe parashikimi i tyre në Programin Buxhetor afatmesëm të bashkisë sipas prioriteteve dhe rëndësisë së ndërhyrjes.
- Ndërmarrja e veprimeve dhe politikave nga NJVV -të për të konsideruar kulturën si nxitës për zhvillimin e turizmit.
- Aplikimi i skemave financiare mbështetëse që të mundësojnë ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore që janë në pronësi të qytetarëve.
- Rritja e kapaciteteve njerëzore dhe financiare për zhvillimin e aktiviteteve kulturore të miratuara nga bashkia për promovimin e kulturës së zonës dhe kulturës kombëtare.

## PËRFUNDIME PËR ARSIMIN DHE KULTURËN

**Miratimi i Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj shënon një moment të rëndësishëm për avancimin e reformës në arsim përfshirë dhe arsimin bazë dhe atë parashkollor.** Në kuadër të procesit të decentralizimit të kompetencave të pushtetit qendror tek ai vendor, arsimi parashkollor është ndër funksionet e fundit të decentralizuara drejt njësisive të pushtetit vendor. Bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe janë funksione të bashkisë.

**Sfidë mbetet buxheti i kufizuar i bashkive për të investuar në infrastrukturën e kopshteve dhe shkollave.** Në vitin 2021 fondi i alokuar nga buxheti vendor për rindërtimin e kopshteve ekzistuese ose ndërtimin e kopshteve të reja është ende i ulët dhe i pamjaftueshëm për mbulimin e nevojave për investime.

**Kanë vazhduar përpjekjet e bashkive për të parashikuar infrastrukturën e nevojshme për Personat me Aftësi të Kufizuar** në projektet për rindërtimin dhe ndërtimin e shkollave duke shënuar progres nga viti 2020.

**Roli i Bashkive në ruajtjen dhe promovimin e kulturës dhe trashëgimisë kulturore ka ardhur në rritje.** Me gjithë situatën e vështirë financiare dhe kufizimeve të pandemisë COVID 2019, bashkitë kanë organizuar një numër të konsiderueshëm aktivitetesh kulturore më fondet e tyre. Gjithashtu % e buxhetit të bashkive të akorduara për aktivitete kulturore dhe për promovimin e trashëgimisë kulturore në vitin 2021 ka qënë më e lartë se në vitin 2020.

**Sfidë mbetet ruajtja dhe mirëmbajtja e objekteve të trashëgimisë kulturore.** Rritja e ndërgjegjësimit të banorëve dhe bashkëpunimi i ngushtë me strukturat e policisë dhe institucionet e tjera qendrore për parandalimin dhe dënimin e rasteve të shkeljeve është i një rëndësie të vecantë. Gjatë vitit 2021 rastet e shkeljeve dhe ndërtimeve të paligjshme në zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore kanë ardhur në ulje. Hartimi i planeve për mbrojtjen dhe zhvillimin e objekteve të trashëgimisë kulturore si dhe alokimi i buxheteve për investime dhe mirëmbajtje është një problematikë që kërkon adresimin e duhur dhe të qëndrueshëm.

### 3.11 KAPITULLI 27: MJEDISI DHE NDRYSHIMI I KLIMËS

“Shqipëria tregon një farë niveli përgatitjeje në fushën e mjedisit dhe klimës. Është bërë progres i kufizuar në përafrimin e mëtejshëm të politikave dhe legjislacionit me acquis, në fusha të tilla si menaxhimi i ujit, kimikatet, krimi mjedisor dhe mbrojtja civile. Megjithatë, nevojiten ende përpjekje të konsiderueshme për zbatimin dhe përfundimin, veçanërisht në menaxhimin e mbetjeve, cilësinë e ujit dhe ajrit dhe ndryshimet klimatike. Shqipëria duhet të bëjë më shumë përpjekje për të përafruar me acquis për cilësinë e ajrit, duke përfshirë zgjerimin dhe përmirësimin e sistemit të monitorimit të ajrit.<sup>133</sup>”

Gjatë vitit 2021 në Këshillin Konsultativ të Qeverisë qendrore me atë vendore janë diskutuar projekt aktet e mëposhtme:

Në fushën e Mjedisit:

- Projektvendimi “Për një shtesë në VKM Nr. 687, datë 29.07.2015, Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve së bashku me relacionin shoqërues”.
- Projektvendimi “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve.
- Projektvendimi “Për kriteret e hartimit të planeve të menaxhimit si dhe për përcaktimin e ekosistemeve, habitateve dhe llojeve të faunës së egër me status mbrojtjeje”.
- Projektvendimi “Për miratimin e listës së llojeve të mbrojtura të bimëve/florës dhe kafshëve/faunës së vendit”.

<sup>133</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

- Prezantim i raportit të monitorimit të dokumentit të politikave strategjike dhe planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve 2020-2035.

➔ *Prezantim i akteve nënligjore të ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”:*

- Projektvendimi “Për kriteret dhe procedurat për krijimin e rezervave strategjike të lëndës drusore në këmbë (të paprerë), ruajtjen dhe trajtimin e pyjeve të virgjër ose pothuajse të virgjër si dhe kalimin e tyre në konservim të plotë”.
- Projektvendimi “Për kriteret e ushtrimit, të miratimit dhe të monitorimit të veprimtarive kërkimore-shkencore në Fondin Pyjor Kombëtar”.
- Projektvendimi “Për strukturën e regjistrimit kombëtar të fondit pyjor, kriteret teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mbajtja e të dhënave, informacioni që regjistrohet dhe raportimi nga administratorët/pronarët e pyjeve”.
- Projektvendimi “Për miratimin e kostove të përlllogaritura për pyllëzim kompensues në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor”.

*Objekti specifik: Rritja e ndërgjegjësimit dhe ngritja e kapaciteteve të qeverive vendore për rolin e tyre në mbrojtjen e mjedisit, natyrës dhe menaxhimin të pyjeve*


Përgjegjësitë e NJQV në fushën e mbrojtjes së mjedisit lidhen me sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja, sigurimin e masave për mbrojtjen nga ndotja akustike, dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese mbi mbrojtjen e mjedisit.

- Në 2021, janë **trajnuar gjithsej 142 nëpunës vendorë** mbi legjislacionin dhe zbatimin e masave të politikave qëndrore në fushën e mjedisit, ose mesatarisht 2.5 nëpunës të trajnuar për bashki (N=57); *treguesi ka rritje nga viti 2020 ku janë raportuar 90 nëpunës të trajnuar.* Numrin më të madh e ka Bashkia Vlorë me 50 nëpunës të trajnuar ndërkohë që 23% e Bashkive nuk kanë asnjë punonjës të trajnuar. **Bashkitë Çërrik, Devoll, Divjakë dhe Vorë nuk kanë dhënë informacion.**
- Bashkitë kanë **organizuar 364 fushata ndërgjegjësimi në vitin 2021 në mbrojtje të mjedisit dhe minimizimin e ndotjes në bashkëveprim me aktorë të tjerë vendorë dhe OSHC (N=57).** Treguesi ka rritje me 40% krahasuar me fushatat në vitin 2020. **Numrin më të madh e ka Bashkia Krujë me 55 fushata dhe Bashkia Belsh me 36. Bashkia Durrës nuk ka ofruar të dhëna.**

*Objekti specifik: Edukimi i gjeneratave të reja për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes*

- Në 2021 janë **organizuar 288 fushata ndërgjegjësimi në shkolla të mesme dhe 9-vjeçare për ruajtjen e mjedisit dhe minimizimin e ndotjes ose mesatarisht 4.8 për bashki (N=60).** **Numrin më të madh e ka bashkia Selenicë me 36 fushata të organizuara. Bashkia Durrës nuk ka ofruar të dhëna.** *Treguesi ka rritje nga viti 2020 me gjithsej 167 fushata ndërgjegjësimi të organizuara.*

Grafiku 82: Fushata ndërgjegjësimi për ruajtjen e mjedisit në shkolla, 2021






- Miratimi sa më shpejt i Planeve Vendore të Veprimit për përmirësimin e cilësinë e ajrit nga Bashkitë që nuk e kanë miratuar dhe integrimi i masave në programet buxhetore.
- Shtimi i numrit të nëpunësve vendorë që kanë si funksion mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e ajrit dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, në disa bashki.
- Bashkëpunimi më i mirë me projektet e financuara nga BE dhe donatorë të tjerë në fushën e mjedisit dhe sigurimi i trajnimeve për nëpunësit në fushën e mjedisit dhe standarteve evropiane.
- Vazhdimi i programeve për edukimin qytetar, edukimi i të rinjve në shkolla dhe rritja e bashkëveprimit më aktorë të tjerë në nivel vendor dhe organizatat e shoqërisë civile.

*Objektivi specifik: Përmirësimi i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve*


- Në 2021 raportohet se 78.6% e bashkive ose 48 Bashki (N=61) kanë raportuar se **mbledhja e mbetjeve dhe depozitimi i tyre në landfill dhe fushat e depozitimit të miratuara** është kryer sipas planit vendor të menaxhimit të mbetjeve. Treguesi shënon rritje vetëm me 7 Bashki nga 2020.
- Mbetjet e riciklueshme depozitohen sipas objektivave të planit vendor për menaxhimin e mbetjeve (PVMIM) nga vetëm 19.7% e bashkive në vitin 2021 me një rënie -1.6 p.p. krahasuar me vitin 2020.
- Në 2021 janë raportuar 79 vend-depozitime të paautorizuara nga 83 në vitin 2020. Bashkitë e tjera (72%) kanë raportuar zero vend-depozitime të pa-autorizuara (N=55). **Ashtu si edhe në vitin 2020 numrin më të madh me gati 50% të totalit e ka Bashkia Kukës me 41 vend-depozitime jashtë standardeve.**

Grafiku 82: Vend-depozitime të mbetjeve të paautorizuara sipas NJQV, 2021



- 64 vend-depozitime të autorizuara janë përdorur nga bashkitë për depozitimin e mbetjeve në 2021 (N=60) ose mesatarisht 1 vend-depozitim për bashki. Numrin më të madh e kanë Bashkia Lushnjë dhe Bulqizë me 4. **Bashkia Vorë nuk ka raportuar për këtë tregues.**

Grafiku 83: Vend-depozitime të autorizuara, 2021



- Në 2021 ndarja e mbetjeve në burim në 2 koha sipas legjislacionit bëhet vetëm nga 8 Bashki duke mbetur në të njëjtat nivele më vitin 2020. **Bashkitë Cërrik, Durrës dhe Vorë nuk ka dhënë informacion (N=50).**
- Largësia mesatare e qendrës së Bashkisë nga vend-depozimi i miratuar është 31.32 km** duke shënuar progres nga viti 2020 me 21.41 dhe 17.97 km në vitin 2019 dhe 2018.

Gjirokastra ka raportuar 600 km në 2020 ka vene 4km A ka kuptim se rrit mesataren e distancës.?

Mat 100 Km. Fushë Arrez 90 km vjet ka vene 4 km


### Problemet dhe sfidat .....

- Sfidë mbetet fuqizimi i kapaciteteve të bashkive në përputhje dhe me metodologjitë e reja dhe rritja e pjesëmarrjes në trajnime mbi përparësitë e fushës së menaxhimit të mbetjeve dhe legjislacioni të BE.
- Grumbullimi i seleksionuar i rrjedhave të mbetjeve dhe instrumentet ekonomike për të nxitur riciklimin dhe ripërdorimin dhe për të parandaluar gjenerimin e mbetjeve mbeten të kufizuara<sup>137</sup>.
- Përmirësimi i sistemit të monitorimit nga ana e bashkive dhe rritja e cilësisë së ofrimit të shërbimeve nga operatorët privatë për menaxhimin e mbetjeve.
- Mbyllja e një numri të madh vend-depozitimeve të papërshtatshme dhe të pautorizuara mbetet sfidë.
- Pamundësia e bashkive për të realizuar ndarjen në burim të mbetjeve për shkak të kostos së lartë dhe mungesës së pajisjeve të duhura. Niveli i ulët i ndërgjegjësimit dhe edukimit qytetar, përfshirë dhe të rinjtë, për rëndësinë e ndarjes në burim.

### Rekomandime .....

- Marrja e masave të qëndrueshme dhe bashkëpunimi i ngushtë me institucionet e tjera qendrore dhe vendore për të mos lejuar shtimin e vend-depozitimeve që nuk përmbushin standartet dhe në vende të pa lejuara. Hartimi i një plani veprimesh për mbylljen e venddepozitimeve të paautorizuara. **Bashkia Kukës duhet të marrë masa urgjente pasi numri mbetet i njëjtë dhe më i larti në vend me 41 vend-depozitime jasht standardeve.**
- Hartimi i planit vendor për menaxhimin e integruar të mbetjeve nga të gjitha bashkitë dhe integrimi i masave të tij në Programin Buxhetor Afatmesëm. Sigurimi i financimit dhe monitorimi i zbatimit të tij me efektivitet dhe efikasitet të lartë financiare.

Harta 28: Ndarja e mbetjeve ne burim, 2021




<sup>137</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

- Monitorimi i vazhdueshëm nga Bashkitë të shërbimeve të operatorëve privatë dhe atyre koncesionare të kontraktuar për ofrimin e shërbimit të grumbullimit, depozitimit dhe riciklimit të mbetjeve.
- Shtimi i numrit të projekteve të investimit për riciklimin e mbetjeve në bashki apo qarqe dhe bashkëpunimi me qeverisjen qendrore për realizimin në kohë të tyre.
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimit qytetar nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

**Objekti i specifik:** Integrimi i rreziqeve të ndryshimeve klimatike në planet vendore në përputhje me përparësitë dhe objektivat kombëtare.

Harta 29: Plani vendor i masave për zbutjen e rreziqeve, 2021



Në përputhje me prioritetet dhe masat kombëtare për zbutjen e rreziqeve të ndryshimit të klimës, kërkohet që bashkitë, me risk më të madh, të hartojnë dhe përditësojnë planin vendor të masave për zbutjen e rreziqeve; **rreth 18 % e bashkive ose 11 bashki kanë plan vendor të masave për zbutjen e rreziqeve** me një bashki më pak krahasuar me vitin 2020.

**Objekti i specifik:** Rritja e aftësisë për t'u përshtatur me efektet sfiduese të ndryshimit të klimës në nivelin lokal


Në 2021, **numri i specialistëve të punësuar dhe trajnuar në nivel vendor për ndryshimet klimatike**, është në total 48 nëpunës ose më pak se 1 nëpunës mesatarisht në Bashki (N=53). Treguesi mbetet në të njëjtat nivele me vitin 2020. Klos 12 punonjës, të njëjtin numër në 2020 dhe në disa bashki me vetëm 1 punonjës.

**Objekti i specifik:** Pyllëzimi i zonave të degraduara përmes riciklimit të destinacionit të burimeve pyjore dhe eliminimin e borxheve të subjekteve që veprojnë në fondin pyjor

- **Rreth 53 % e bashkive (N=56) kanë hartuar planin për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor dhe kullësor**, i cili integron dhe masat e mbarështimit të pyjeve, kullotave dhe bimëve mjekësore;
- **Numri i përgjithshëm i specialistëve vendorë për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave në 2021 është 464 ose mesatarisht 8.4 punonjës (N=55)**. Treguesi ka rritje nga viti 2020 me 70 specialistë më shumë. Bashkia Gramsh (59) dhe Kolonjë (32) kanë numrin më të madh të specialistëve të punësuar.




Grafiku 84: Shkalla e punësimit të specialistëve të fondit pyjor sipas legjislacionit, 2021



- Ndërmjet detyrave dhe përgjegjësi të NJQV që lidhen me ushtrimin e funksionit të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave është krijuar **i dëbës mbi subjektet që ushtrojnë veprimtari dhe krijuar i kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor**. Në 2021 janë 48 bashki (ose 78% N=57) kanë ngritur databazën<sup>138</sup>. Treguesi tregon rritje me vetëm 1 p.p. në krahasim me 2020.

Harta 30: Databaza për subjektet që ushtrojnë aktivitetet mbi fondin pyjor dhe kullësor, 2021



**Problemet dhe sfidat**

- Mungesa e planit vendor për menaxhimin e fondit pyjor dhe kullësor si dhe mbarështimit të pyjeve në një pjesë të bashkive.
- Planifikimi buxhetor i masave të planit vendor në dokumentin e planifikimit të buxhetit afat-mesëm (PBA) nuk është bërë nga një pjesë e madhe e bashkive.
- Numri i punonjësve vendorë për administrimin dhe inspektimin e duhur të Fondit Pyjor dhe Kullësor është ende larg standartit të përcaktuar me ligj.
- Rekrutimi i specialistëve për administrimin e fondit pyjor dhe kullësor nuk respekton kërkesat ligjore dhe në nivelin e kuotave të kërkuara.
- Trajnimet e pamjaftueshme për punonjësit vendorë për të rritur nivelin e profesionalizmit dhe zbatimin efektiv të kompetencave vendore.

**Rekomandime**

- Hartimi i planeve vendore për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike nga të gjitha bashkitë dhe sigurimi i fondeve për zbatimin e masave pilot dhe projekteve më afatgjata.
- Të marren masa të menjëhershme për të rishikuar dhe përmirësuar ndikimin mjedisor dhe strategjik për projektet, planet dhe programet ekzistuese dhe të planifikuara, veçanërisht në sektorët e hidroenergjisë, ndërtimit, turizmit, transportit dhe minierave<sup>139</sup>;

<sup>138</sup> Bashkitë Vorë, Skrapar, Divjakë dhe Cërrik nuk kanë ofruar të dhëna për treguesin

<sup>139</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

- Miratimi i Planeve Vendore për Pyjet dhe Planet e Mbarështimit si dhe përfshirja e masave në programin buxhetor për financimin e tyre në përputhje me prioritetet e bashkive sipas problematikave.
- Forcimi i bashkëpunimit midis bashkisë dhe qytetarëve dhe përfshirja e tyre në aksione për mbrojtjen e mjedisit, si dhe në veprime që synojnë monitorimin dhe ndikimin e ndotjes së mjedisit nga operatorët ekonomikë, dhe ushtrimi i presionit mbi ta për të ndërmarrë masa për të shmangur ndotjen.
- Bashkitë duhet të organizojnë fushata ndërgjegjësuese dhe komunikuese për të informuar qytetarët e tyre mbi rreziqet e ndryshimeve klimatike, masat zbutëse dhe përshtatëse.


Objekti i specifik: Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimet

Ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve përballen me sfida të tilla si mungesa e licensimit dhe tarifimit për trajtimin e ujërave të zeza, funksionimi dhe mirëmbajtja e pamjaftueshme, të ardhurat e pakta dhe ndikimi i kufizuar për shkak të rrjetit të pazhvilluar të kanalizimeve si dhe lidhjet shtëpiake. Ekziston një nevojë urgjente për harmonizimin e plotë me Direktivën e Trajtimit të Ujërave të Zeza Urbane, zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve, licensimi dhe aplikimi i tarifave adekuate për të gjitha impiantet e trajtimit dhe ndërtimit të ujërave të zeza të reja, veçanërisht në zonat urbane dhe bregdetare me zhvillim të lartë turistik<sup>140</sup>.

🔄 Në vitin 2021 raportohet se:

- Mesatarisht 82.65 % e familjeve janë të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë në zonat urbane në 2021 (N=60). **33% e Bashkive raportojnë 100% lidhjen e familjeve me rrjetin e furnizimit me ujë<sup>141</sup>. Ndërkohë 3 bashki: Dropull, Finiq, dhe Pustec raportojnë 0% të rrjetit të furnizimit me ujë i lidhur në zonat urbane. Bashkia Shijak nuk ka raportuar për këtë tregues. Treguesi ka pësuar ulje nga viti 2020 ku është raportuar 86.2 %.**
- Mesatarisht 62.17 % e familjeve janë të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë në zonat rurale në vitin 2021 (N=60). **Vetëm bashkia Shijak nuk ka raportuar për këtë tregues. Treguesi ka pësuar ulje nga viti 2020 ku është raportuar 71.2%.**
- **Ashtu si në vitin 2020 sërish nuk raportohet asnjë e dhënë për % e familjeve të lidhura me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza në zonat urbane.**
- Mesatarisht 22.36 % e familjeve janë të lidhura me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza në zonat rurale në vitin 2021 (N=59). **Bashkitë Shijak dhe Has nuk kanë raportuar për këtë tregues Treguesi ka pësuar ulje nga viti 2020 ku është raportuar 23.42%**


Grafiku 84: % e familjeve të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë në zonat urbane, 2021




<sup>140</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

<sup>141</sup> Tiranë, Tropojë, Skrapar, Selenicë, Prrenjas, Polican, Pogradec, Memaliaj, Mat, Belsh, devoll, Divjakë, Gramsh, Has, Klos, Kolonjë, Korçë, Lezhë, Libohovë, Librazhd

Grafiku 85: % e familjeve të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë në zonat rurale, 2021




Grafiku 86: % e familjeve të lidhura me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza në zonat rurale



- Rreth 23% e bashkive (ose 14 Bashki) raportojnë se Impianti i pastrimit të përpunimit të ujërave të zeza është i ngritur dhe funksional në vitin 2021 (N=58). **Treguesi ka rritje me +3.3 p.p. nga viti 2020.**
- Mesatarisht 51.86 % e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut është i rehabilituar dhe funksional në 2021.<sup>142</sup> Treguesi ka përmirësim nga viti 2020 me 47.7 % të rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut i rehabilituar.

Grafiku 87: % e rrjetit të kanalizimeve të ujërave të shiut i rehabilituar dhe funksional, 2021



**Objekti i specifik: Rritja e kapaciteteve për përballimin e emergjencave natyrore**

“Kapacitetet administrative, infrastruktura dhe sistemet për paralajmërim të hershëm, parandalim, gatishmëria dhe reagimi janë ende të pamjaftueshme. Përmblytjet e shpeshta në dekadën e fundit, tërmetet e vitit 2019, si dhe zjarret e fundit në pyje kanë nxjerrë në pah urgjencën e ndërtimit të sistemeve efikase të mbrojtjes civile

<sup>142</sup> 12 Bashki nuk kanë raportuar për këtë tregues

dhe reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe për të rritur qëndrueshmërinë e vendit ndaj fatkeqësive natyrore dhe krizave”<sup>143</sup>.

➔ **Gjatë vitit 2021 në Këshillin Konsultativ të Qeverisë qendrore me atë vendore janë diskutuar projekt aktet e mëposhtme:**

- Projektvendimi “Për miratimin e procedurave të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.
- Projektvendimi “Për përcaktimin e masës së kompensimit të dëmeve, procedurave, afateve, strukturave shtetërore përgjegjëse për vlerësimin e dëmeve, si dhe të pasurive të subjekteve që kompensohen për dëmet që shkaktohen si pasojë e një fatkeqësie”.
- Projektvendimi “Për miratimin e llojeve të sinjaleve të alarmit, numrit dhe mënyrës së përdorimit të tyre, në rastet e fatkeqësive”.
- Projektvendimi “Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura”.
- Projektvendimi “Për miratimin e procedurave të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.
- Projektvendimi “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për shpalljen e gjendjes së fatkeqësive natyrore”.



➔ **Ecuria në realizimin e këtij objektivit specifik matet me treguesit e mëposhtëm:**

- Në vitin 2021, janë 53 bashki (ose 86%) që raportojnë se kanë hartuar Planin Vendor për Përballimin e Emergjencave Civile në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile. Bashkitë Shijak dhe Divjakë nuk raportojnë për këtë tregues. Treguesi ka rritje të konsiderueshme me +15 p.p. nga viti 2020.
- Në vitin 2021, 59 Bashki ose rreth 97% e bashkive kanë ngritur shtabin e emergjencave civile. Vetëm dy bashki Shijak dhe Divjakë nuk raportojnë për këtë tregues. Treguesi ka rritje me +9 p.p. nga viti 2020.
- 97% e bashkive e bashkive (59 Bashki) kanë ngritur strukturën e emergjencave civile në 2021. Vetëm dy bashki Shijak dhe Divjakë nuk raportojnë për këtë tregues. Treguesi ka rritje me +9 p.p. nga viti 2020.
- Mbulimi i buxhetit për emergjencat civile nga Qeveria qendrore për vitin 2021 është mesatarisht 9.71 % e buxhetit të emergjencave civile në nivel vendor (N=56). Ka një rritje cilësore të buxhetit për emergjencat civile krahasuar me vitin 2020 ku është raportuar vetëm 2.24%.
- 5.41 % është mesatarja e fondeve shtesë për emergjencat civile të alokuar për vitin 2021 nga Bashkitë (N=56). Treguesi ka ulje nga viti 2020 ku janë alokuar mesatarisht 6.79% fonde shtesë.

<sup>143</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

Harta 31: Hartimi i Planit Vendor për përballimin e emergjencave civile, 2021

Harta 32: Bashkia ka ngritur strukturën e emergjencave civile, 2021



**Problemet dhe sfidat** .....

- Mungesa e rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve është ende prezente në disa Bashki të cilat raportojnë 0 % lidhje të rrjetit me familjet.
- Pamundësia e bashkive për të ndërhyrë me fondet e tyre me investime në rrjetet e ujësjetësive dhe kanalizimeve për shkak të financimit të lartë që kërkojnë këto projekte.
- Ndërmarrjet e ujësjetësive kanalizimeve përballen me sfida të mëdha si mungesa e licensimit dhe tarifimit për trajtimin e ujërave të zeza, funksionimi dhe mirëmbajtja e pamjaftueshme dhe të ardhurat e kufizuara për shkak të rrjeteve të pazhvilluara të kanalizimeve dhe lidhjet shtëpiake.<sup>145</sup>
- Ndërhyrjet e paligjshme në rrjetin e ujësjetësive nga banorët, familjet dhe biznet private kanë shtuar problematikat e bashkive.
- Kapacitetet administrative, infrastruktura dhe sistemet për paralajmërim të hershëm, parandalim, gatishmëria dhe reagimi janë ende të pamjaftueshme<sup>147</sup>.

145 Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

147 Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

**Rekomandime**

- Ekziston një nevojë urgjente për zgjerimin e rrjetit të kanalizimeve licensimi dhe aplikimi i tarifave adekuate për të gjitha impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura dhe ndërtimi i impianteve të reja, veçanërisht në zonat urbane dhe bregdetare me zhvillim të lartë turistik<sup>149</sup>.
- Më shumë projekte investimi duhet të kanalizohen nga qeveria qendrore kryesisht për bashkitë që kanë problematikat më të mëdha në rrjet dhe buxhete të limituara.
- Forcimi i bashkëpunimit Bashki–Komunitet–Polici për të shmangur dhe ndalur ndërhyrjet e paligjshme në rrjetin e furnizimit me ujë.
- Rrirja e performancës së bashkive në monitorimin e situatës dhe identifikimin e hershëm të ndërhyrjeve në terren.
- Hartimi dhe miratimi i Planit Vendor për përballimin e emergjencave civile në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencave Civile nga të gjitha Bashkitë.
- Shtimi i fondeve nga ana e Qeverisë Qendrore sipas detyrimit për mbështetjen e bashkive me fonde buxhetore për parandalimin dhe menaxhimin e emergjencave civile.

**PËRFUNDIME MBI MJEDISIN DHE NDRYSHIMIN E KLIMËS**

**Kanë vazhduar përpjekjet e Bashkive për të siguruar zbatimin e legjislacionit në fushën e mjedisit dhe klimës si dhe rritjen e njohurive të stafëve lokale mbi standartet e BE-së në këtë sektor.** Problematikat e mbartuara në vite dhe abuzimet me mjedisin vazhdojnë të mbeten prezente në një pjesë të madhe të territorit të vendit. Kjo situatë ka shtuar nevojën për më shumë fonde dhe projekte afatgjata për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit përmes një zhvillimi të qëndrueshëm.

**Lidhur me menaxhimin e Integruar të mbetjeve kapacitetet e bashkive për mbledhjen dhe ndarjen në burim mbeten të kufizuara.** Roli i bashkive për monitorimin e zbatimit efektiv të shërbimit të ofruar nga kontraktorë të jashtëm për pastrimin duhet të forcohet si dhe të rritet shkalla e ndërgjegjësimit qytetar në mbrojtje të mjedisit. Mbyllja e shumë vend-depozitimeve të papërshtatshme mbetet problematikë edhe në vitin 2021.

**Progres të ngadaltë ka patur përsa i përket hartimit të planit të veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe marrjen e masave për zbutjen e rreziqeve të ndryshimit të klimës.** Pjesa më e madhe e bashkive nuk kanë një plan vendor veprimi për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Niveli i pjesëmarrjes së bashkive në trajnime mbi zbatimin e masave të politikave kombëtare për ndryshimet klimatike ka qenë pozitiv.

**Progres i ulët është bërë në vitin 2021 lidhur me hartimin e planeve vendore për administrimin e pyjeve.** Njësitë e Qeverisjes Vendore kanë detyra të rëndësishme që lidhen me administrimin e fondit pyjor vendor të tilla si hartimi i strategjive, planin e menaxhimit për fondin pyjor, programin e zhvillimit të sektorit dhe planin e mbarështimit të pyjeve. **Në raportin e progresit të BE të vitit 2021, theksohet nevoja që Shqipëria duhet të sigurojë zbatimin e ligjeve për pyjet dhe prerjet e pyjeve dhe të ndjekë penalisht shkelësit dhe zjarrvënësit.**

**Investimet në rrjetin e ujësjellës kanalizimeve sërisht hasen me problematika si ndërhyrjet e paligjshme, mirëmbajtja e pamjaftueshme, rrjeti i pazhvilluar i kanalizimeve dhe lidhjet shtëpiake e të bizneseve.** Nevojë urgjente mbetet investimi në rrjetin e kanalizimeve dhe impiantet e trajtimit të ujërave të zeza. Sipas Raportit të Progresit të BE 2021 Shqipëria duhet të përforcojë dhe përshpejtojë më tej masat e reformës së ujit për të rritur performancën dhe qëndrueshmërinë e shoqërive dhe nivelin e shërbimit të ofruar për të gjithë qytetarët.

**Progres domethënës është bërë nënëgritjen e Shtabit të Emergjencës Civile dhe strukturës së emergjencave civile të cilat janë tashmë funksionale pothuaj në të gjithë territorin e vendit.** Megjithatë sipas edhe raportit të progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021 kapacitetet administrative, infrastruktura dhe sistemet për paralajmërim të hershëm, parandalim, gatishmëria dhe reagimi janë ende të pamjaftueshme.

<sup>149</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

sipas edhe raportit të progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021 kapacitetet administrative, infrastruktura dhe sistemet për paralojmërim të hershëm, parandalim, gatishmëria dhe reagimi janë ende të pamjaftueshme.

### 3.12 KAPITULLI 32: KONTROLLI FINANCIAR

*“BE promovon reformën e sistemeve të qeverisjes kombëtare për të përmirësuar përgjegjshmërinë menaxheriale, menaxhimin e shëndoshë financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kontrollin e jashtëm të fondeve publike. Gjithashtu, rregullat e kontrollit financiar mbrojnë më tej interesat financiare të BE-së kundër mashtrimit në menaxhimin e fondeve të BE-së dhe euros kundër falsifikimit.*

Shqipëria është përgatitur mesatarisht në këtë fushë. Është bërë njëfarë progresi gjatë periudhës së raportimit, veçanërisht me miratimin e një dokumenti politikash për forcimin e kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP), udhëzimet për delegimin e përgjegjësive financiare, udhëzimet për monitorimin dhe raportimin për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të brendshëm dhe rishikimin e kontrollit të cilësisë së auditimit të jashtëm dhe procedurat e sigurimit të cilësisë. Megjithatë, Shqipëria nuk ka miratuar ende një dokument politik gjithëpërfshirës të kontrollit të brendshëm financiar publik, për t'u përqëndruar në llogaridhënien menaxheriale, dhe nuk ka bërë ndryshimet e nevojshme në legjislacion. Funkionimi i duhur dhe efektiv i kontrollit të brendshëm ende nuk është siguruar në të gjitha njësitë buxhetore. Kërkohej që vendi të (i) zbatojë udhëzimet për delegimin financiar të përgjegjësive dhe të nxjerrë udhëzime për delegimin e përgjegjësive menaxheriale, (ii) të monitorojë dhe të ndjekë zbatimin e rekomandimeve të bëra në raportin vjetor të KBFP në institucionet buxhetore, (iii) të rrisë shqyrtimin parlamentar të organeve të audituara në zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm dhe krijimit të një kuadri monitorues parlamentar për të vlerësuar rregullisht veprimet vijuese të qeverisë.”<sup>150</sup>.


Ekziston një kornizë strategjike për KBFP. Masat e KBFP-së përfshihen në Stratëgjinë e Menaxhimit të Financave Publike dhe Reformën në Administratën Publike 2019-2022 dhe në dokumentin e politikave të KBFP-së 2021-2022. Përgjegjësia menaxheriale nuk është ende plotësisht e sanksionuar në legjislacion dhe praktikën administrative.

Udhëzimet e miratuara për delegimin e përgjegjësive financiare duhet të zbatohen dhe të shoqërohen me një reformë më të gjerë për delegimin e përgjegjësive operacionale dhe administrative, në mënyrë që të kemi një qasje gjithëpërfshirëse për llogaridhënien menaxheriale. Një numër shumë i vogël vendimesh administrative delegohen në praktikë. Raportimi fokusohet kryesisht në performancën financiare, por me një numër në rritje të institucioneve që raportojnë edhe performancën kundrejt objektivave. Rishfaqja dhe rritja e detyrimeve të prapambetura është një tregues për atribuimin ende jo efektiv të përgjegjësive dhe kontrolleve të angazhimit<sup>93</sup>.

Në vitin 2021, të ardhurat nga pushteti vendor kanë përbërë 1.67% të PBB (29,498 milion lek), që shënon rritje me 0.27 p.p të PBB, krahasuar me vitin 2020 (N=61).

<sup>150</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (2021)

Grafiku 88: Të ardhurat e pushtetit vendor, 2017 – 2021 (në milion lek)




Shpenzimet e pushtetit vendor, në 2021, kanë qenë 52,583 milion lek (ose 8.82% të shpenzimeve publike), duke shënuar një rritje me 1.85 p.p. krahasuar me shpenzimet e vitit 2020 (pa konsideruar totalin për rindërtimin në 2020)<sup>151</sup>.

Në raport me PBB, shpenzimet e pushtetit vendor zënë një peshë 2.97% të PBB (PBB 1769,3 miliard lek në 2021). Shpenzimet për paga (600), kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601) dhe shpenzime për mallra dhe shërbime (602) kanë shënuar rritje në vitin 2021 kundrejt 2020, ndërsa subvencionet (603) kanë pësuar ulje të lehtë (N=61).

Grafiku 89: Shpenzimet e NJVV, 2021 / 2020

(në milion lek)



Burim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë / Drejtoria e Financave Vendore


Në 2021, mesatarja e realizimit të të ardhurave të planifikuara vjetore ka qenë 77.04% (n=56). Bashkia e Tiranë, Kukësit dhe Sarandës kanë patur një normë realizimi 100%. Rreth 24% e bashkive kanë patur normën e realizimit të të ardhurave të planifikuara vjetore më të ulët se 70%<sup>152</sup> (N=56).

<sup>151</sup> Burim: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

<sup>152</sup> Raportimi i NJVV mbi treguesit e performancës për vitin 2021




Grafiku 90: Norma e realizimit të të ardhurave të planifikuara vjetore, 2021



Norma mesatare e realizimit të shpenzimeve të planifikuara vjetore ka qenë 79.84% (N=56)


Bashkia e Mirditës ka patur normë realizimi 100%, ndjekur nga Bashkia Finiq (99%), Bashkia Tropojë (98.18%), Këlcyrë (95%), Gjirokastrë (94%). Rreth 38% të bashkive kanë patur normë realizimi të shpenzimeve të planifikuara vjetore më të ulët se 80%.

Grafiku 91: Norma e realizimit të shpenzimeve të planifikuara vjetore të NJVV, 2021



Detyrimet e prapambetura të bashkive në fund të vitit 2021 kanë qenë 6,460,929,683 leke duke u zvogëluar me 6.78 p.p. krahasuar me vitin 2020. Duke konsideruar edhe institucionin e qarkut, stoku i detyrimeve të prapambetura për pushtetin vendor ishte 6,580 milion lek, në fund të vitit 2021.

Rreth 29% e bashkive kanë rritur stokun e detyrimeve të prapambetura në vitin 2021 krahasuar me 2020, por norma mesatare e ndryshimit të stokut ka qenë 22.3% (N=57) që rezulton me vlerë më të ulët krahasuar me vitin 2020 (26.8%).

Grafiku 92: Norma e ndryshimit të detyrimeve të prapambetura të NJVV (2021/2020)<sup>153</sup>

Edhe në vitin 2021, detyrimet e prapambetura të bashkive u reduktuan por mbetën mbi nivelin e synuar. Në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të të Dhënave Sistematike (NSPD) 2020-2027, është kryer rishikimi dhe përmirësimi i paketave fiskale të NJQV dhe janë organizuar aktivitete për kontrollin e brendshëm dhe auditimin në nivel vendor, monitorimin dhe vlerësimin e performancës mbi bazën e objektivave dhe treguesve<sup>148</sup>.

Stokun më të lartë të detyrimeve e ka bashkia e Kavajës (12.46% të stokut gjithsej), ose rreth 820 milion lek, Bashkia e Tiranës (9.61% të stokut gjithsej) ose rreth 632 milion lek dhe Bashkia e Vorës (7.83% të stokut gjithsej) ose rreth 515 milion lek.

Rreth 188 dëgjesa publike (mesatarisht 3 dëgjesa) janë organizuar nga bashkitë mbi realizimin faktik të buxhetit (N=58).

Si rezultat i aktivitetit auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) janë evidentuar shkelje me efekte në buxhetin e shtetit lidhur me administrimin e të ardhurave dhe menaxhimin jo të kujdesshëm të fondeve publike, si dhe inefiçenca në realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe shkelje në zbatimin e legjislacionit fiskal. Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, janë llogaritur me dëm ekonomik në shumën totale 29.5 milion euro. Nga 134 subjekte, në të cilat janë ushtruar misione auditimit, 28 prej tyre janë institucione të vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor. Në fund të misioneve të auditimit, KLSH ka dhënë 2171 masa organizative, 622, 132 masa administrative dhe 64 rekomandime për ndryshime apo përmirësime ligjore<sup>154</sup>.

Në fushën e shitjes, blerjes dhe dhënies me qera të pasurisë shtetërore, marrëveshjeve hidrokarbure janë evidentuar shkelje në Bashkinë Dibër (8,494 mijë lekë), si pasojë e mosllogaritjes së vlerës së qerasë të aseteve,

<sup>153</sup> Burim: MFE / Drejtoria për Financat Vendore

<sup>154</sup> Raport i Kontrollit të Lartë të Shtetit (për vitin 2021)

të cilat janë pronë e njësisë vendore, Bashkia Peqin (4,941 mijë lek), si pasojë e moslidhjes së kontratave të qerasë me personat të cilët kanë zaptuar tokat bujqësore dhe nuk është ndjekur rruga ligjore për krijimin e të ardhurave nga këto prona, Bashkia Kurbin (1,381 mijë lek), si pasojë e moslogaritjes saktë të vlerës së qerasë për subjektin që ka në përdorim tokën shtetërore për qëllime biznesi, Bashkia Sarandë (42 mijë lek), si pasojë e moslogaritjes saktë të vlerës që duhet të paguhet nga subjektet për sipërfaqet e plaxhit në përdorim. Në fushën e urbanistikës, është vlerësuar dëm ekonomik në Bashkinë e Shkodrës (14,418 mijë lek), për shkak të moslogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, Bashkia Peqin (790 mijë lek), si pasojë e mosarkëtimit të tarifës së urbanistikës për çdo kantier ndërtimi, nga subjekte që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e bashkisë<sup>155</sup>.

Dëmi në prokurime publike në të gjitha misionet e aktivitetit auditues është vlerësuar 337 milionë lek nga KLSH në 2021. Shkeljet kanë rezultuar në mosplotësimin e kriterëve të kualifikimit, në skualifikime të ofertuesve, në oferta anormalisht të ulta dhe procedura prokurimi me një pjesëmarrës dhe fituesnjëkohësisht. Midis subjekteve ku janë evidentuar dëm ekonomik në realizimin e procedurave të prokurimit janë Bashkia Kukës, Bashkia Tropojë, Bashkia Krujë, Durrës, Konispol, Këlcyrë, dhe Bashkia Shkodër. Dëm ekonomik për moszbatimin e punimeve përkundëjt termave të kontratës, janë evidentuar Bashkitë Korçë, Sarandë, Kurbin, Këlzyrë, Pogradec, Dibër, Shkodër Peqin, Tropojë, Kuçovë, Lushnjë, Vlorë, kukës, Tepelenë dhe Konispol.

*Disa nga sfidat dhe rekomandimet të raportimit të mëparshëm mbeten relevante:*

#### Problemet dhe sfidat .....

- Realizimi i planit të të ardhurave.
- Realizim i plotë i shpenzimeve dhe likuidimi i detyrimeve ndaj palëve të treta.
- NJVV mbeten institucionet më të dobta përsa i përket funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm<sup>156</sup>.
- Praktika jo të mira me pasojë dëm ekonomik lidhur me administrimin e të ardhurave dhe menaxhimin jo të kujdesshëm të fondeve publike, si dhe inefiçenca në realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe në zbatimin e punimeve sipas kontratave të nënshkruara<sup>157</sup>.
- Mungojnë kapacitetet për të menaxhuar në mënyrë efektive proceset e prokurimit publik<sup>158</sup>.
- Sfida janë pagesat e detyrimeve të prapambetura, shmangia e krijimit të borxheve te reja, dhe rritja e burimeve të financimit nëpërmjet rishikimit të politikave vendore fiskale.
- Mungesë e kapaciteteve për të aplikuar sistematikisht dhe me efektivitet parimet dhe instrumentat për menaxhimin e shëndoshë financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kontrollin në përdorimin e fondeve publike dhe fondeve të BE<sup>159</sup>.

<sup>155</sup> Raport i Kontrollit të Lartë të Shtetit (për vitin 2021)

<sup>156</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Nëntor 2021), kapitulli 32 (Kontrolli Financiar)

<sup>157</sup> Raport i KLSH (2021)

<sup>158</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Nëntor 2021)

<sup>159</sup> Raport mbi Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme (2020), MFE

**Rekomandime**

- Ruatja e standardeve ligjore për buxhetimin mbi bazë programi e funksioni dhe të prioritetëve strategjike në të gjitha njësitë vetëqeverisjes vendore.
- Ruajtja e qëndrueshmërisë së transfertës së pakushtëzuar<sup>160</sup>.
  - Forcimi i zbatimit të rregullave dhe procedurave për menaxhimin e financave publike në nivel vendor.
  - Përmirësimi i zbatimit në legjislacion dhe në praktikë të përgjegjësive operacionale dhe menaxheriale<sup>161</sup>.
  - Librat e proceseve të biznesit duhet të hartohen në të gjithë administratën publike në mënyrë që të përforcohet KBFP, duke përfshirë qartësimin e roleve dhe përgjegjësive në procedurat e ndryshme, përcaktimin e objektivave dhe rezultateve<sup>101</sup>.
  - Rritja e kapaciteteve të NJVV në prokurimin publik të mallrave, shërbimeve dhe punë civile dhe në monitorimin dhe zbatimin rigoroz të kontratave të nënshkruara nëpërmjet trajnimeve.
- Rritja e alokimit të buxhetit në shërbimet publike në NJVV, që kanë patur një fond më të vogël se 2% të buxhetit vendor, për shërbime të rëndësishme.<sup>162</sup>
- Rritja e cilësisë së raportimit dhe të transparencës mbi ekzekutimin e buxhetit, duke përfshirë jo vetëm performancën financiare por edhe performancën mbi arritjen e objektivave dhe rezultateve të synuara.

**PËRFUNDIME MBI KONTROLLIN FINANCIAR**

Ndonëse ekziston një kornizë strategjike për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik (KBFP), përgjegjësia menaxheriale nuk është ende plotësisht e sanksionuar në legjislacion dhe praktikën administrative. NJVV mbeten institucionet më të dobta për sa i përket funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm<sup>163</sup>.

Të ardhurat nga pushteti vendor janë rritur në vitin 2021, duke zënë një peshë 1.67% të PBB. Rritje kanë patur edhe shpenzimet e pushtetit vendor. Rreth 29% e bashkive kanë rritur stokun e detyrimeve të prapambetura. Praktika jo të mira me pasojë dëm ekonomik lidhur me administrimin e të ardhurave dhe menaxhimin jo të kujdesshëm të fondeve publike, si dhe inefiçenca në realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe në zbatimin e punimeve sipas kontratave të nënshkruara janë evidentuar në disa bashki të vendit<sup>164</sup>.

Sfida janë rritja e burimeve të financimit nëpërmjet rishikimit të politikave vendore fiskale, realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve sipas planit, likuidimi i borxhit dhe shmangia e krijimit të borxheve të reja. Gjithashtu, është i nevojshëm forcimi i zbatimit të rregullave dhe procedurave për menaxhimin e financave publike në nivel vendor, rritja e cilësisë së raportimit dhe të transparencës mbi ekzekutimin e buxhetit, duke përfshirë jo vetëm performancën financiare por edhe performancën mbi arritjen e objektivave dhe rezultateve, si dhe rritja e kapaciteteve në drejtim të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

<sup>160</sup> Raporti vjetor për financat publike vendore (2020)\_MFE

<sup>161</sup> Raporti i Progresit të KE për Shqipërinë (Nëntor 2021)

<sup>162</sup> Raporti mbi performancën e shërbimeve publike të ofruara nga NJVV (2021), SHAV me mbështetje të BfF (Helvetas, SDC)

<sup>163</sup> Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (Nëntor 2021), kapitulli 32 (Kontrolli Financiar)

<sup>164</sup> Raport i KLSH (2021)



BASHKITË  
NË PROCESIN  
E INTEGRIMIT  
TË SHQIPËRISË  
NË BASHKIMIN  
EVROPIAN

RAPORTI  
I VLERËSIMIT  
PËR VITIN 2021